

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

3.12.2024

Ora 11:04

RENDI I DITËS


Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr.24-29 dhe revokim vendimi i KAS nr. 14 dhe nr.18.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. J. Dumi, z. K. Puleri
- **Parti Politike:** (Sipas listës bashkëlidhur procesverbalit)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. Ledio Braho: Mirëmëngjes, sot për në ora 11.00 ishte lënë seanca për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit në lidhje me vendimin nr.186 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Megjithatë përpara se të fillojmë me shqyrtimin e kësaj kërkesë të Komisionerit duhet të relatojmë që pas zhvillimit të seancës nga ana e KAS-it me datë 19.11.2024, pranë KQZ-së janë paraqitur dhe një sërë kërkesash të tjera ankimore nga subjekte të ndryshme, që kanë lidhje pikërisht me këtë kërkesë të Komisionerit dhe me këtë vendim të Komisionerit. Kështu që duke iu referuar praktikës që u ndoq me vendimmarrjet e datës 19.11.2024, po ashtu dhe me vendimmarrje të mëparshme të KAS-it në lidhje me çështje të ngjashme, referuar kërkesave ankimore: nr. 24, me ankues “Partia Aleanca Progresiste e Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, kërkesa ankimore nr. 25, me ankues “Partia Aleanca për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Demokraci dhe Solidaritet”, kërkesa ankimore nr.26 me ankues “Partia Aleanca Demokratike” dhe kërkesën ankimore nr. 27 me ankues Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Mëlyshi, kërkesa ankimore nr. 28, me ankues “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” dhe kërkesa ankimore nr. 29, me ankues “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, janë të gjitha kërkesa ankimore të depozituara pas seancës së datës 19.11.2024. Në lidhje me gjithë këto kërkesa do të vendoset mospranimi i tyre për shkak të të njëjtit argument që është arsyetuar dhe për kërkesat e tjera sepse jemi në kushtet që Komisioneri ka bërë një kërkesë dhe nuk ka një vendimmarrje dhe të gjitha këto palë që citova, së bashku me palët e tjera për të cilat seanca është zhvilluar në datë 19.11.2024, kanë cilësinë e palës së interesuar në zhvillimin e seancës për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit. Pra të gjitha ato të drejta që ata kanë tentuar t’i rregullojnë nëpërmjet mjetit procedural të ankimit për të cilin KAS-i nuk ka kompetencë, duke qenë se nuk ka vendimmarrje, mund t’i mbrojnë nëpërmjet seancës së sotme të shqyrtimit administrativ, në cilësinë e palëve të interesuara në lidhje me vendimin nr.186 të Komisionerit. Kështu që kjo për sa u përket këtyre kërkesave ankimore. Gjithashtu edhe të gjitha palët që janë pjesë e kërkesës së Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ, kanë marrë dijeni për seancën e sotme të shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë, kështu që procesi i rregullt ligjor është i përmbushur për të gjitha këto palë që është vendosur mospranimi i ankimit. Të njëjtën gjë, që duhet të citohet, është që gabimisht në seancën e kaluar kanë qenë dy kërkesa ankimore, kërkesa ankimore nr. 14 dhe kërkesa ankimore nr.18 që ishin media audio-vizive, për të cilat KAS-i ka vendosur me vendimin nr.34 dhe nr.35 të datës 19.11.2024, po ashtu mospranimin, moskalimin për shqyrtim. Këto vendime si absolutisht të pavlefshme duke qenë se këto kanë vendimmarrje dhe jo kërkesë të Komisionerit, do të anulohen dhe pas zhvillimit të kësaj seance do të vendosim në qoftë se do i kalojmë për shqyrtim një

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

ditë tjetër apo do t'i kthejmë për plotësim të metash, në qoftë se kanë të meta. Kjo ishte për hyrje, kështu që tani vijojmë me...

Z. Kujtim Gjuzi: Kryetar mund të bëj një ndërhyrje?

Z. L. Braho: Po.


Z. K. Gjuzi: Po, faleminderit! Aty ju thatë që janë bërë kërkesa ankimore me shkrim drejt zyrës së Komisionerit, ne kemi qenë prezent në seancën e kaluar, pra konsiderohemi që jemi të barabartë me të gjithë kolegët e tjerë?

Z. L. Braho: Po. Këto kërkesa janë depozituar pasi kemi zhvilluar seancën me datë 19, kështu që për ju i kemi sqaruar herën e kaluar.

Z. K. Gjuzi: Faleminderit z. kryetar!

Vendimi nr. 36-43

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

3.12.2024

Ora 11:16

RENDI I DITËS


Shqyrtimi i kërkesës nr. 3, datë 15.11.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative, referuar vendimit nr. 186, të KSHZ, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. J. Josifi, z. E. Mema, z. K. Puleri
- **Parti Politike:** (Sipas listës bashkëlidhur procesverbalit)
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. L. Braho: Mirë atëherë çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit, me nr. 3, datë 15.11.2024, kërkesë për vendosje sanksioni administrativ. Kërkesë kjo që bazohet në vendimin nr.186, të Komisionerit, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve dhe auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. KAS-i përbëhet nga katër anëtarë që janë të pranishëm në sallë, një anëtar, Koli Bele po e ndjek online dhe shumë shpejt do të na bashkohet fizikisht. Kështu që trupa e KAS-it është e përbërë në mënyrë të plotë për zhvillimin e kësaj seance shqyrtimi administrativ. Në sallë janë një numër i konsiderueshëm palësh të cilët do të identifikohen në vijim. Nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

palët që janë këtu të pranishme, ka ndonjë prej tyre ndonjë pretendim në lidhje me trupën e KAS-it për konflikt interesi? Jo, nuk ka. E pranishme është administrata e KQZ-së. Kështu që si fillim të dëgjojmë përfaqësuesit e KQZ-së në lidhje me kërkesën dhe pastaj sipas renditjes në vendimin e Komisionerit do t'ju japim fjalën gjithsecilit që është i pranishëm në këtë seancë nga palët duke qenë se propozimi për sanksion administrativ është rreth 80 palë që janë kryetarë bashkish, parti politike, kandidatë për kryetar bashkie. Kështu që vijojmë, si fillim i japim fjalën përfaqësueses së KQZ-së në lidhje me parashtrimet përsa i përket kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative. Përmbledhtazi për secilin rast, na referoni subjektin, shkaqet për kërkesën, për sanksion administrativ dhe vlerën e propozuar, pse propozohet atë nga Komisioneri.

Znj. J. Josifi: Ju faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim raportet e gjetjeve të audituesve ligjorë, sa i takon fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në përfundim të raporteve të gjetjeve të dorëzuar nga auditët ligjorë, administrata e KQZ-së ka përgatitur raportin përmbledhës të këtyre gjetjeve dhe në përfundim të procedurës administrative, verifikimeve, komunikimeve zyrtare të kryera me palët, por edhe me institucione të tjera për të cilat kishte nevojë për verifikim, Komisioneri nëpërmjet vendimit nr.186, të datës 8 tetor 2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara, shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” ka konstatuar shkelje në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga disa subjekte. Në vijim, Komisioneri nëpërmjet kërkesës nr. 3, të datës 15 nëntor 2024, i propozon Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve vendosjen e masave administrative sipas shkeljeve përkatëse për subjektet e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

listuara nga pika 2 deri në pikën 88 të dispozitivit të vendimit të sipër cituar. Në vijim të kërkesës tuaj për të paraqitur shkurtimisht cila është shkelja dhe vlera e propozuar nga ana e Komisionerit për vendosjen e sanksionit përkatës, nga pika 2 deri në pikën 88 të dispozitivit të vendimit, janë kthim shume nga fondet e përfituara për fushatën sepse rezultojnë të pashpenzuara, kthim diference, pra nuk është sanksion, është kthim shume.

Z. L. Braho: Kjo që është vendosur si detyrim për pikën 89 dhe pikën 90, është pjesë e kërkesës apo është pjesë e vendimmarrjes?

Znj. J. Josifi: Është pjesë e vendimmarrjes.

Z. L. Braho: Ka pasur ndonjë ankim për këto?

Znj. J. Josifi: Jo.

Z. L. Braho: Dakord.

Znj. J. Josifi: Konkretisht shkeljet sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor, është propozuar sanksioni në vlerën 500 000 lekë, shkak është paraqitja e raporteve financiare në shkelje të rregullave të formateve të standartizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përkatësisht neni 173, pika 3, pjesa e dytë ku thuhet “Dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë”, propozimi i Komisionerit është në vlerën 500 000. Përkatësisht për: “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian”, “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, “Partia Aleanca Liberale e Djathtë”, “Partia Aleanca Arbnore

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Kombëtare”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, “Partia Aleanca për Drejtësi, Demokraci dhe Solidaritet”, “Partia Aleanca Progresiste LZHK”, “Partia Ardhmërija Shqiptare”, “Partia Bindja Demokratike”, “Partia Fronti i Majtë”, “Partia Fryma e Re Demokratike”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, “Partia Nisma Thurje”, “Partia Agrare Ambjentaliste”, “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”, “Partia Balli Kombëtar”, “Partia Demokracia Sociale”, “Partia Demokratike”, “Partia e Gjellbër”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, “Partia e Emigracioni Shqiptar”, “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, “Partia Konservatore”, “Partia Kristian Demokrate”, “Partia për Mbrojtjen e Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, “Partia Republikane Shqiptare”, “Partia Uniteti Kombëtar”, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”. Sanksioni tjetër i propozuar në vlerën 2 000 000 lekë, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vjen në zbatim të nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor, konkretisht mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor, thotë neni përkatës dhe dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh, pjesa e parë e këtij neni, përkatësisht për këtë sanksion. Ky sanksion është propozuar për “Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, “Partinë Aleanca Arbnore Kombëtare”, “Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë”, “Partinë Komuniste të Shqipërisë”, “Partia Uniteti Kombëtar”, “Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane”, “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”, “Partia Konservatore”, “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”, “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”. Sanksioni tjetër i radhës i propozuar sipas nenit 173, pika 5, të Kodit Zgjedhor përkatësisht, është për shkak të pranimit të fondeve private me vlerë më të madhe se 50 000 lekë, përmes formave të tjera,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe me kalimin e fondeve të marra për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përkatësisht për kandidatin për kryetar bashkie të Bashkisë Belsh, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Arif Tafani, propozohet gjobë në vlerën 206 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie të Bashkisë Fier, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Armando Subashi me gjobë në vlerën 138 910 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidaten për kryetare bashkie të Bashkisë Durrës, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, znj. Emirjana Sako, me gjobë në vlerën 75 859 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie të Bashkisë Kuçovë, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” z. Kreshnik Hajdari me gjobë në vlerën 500 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidaten për kryetare bashkie të Bashkisë Roskovec të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” znj. Majlinda Bufi me gjobë në vlerën 243 500 lekë dhe kalimin e fondeve për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie të Bashkisë Librazhd të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Mariglen Disha, me gjobë me vlerën 125 490 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Mat, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” z. Agron Malaj, me gjobë në vlerën 80 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Peqin, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Bukurosh Maçi, me gjobë në vlerën 70 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Krujë të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Agron Loka, me gjobë në vlerën 486 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Mirditë, z. Albert Mëlyshi, të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

subjektit “Partia e Lirisë”, me gjobë në vlerën 300 mijë lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Sarandë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Ardit Cikuli, me gjobë me vlerën 259 958 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Kamëz, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Arjan Hoxha me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Divjakë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Aurel Malko, me gjobë me vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Shkodër, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Bardh Spahia, me gjobë me vlerën 445 280 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Klos, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Bedri Hoxha, me gjobë në vlerën 156 715 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie të Bashkisë Kurbin, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Behar Haxhiu, me gjobë në vlerën 132 456 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Tropojë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Besnik Dushaj me gjobë në vlerën 178 758 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Bulqizë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Dëfrim Fiku, me gjobë në vlerën 192 294 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Gjirokastrë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Dorjan Lani, me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të bashkisë Përmet, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Edmond Komino, me gjobë në vlerën 198 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Devoll, të subjektit “Partia e Lirisë”, z.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Elvis Hajderlli, me gjobë në vlerën 223 762 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Kolonjë, subjekti “Partia e Lirisë”, z. Ethem Lumani, me gjobë në vlerën 169 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Fier, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Evdar Kodheli, me gjobë në vlerën 192 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Konispol, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Fatmir Shero, me gjobë në vlerën 172 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Kavajë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Fisnik Qosja, me gjobë në vlerën 392 220 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidati për kryetar bashkie, Bashkia Gramsh, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Hasim Çekrezi, me gjobë në vlerën 107 440 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidati për kryetar bashkie, të Bashkisë Fushë-Arrëz, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Hilë Curri, me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Vlorë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Hysni Sharra me gjobë në vlerën 452 311 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Durrës, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Igli Cara, me gjobë në vlerën 368 135 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidati për kryetar bashkie, të Bashkisë Dibër, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Ismail Uka, me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Kuçovë, subjekti “Partia e Lirisë”, z. Lefter Maliqi, me gjobë në vlerën 170 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Elbasan, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Luçiano Boçi, me gjobë në vlerën 72 000

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Has, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Miftar Dauti, me gjobë në vlerën 95 948 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidati për kryetar bashkie, të Bashkisë Lezhë, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Pashk Gjoni, me gjobë në vlerën 171 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidati për kryetar bashkie, të Bashkisë Mallakastër, subjekti “Partia e Lirisë”, z. Resmi Shanaj, me gjobë në vlerën 72 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidati për kryetar bashkie, të Bashkisë Librazhd, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Shefki Çota, me gjobë në vlerën 118 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Rrogozhinë, të subjektit “Partia e Lirisë” z. Shkëlqim Hoxha me gjobë në vlerën 316 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidaten për kryetare bashkie, të Bashkisë Patos, të subjektit “Partia e Lirisë”, znj. Sofije Alushaj, me gjobë në vlerën 80 100 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Berat, të subjektit “Partia e Lirisë”, z. Zija Ismaili, me gjobë në vlerën 105 840 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Pogradec, subjektit “Partia e Lirisë”, z. Zini Tollozhina, me gjobë me vlerën 188 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Sanksioni i radhës i propozuar vjen në vijim të shkeljeve të nenit 173, pika 6, të Kodit Zgjedhor, përkatësisht pranimi i fondeve nga donatorë të ndaluar, sikundër specifikohet në pikën 3 të nenit 92/1, dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra. Përkatësisht ky sanksion është propozuar për kandidatin për kryetar bashkie, të Bashkisë Lezhë, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Pjerin Ndreu, me gjobë në vlerën 720 000 lekë dhe kalimin e fondeve të marra për llogari

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

të KQZ-së. Sanksioni i radhës është ai për shkak të shkeljeve të nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor, mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjesimi i dokumentave ose vonesat, ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja ,sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë, përkatësisht ky sanksion është propozuar për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 300 000 lekë. Partinë politike “Partia Demokratike” me gjobë në vlerën 200 000 lekë, partinë politike, “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” në vlerën 100 000 lekë. Partinë politike “Partia Republikane” me gjobë në vlerën 100 000 lekë, partinë politike “Partia Konservatore” me gjobë në vlerën 100 000 lekë. Faleminderit!

Z. L. Braho: Mirë, faleminderit! Siç duket qartë, propozimi për sanksionet administrative është i ndarë në grupe në varësi të pikave, të specifike të nenit 173 të Kodit Zgjedhor që ka të bëjë me sanksionet në lidhje me financimet e fushatës. Atëherë mund t’i kthehemi prapë administratës së KQZ-së me pyetje në varësi të pretendimeve që kanë palët, që janë të pranishme në këtë seancë. Atëherë fillojmë me radhë sipas renditjes së vendimit, do të shohim kush është i pranishëm në seancë. Nga “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Evropian”, ka ndonjë të pranishëm? Jo nuk ka. “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”? Po, gjej një vend me mikrofon, bëjeni me rotacion, siç e bën KAS-i kryetarin, bëjeni dhe ju të drejtën e fjalës. Shkurtimisht pse, a e gjeni në mbështetje me ligjin këtë propozimin e Komisionerit për gjobë në vlerën 500 000 lekë sipas nenit 173, pika 3? Na thuaj njëherë çfarë lidhje ke me partinë? Pra ke ndonjë autorizim nga kryetari, nga ndonjë organ i partisë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Jam nënkryetari i “Partisë Aleanca Demokristiane”.

Z. L. Braho: Nënkryetari, ka nënkryetari i partisë të drejtë për të përfaqësuar partinë në raport me të tretët?

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Patjetër.

Z. L. Braho: Apo është standard i vendosur tani?

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Partitë e vogla njihen me njëri-tjetrin.

Z. L. Braho: Dakord. Shkurtimisht çfarë mendimi keni për propozimin e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë 500 000 lekë? Ju e keni për mosparaqitje të raportit financiar, për fushatën brenda afatit ligjor, pika 3.

Znj. J. Josifi: Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave të formatit.

Z. L. Braho: Në shkelje të formatit të standardizuar.

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Ne një raport financiar, e kemi paraqitur, ndoshta nuk ka qenë pdf, në excel ose si janë. Për subjektin tonë është paraqitur një raport, me shpenzimet përkatëse, zërat, çfarë kanë qenë zërat, për subjektin tonë. Domethënë kemi paraqitur raport.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Pra ju pretendoni se e keni në formatin dhe në standardin e përcaktuara nga KQZ-ja?

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Po.

Z. L. Braho: Administrata e KQZ-së në lidhje me këtë çështje? Pra mund të na thoni cila është shkelja në rastin konkret sepse palët pretendojnë se e kanë depozituar sipas standardeve dhe formatit?

Znj. J. Josifi: Është dorëzuar raporti financiar i partisë për të ardhurat dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore por ndërkohë mungojnë raportet e kandidatëve të listave shumemërore për këtë parti, prandaj është propozuar ky sanksion.

Z. L. Braho: Dakord.

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Mund të them diçka për kandidatët?

Z. L. Braho: Ka qenë pjesë e ndonjë koalicioni partia apo jo? Ka kandiduar më vete me listat shumemërore? S'ke informacion.

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Po.

Z. L. Braho: Mund të më thuash për kandidatët?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. I. Zhalaj, përfaqësuesi i PAD: Për partitë e vogla është gati e pamundur kjo, për kandidatët, çdo këshilltar, kryesisht këshilltarë, për partitë e vogla. Ndoshta në momentin e pranimit si kandidat ose mund të vijë ndonjë rregull që të pranohet.

Z. L. Braho: Rregullat nuk i vendosim ne. Ne po gjykojmë kërkesën e Komisioneri, prandaj ju pyeta dhe pretendimi që dha administrata e KQZ-së për Komisionerin në këtë rast është se nuk keni paraqitur raportin për kandidatët për listat shumëmemërore dhe ju e pranoni këtë fakt që s'keni paraqitur një raport të tillë për shkak se jeni parti e vogël. Dakord. Vazhdojmë me tjetrën, "Partia Aleanca Liberale e Djathtë", ka përfaqësues? Nuk ka. "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare"? Nuk ka. "Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane"? Nuk ka. "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet"? "Partia Aleanca Progresiste" LZHK? Ju ishit për?

Z. G. Apostoli, kryetar i PADS: "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet"?

Z. L. Braho: Po, "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet". Atëherë edhe për ju Komisioneri ka propozuar një gjobë në vlerën 500 000 lekë sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor për arsye se nuk është paraqitur raporti financiar sipas standardeve dhe formateve të përcaktuara nga KQZ-ja.

Z. G. Apostoli, kryetar i PADS: E kam unë apo jo? Ne i kemi dorëzuar në kohë, raportin financiar për zgjedhjet vendore dhe brenda datës 14 maj 2023, për datën 14 maj 2023 që është depozituar në KQZ me datën 9.10.2023, nr. prot 7146 si dhe me një email në adresën e Krist Pulerit, kqz.gov.al.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Dëgjo nuk është problemi te afati në rastin tuaj, nuk është gjoba, nuk propozohet për afat, për shkelje afati po propozohet për shkelje të standardit në formatin e miratuar nga KQZ-ja apo jo?

Znj. J. Josifi: Sërish e njëjta arsye është mosdorëzimi i raporteve të kandidatëve të listave shumemërore, të cilat duhen dorëzuar bashkëlidhur raportit të partisë përkatëse politike. Është i njëjti konstatim.

Z. L. Braho: E kuptuat? Nuk ka të bëjë me afate?

Z. G. Apostoli, kryetar i PADS: Sigurisht që e kuptuam, po s'na vjen mirë domethënë, që njerëzit që nuk e njohin këtë situatë, të biem në të tilla, që unë e quaj një kurth politik. Megjithatë nuk dua ta zhvilloj më tepër këtë gjë. Problemi është, që është tërësisht e porealizueshme, kjo ka të bëjë me iniciativat e fshehta që kanë ndërmarrë për të zhdukur partitë e vogla, për të çarë pluralizmin politik e për ta shuar dhe pa dashur ta zhvilloj më tepër këtë gjë, në parti që s'marrin asnjë lekë. Domethënë t'ju kërkosh 3 milionë lekë, edhe kryetari, ai që ka marrë iniciativën, nuk dua të them për ju. Urdhëro, është milion, sa e thashë unë, po s'ka gjë e ula vetë një çikë. Problemi është që se përveç emocioneve ne duhet të kuptojmë të vërtetën këtu dhe që të marrim një hap të tillë tamam. Kështu që sa për atë, standardet për partitë e vogla, kthehen në barcaleta, tani unë jam marrë shumë me politikë, me një fjalë e njoh me të gjitha që nga e vogla deri te e larta, por megjithatë ne kemi bërë maksimumin që mund të bëjmë në këtë gjë. Ne nuk është se kemi shtabe apo situata ku të rreshtohen të gjithë ekonomistët me një përgatitje të shkëlqyer apo platforma që ata krahas punës së tyre bëjnë edhe punën e partisë, për aq sa munden, por mendoj që duhet të merret një hap që të anulohet ose një

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

mirëkuptim me z. Komisioner për arsye se kjo është tërësisht e pamundur. Ne kemi bërë të pamundurën për këtë gjë. Domethënë s'po ankohe mi, janë ankuar na vodhën votat e kështu, po.

Z. L. Braho: Të paktën të mos ju marrin lekët!


Z. G. Apostoli, kryetar i PADS: Çfarë lekësh!

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Po, ka një pyetje kolegu Çefa.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Unë kam një pyetje, domethënë edhe për ta pasqyruar siç duhet në procesverbal dhe kjo vlen edhe për argumentat e të gjitha partive që janë në këtë linjë, domethënë të sanksionimit. Pra ju thoni që ne si parti të vogla, duke qenë se jemi parti të vogla e kemi të pamundur t'i deklarojmë. Atëherë a mund të ma specifikoni pak, pamundësia ku konsiston? Nuk gjeni njerëz, nuk keni para për të paguar dikë kompetent për të bërë apo nuk dini, apo?

Z. G. Apostoli, kryetar i PADS: Partia e vogël është siç vjen nga dimensionet që ka. Ne nuk mund të themi që nuk kemi njerëz, po problemi është që ne kemi njerëz shumë cilësorë. Problemi është që kur fillojnë kemi shumë vështirësi në regjistrimin e njerëzve, domethënë që të mbushësh listën është një vështirësi në këtë drejtim, nuk është një dyndje e madhe. Problemi është që mbajtja e partive të vogla është një mbajtje e pluralizmit në këtë sens dhe ne shqyr që arrijmë të kontaktojmë. Për shembull unë nuk dua, po të bënim ndonjë debat politik që të kishte dhe nga ata të tjerët që vidhnin votat, kështu që mund ta bënim po me ju nuk

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

bëjmë dot një gjë të tillë sepse ju keni këtë standard që ka dhënë Komisioneri, por kaq.

Z. E. Çefa: Dakord. Jo duhet me pasë pak debat me sinqeritet, por unë di dhe këtë, ju mund ta keni në konsideratë ndoshta dhe për herët e tjera në vijim, për mënyrën se si ngrini burimet. Në KQZ stafi është lehtësisht i aksesueshëm edhe për asistencë në plotësimin e këtyre. Pra domethënë, nuk ju kërkohet ndonjë sforco kolosale për të zbatuar dispozitën urdhëruese të ligjit sepse ligji në këtë pikë është i qartë. Domethënë ne mund të diskutojmë sa të duam jemi parti të vogla, absolutisht keni të drejtë, edhe ju i jepni kolor absolutisht spektrit politik shqiptar, por detyrimet ligjore janë detyrime ligjore dhe këtë ma merrni dhe si sygjerim, administratën e KQZ-së e keni këtu. Shpeshherë ndoshta mund të jenë shumë më të lehta gjërat se sa dhe ju e mendoni, mbase nuk ka nevojë të punësoni dikë, me një rrogë shumë të madhe për një shërbim që mund ta marrësh duke kërkuar asistencën e sektorëve specifikë në KQZ, pra këtë jam duke thënë. Nuk është argument, nuk kemi mundësi se jemi të vegjël, atëherë.

Z. G. Apostoli, kryetar i PADS: Ne s'mund t'i themi dhe të gjitha gjërat, domethënë bëhet fjala për listat ose më saktë për pasqyrat e përpiluara nga kandidatët. Ne po marrim dhe pjesën e kandidatëve fitues, që kanë fituar te ne, kanë fituar 5-6 veta në të gjithë Shqipërinë. Po problemi është që raportimi domethënë i shpenzimeve, që janë shpenzimet e tyre, shpenzime nga xhepat e tyre, jo nga xhepat e mi. Ata tregojnë qoftë pakujdesi po dhe një pjesë e madhe që kanë marrë pjesë dhe s'kanë fituar, ata e neglizhojnë fare. Nuk mund të shkojnë tani kur shtrojnë një drekë për shembull, bëjnë një drekë dhe gjatë drekës bëjnë dhe propagandën, që ta themi tamam muhabetin. Fushata është, fut tjetri paratë dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

ikën bën pallatin, por që të flasim tamam, për fushata tamam, që po futen në burgje tani, s'dua të shkoj, por po flas për njerëzit që kemi ne, që admistrojmë ne, që disponojmë ne në këtë drejtim. Kjo kërkesë, që thuhet standarde, kjo kërkesë është qesharake në kushtet tona dhe unë me kaq e mbyll.

Z. L. Braho: Faleminderit! Viojmë me propozimin për partinë e radhës “Partia Aleanca Progresiste” LZHK.

Z. R. Vrenozi, përfaqësues i LZHK: Faleminderit i nderuar kryetar e anëtarë të KAS-it.

Z. L. Braho: Vetëm ju lutem prezantohuni për efekt procesverbali.

Z. R. Vrenozi, përfaqësues i LZHK: Risaldo Vrenozi, përfaqësues prej viti 2011 pranë Komisionerit zgjedhor dhe me autorizim nga kryetari i “Partisë Aleanca Progresiste” LZHK për zgjedhjet e fundit. Jemi njohur elektronikisht, edhe me shkresë zyrtare për vendimmarrjen dhe për kërkesën për vendosjen e gjobave siç u citua. Shikojmë që në pikën ku ne përfshihemi është konstatuar nga administrata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që janë 12 kandidatë në listat shumemërore për këshilltarë bashkish, konkretisht në Bashkinë Cërrik, Dropull, Has, Klos, Korçë dhe Lezhë nuk janë dorëzuar 12 deklaratat e këtyre zotërinjve dhe zonjave. Nga ana jonë është menduar se janë dorëzuar të gjitha për sa kohë janë dorëzuar 1500 deklaratat të tjera të kandidatëve që kemi pasur, është një lapsus nga ana e administratës së brendshme të partisë, nuk kemi pasur një njoftim para se të dilte me kërkesë ose me vendimmarrjen se ishte lehtësisht e aksesueshme, mund t'i dorëzonim dhe këto 12 kërkesa. Kështu që në këtë pikë e kundërshtojmë vendosjen

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

e gjobës, ne e kuptojmë që është në minimumin dhe ajo është minimumi po kërkonim nga ana e KAS-it që të na jepej mundësia t'i dorëzonim dhe këto 12 deklarata, pasi janë dorëzuar afro 1500. Nuk është se s'kemi ndërmarrë nisma apo nuk kemi punuar për të përmbushur detyrimet tona ligjore ose në të kundërt diçka ekstra ligjore në proporcion pasi përbëjnë më pak se 1% të kandidatëve që ne kemi pasur në zgjedhjet e fundit, pasi s'kemi kandiduar në të 61 bashkitë, por janë siç ua përmenda mbi 1500 janë vetëm 12 emra të cilët nuk janë dorëzuar. Kjo ishte i nderuar, faleminderit!

Z. L. Braho: Po e qartë. Administrata e KQZ-së në lidhje me pretendimet e "Partisë Aleanca Progresiste" LZHK është vendim i bazuar që ka të bëjë me lidhur me 12 kandidatët?

Znj. J. Josifi: Po është pjesë e raportit tonë përmbledhës për gjetjet. Në fakt janë dorëzuar raportet, bashkë me raportin e partisë, janë dorëzuar raportet financiare të 1393 kandidatëve të tyre, të listave shumemërore dhe mungojnë raportet financiare për 12 kandidatë. Proporcionaliteti i numrit të raporteve të kandidatëve të padorëzuar në raport me numrin total të kandidatëve apo atyre të dorëzuar nuk përbën një arsye për ne, sepse sasia duhet të jetë një kandidat që mund të ketë, mund të zërë peshën më të madhe në të ardhura që ka përfituar dhe në shpenzime që ka bërë për fushatën përkatëse. Ne nuk jemi gjendje të gjukojmë administrativisht nëse nuk e kemi raportin.

Z. L. Braho: Dakord e kuptoj këtë. Kam një pyetje për procedurën. Pra në momentin që këta i sjellin këto raportet, u lihet ndonjë afat tjetër për plotësim të metash, ku di unë kur mungojnë? Pra në raste të tilla, që janë shkeljet dukshëm të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

vogla, sasiore, pra a është njoftuar në një moment të dytë kjo parti që i mungojnë këta 12 kandidatë apo përgjegjësia mbaron në momentin që ato depozitohen këtu në KQZ?

Znj. J. Josifi: Atëherë me dorëzimin e raporteve financiare nga ana e partive politike brenda afatit ligjor, ato thjesht dhe vetëm në momentin e parë administrohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por ndërkohë i bie të hidhet shorti, i vihen në dispozicion audituesve ligjorë përkatës sipas rezultatit të shortit dhe janë ata që bëjnë një shqyrtim të thelluar me një afat 30 ditor, kur ka volum të madh ata kërkojnë edhe shtyrje të këtij afati të auditimit. Gjatë kësaj periudhe audituesi ligjor vihet në kontakt me partinë politike përkatëse të cilën po e auditon për fushatën zgjedhore dhe ndan me partinë përkatëse edhe projektraportin e auditimit. Ka një proces të dhënies së ndërmjetësimit në këtë moment midis audituesit ligjor dhe partisë politike, për dhënien e shpjegimeve, observacioneve dhe më tej audituesi dorëzon në KQZ raportin përfundimtar të auditimit.

Z. L. Braho: Ka ndonjë provë në rast se LZHK-së, që ka pasur një marrëdhënie të tillë mes audituesit dhe kësaj partie? Që është çuar projektraporti, është konstatuar mungesa e këtyre 12 deklaratave dhe sërish ka pasur ndonjë refuzim apo pamundësi, pra së pari nga ana e KQZ-së pastaj, sepse ju duhet ta dini, audituesit pra?

Znj. J. Josifi: Është dërguar projektraporti dhe më pas është dorëzuar edhe raporti përfundimtar. Nga ana tjetër, kur administrata e KQZ-së bën raportin përmbledhës të gjetjeve, pra grumbullon raportet e të gjithë audituesve ligjorë, kemi nxjerrë për konsultim përpara projektvendimit të Komisionerit raportin përmbledhës të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

gjetjeve, konkretisht e kemi publikuar atë për konsultim me datën 6 shtator 2024 dhe ndërkohë sikundër e thatë kemi risjellë edhe 10 ditë përpara vendimmarrjes së Komisionerit për konsultim publik tashmë projektvendimin e tij me raportin përmbledhës të gjetjeve bashkëlidhur derisa ka ardhur Komisioneri me vendimmarrjen e tij të përmendur në fillim të seancës të datës 8 dhjetor. Pra, ka pasur nga data 6 shtator deri me datën 8 dhjetor, përpos procesit të ndërmjetëm midis audituesit dhe partisë, një kohë të mjaftueshme për t'u njohur. Kemi pasur raste partish të tjera që gjatë këtij një mujori për shembull e kanë plotësuar listën e dokumentacionit të tyre mungues dhe u është marrë parasysh, sigurisht se qëllimi nuk është vetëm të bëjmë gjetje, qëllimi është t'i adresojmë ato.


Z. L. Braho: Po e kuptoj që nuk është qëllimi. Atëherë përfaqësuesi i LZHK-së në lidhje me këto prapësime të administratës së KQZ-së, pra që ka pasur komunikim audituesi me partinë tuaj, ka pasur komunikim KQZ-ja, pse nuk janë plotësuar në vijim këto?

Z. R. Vrenosi, përfaqësues i LZHK: Ne sapo e kërkuam këtë që të na jepet mundësia siç është dhënë dhe për raste të tjera, siç i përmendi.

Z. L. Braho: Dëgjo sot jemi për gjë tjetër, mundësia sipas tyre të është dhënë më përpara.

Z. R. Vrenosi, përfaqësues i LZHK: Po pra nuk na është vënë në dijeni se në qoftë se do të na ishte vënë, absolutisht që do të kish qenë...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Ky audituesi nuk ka komunikuar asnjëherë me ndonjë përfaqësues të partisë suaj?

Z. R. Vrenozi, përfaqësues i LZHK: Ka komunikuar me ekonomisten e partisë që mban edhe pjesën e financave, por nuk ia ka bërë me dije këtë problematikë sepse ishte lehtësisht e zgjidhshme.

Z. L. Braho: Po sot i ke me vete këto?

Z. R. Vrenozi, përfaqësues i LZHK: Nuk i kam me vete prandaj kërkova kohë që t'i marr dhe t'i dorëzoj.


Z. L. Braho: Po tani ti.

Z. R. Vrenozi, përfaqësues i LZHK: Domethënë na kanë ardhur.

Z. L. Braho: Atëherë dëgjo vijojmë. Dakord atëherë dhe me "Partinë Aleanca Progresiste" LZHK. Vijojmë me "Partia Ardhmëria Shqiptare". Po. Ulu aty te mikrofoni.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Unë megjithëse kisha, s'ka gjë se do t'i sqarojmë dhe në diskutim. Jo vetëm që nuk jam dakord me vendimin e Komisionerit për vetë faktin se ne nuk kemi dijeni për këtë vendim ose akte që nxjerrin nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, është detyrim ligjor, është e drejta e informimit. Kemi një komision kushtetues që paguhet nga taksat e shqiptarve për të drejtën e informimit. Pse nuk na informon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për këtë vendim? Kemi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

ardhur të papërgatitur, kjo është shkelje flagrante e ligjit mbi partitë politike, mbi Kushtetën, mbi të drejtën themelore të njeriut dhe të Konventës Europiane. Pse s'na jepni të drejtë që të shkojmë në gjykatë? "Partinë Ardhmëria Shqiptare" e keni ndëshkuar dy herë radhës, vendimin 38 të qershorit 2024 dhe po e ndëshkoni prapë, përsëri. Ka qenë z. Çefa, të cilin e falenderojmë ta marrin vesh të gjithë që e konstatoi faktin që "Partia Ardhmëria e Shqiptarve" në paraqitjen e informacionit ishte e saktë, e kishte dorëzuar 5 ditë, brenda afatit dhe i kërkoi këtyre, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pse i keni dërguar "Partisë Ardhmëria e Shqiptarve", megjithëse Komisioni mori vendim ndryshe, që la në fuqi Komisioneri, nuk e paragjykoj vendimin, por na jepni të drejtë të shkojmë në gjykatë. Ende, që ta marrin vesh të gjithë këta pjesëmarrës këtu, Ardhmëria Shqiptare nuk ka vendim të zbardhur se është ndëshkuar 600 mijë lekë të reja ose ashtu të vjetra, akoma nuk e kemi këtë vendim të zbardhur. Pse nuk na e dërgoni? Partitë politike janë asete politike kombëtare, i japin ndihmesën, kontributin e tyre në zgjedhje për atë sa kanë mundësi, ky është pluralizmi politik në Shqipëri. Ky është pluralizmi për partitë, pse s'na i jepni të drejtë, të shkojmë në gjykatë të Starsburgut ta zgjidhim përfundimisht?

Z. L. Braho: Zotëri edhe njëherë, të drejtën në gjykatë e ke pas vendimmarrjes së KAS-it sepse kështu e parashikon Kodi Zgjedhor.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Më vjen shumë keq...

Z. L. Braho: Më lër të mbaroj.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: E kam për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që ka të drejtën me ligj.

Z. L. Braho: Ne jemi pjesë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioneri ka bërë një propozim, ai ka propozuar që partisë suaj t'i vihet një sanksion administrativ me gjobë, në masën 500 mijë lekë sepse sipas Komisionerit raportet financiare të depozituara nga ana juaj për zgjedhjet e 14 majit nuk janë në standardet dhe formatet e miratuara nga KQZ-ja.

Z.I. Arapi, kryetar i PASH: Jam dakord me ju.

Z. L. Braho: Ju sot keni të drejtën që të bëni parashtrimet tuaja dhe të thoni pse Komisioneri nuk ka të drejtë për këtë propozim dhe pas vendimmarrjes tonë në qoftë se kjo gjobë do të të rrijë në fuqi, ti ke të drejtën të shkosh në gjykatë.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Na vjen shumë keq, e thashë janë dy raste ne nuk kemi sot raportin e auditimit të këtyre ekspertëve, akoma nuk e kemi, nuk na është dhënë. Ligji e ka të parashikuar. Ligji, në momentin që eksperti mbaron auditimin njofton partinë politike, e cila ka të drejtë që të ngrejë problemet, të diskutojë problemet, të mbrohet, po kështu merr e shih vetëm, vër gjoba, këto e dënuan gjithë Shqipëria, për parti politike.

Z. L. Braho: Ju pretendoni që nuk është respektuar procedura nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk duhen vënë në dijeni asnjëherë këto akte?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Jo, mua s'më janë vënë në dijeni. Pse? Është një ndëshkim, po e përgjithësoj s'është e vërtetë kjo. Është një Fatmira Kastrati, e cila paragjykon, nuk ka etikën minimale të komunikimit me partitë politike. I kam shkuar në zyrë, më tha, m'i hodhi ato letrat, më tha ik, s'më duhet, tha ti je në statusin pasiv. Çfarë më intereson nëse jam në statusin pasiv. Njëherë duhet të di, partinë politike sa e lidh tatimet, çfarë e lidh, unë nuk jam parti parlamentare, që kam fonde dhe i shpenzoj për paga dhe për sigurime shoqërore, s'kanë lidhje partitë politike.

Z. L. Braho: Partia juaj është me status pasiv?

Z.I. Arapi, kryetar i PASH: Më fal, partitë politike kanë lidhje me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ligji i 2017 ka bërë ndryshime dhe është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, domethënë epror, se kam qenë ushtarak dhe dua ta trajtoj kështu këtë problem, e njoh mirë këtë rregull, që komunikon me partitë politike, nxjerr urdhra, udhëzime. Sot nuk kemi një akt administrativ që e detyron ligji mbi partitë politike Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të nxjerrë se si duhet të funksionojë partia politike, se si duhet të komunikojë me institucionet, të drejtën financiare që janë. Megjithëse ajo është një e drejtë e tij që mund të vendosi gjoba, unë nuk jam dakord, unë e kam çuar, ia kam çuar dhe asaj Fatmira Kastratit, gjoba është e dyta herë që ajo ma jep të tillë, nuk na auditoi thotë Partia Ardhmëria Shqiptare sepse është në statusin pasiv, në një kohë që ligji nuk e pengon, në një kohë paguhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, po kjo është anakronike. Unë s'e marr vesh, tani a kemi të drejtë ne apo s'kemi të drejtë, na çoni në gjykatë atëherë, t'i them gjykatës.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Dakord.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Më fal, tani dua të shprehem kështu, kam një rast “Partisë Ardhmëria Shqiptare” i janë mohuar padrejtësisht 2 milionë, afër 3 milion lekë, po na çoni nëpër gjykata, na keni lënë nëpër gjykata, nuk na i keni dhënë fondin e asaj, jo juve, e ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk na ka dhënë fondin e zgjedhjeve, të 30 qershorit.

Z. L. Braho: Dakord, mos të dalim me çështje të tjera se janë shumë palë.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Janë shumë palë.

Z. L. Braho: Dëgjo, për këtë bëj kërkesë Komisionerit.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Tani për sa i përket asaj që kërkon ju, gjobës, ne e kemi.

Z. L. Braho: Nuk e kërkojmë ne gjobën, e ka kërkuar Komisioneri.

Z. I. Arapi, kryetar i PASH: Dakord, ne po e sqarojmë këtu. Nuk e di a tha dhe z. Gaqo, ne e kemi të vështirë, në pamundësi sepse jemi parti politike që s’kemi financime, nuk jemi njësoj. Nuk duhet trajtuar njësoj partia politike që s’merr asnjë qindarkë nga buxheti i shtetit, me partitë politike që marrin miliona, kjo s’është e drejtë. Këtu duhet parë barazia edhe trajtimi prandaj them unë këtu mungon një akt normativ i Komisionerit që duhet t’i trajtojë partitë e vogla njësoj. Çfarë duhet të dërgojmë, pse keq është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të dërgojë me thes

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

letra, që nuk kemi fonde. Çfarë do të denoncojmë ne, çfarë t'u japim? Do na i merrni. Më mirë t'i hiqni partitë politike, çfarë të them unë tani, po hiqi, po hiqi me ligj, jo kështu me gjoba, me dënu gjithë Shqipërinë.

Z. L. Braho: Faleminderit jam i qartë, e the për listat shumemërore.


Z. I. Arapi, kryetar i PASH: S'e di unë flas për veten time.

Znj. J. Josifi: Për sa i përket raporteve të kandidatëve të listave shumemërore, përkatësisht, të mosdorëzimit të asnjë prej raporteve të 348 kandidatëve të regjistruar për listat shumemërore për këtë parti.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! “Partia Bindja Demokratike”, ka përfaqësues? Nuk ka. “Partia Fronti i Majtë”? “Partia Fryma e Re Demokratike”? “Partia Lëvizja Puntore Shqiptare”? “Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare”? “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”? “Partia Nisma Thurje”? “Partia Agrare Ambjentaliste”? “Partia Aleanca Demokratike Shqiptare”? Ju jeni “Partia Agrare Ambjentaliste”? Po ju? Kthehem pastaj. Vazhdojmë me “Partinë Agrare Ambjentaliste” që po ashtu është propozuar gjobë në vlerën 500 000 lekë sipas nenit 173, pika 3 për çështjen e mosdorëzimit sipas formatit të standardit të miratuar nga KQZ-ja. Vetëm shkurtimisht që të mos biem në përsëritje.

Z. Th. Miço, përfaqësues i PAA: Shkurtimisht sepse pak a shumë janë probleme që dalin për të gjitha partitë. Në parim do të thosha partitë e vogla me këto gjoba ndëshkohen, ndëshkohen në mënyrë jo profesionale, di të them që qëllimi i gjobës është që ne të ndërëgjegjësohemi, funksionarët e partisë ose të zgjedhurit, kandidatët

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

dhe partinë kryesisht me qëllim që të ketë transparencë me fondet, këtu nuk bëhet fjalë për transparencë fondesh, partitë nuk kanë fonde. Këshilltarët me paratë e tyre mundohen domethënë ose me kursimet e tyre mundohen të bëjnë një fushatë me qëllim që të marrin pjesë në këtë garë elektorale. Pra në këtë kuptim e kemi të gjithë të qartë, që partitë e vogla ndëshkohen. Aktualisht për “Partinë Agrare Ambjentaliste”, ne kemi një problem vetëm me Burrelin, pra është një moskomunikim i drejtë ose një tërheqje vëmendje, t’i sjellim edhe këto pra ne jemi munduar që në gjithë territorin shqiptar, me rreth 2000 e ca shqiptarë të jemi korrekt dhe i kemi bindur ata. Duhet të kemi parasysh dhe nga ana konceptuale kur i thua tjetrit deklaro ose nxirr një llogari, kur ai nuk i jep asnjë qindarkë, ai fillon e dyshon, thotë për çfarë bëhet fjalë tani, këtu nuk dua të kandidoj fare, pra duhet ta marrim dhe këtë si masë që ne duhet të jemi njerëz që të edukojmë ata me këtë kontroll, me këtë rregull, pra të mos ndëshkohemi fillimisht, po kjo të jetë një masë dhe një mësim i mirë për të gjithë partitë e vogla të cilat në pamundësi për ta bindur dhe një këshilltar ose një kandidat, ta vëmë në vazhdimësi që është një detyrim ligjor. Ne nuk i shmangemi detyrimit ligjor. Po diskutojmë këtu që e kemi zbatuar ligjin apo s’e kemi zbatuar, atë që mund të themi është që KQZ-ja të mos i shikojë partitë e vogla duke zbatuar Kodin Zgjedhor, gjërmë për gjërmë se po të jetë për detyrime, për të drejta e zbaton ajo, po për detyrimet për financime siç e tha zotëria pak më parë nuk na ka dhënë asnjë kokërr leku, as para zgjedhjeve, as pas zgjedhjeve duke u justifikuar me mënyra nga më të ndryshmet, prandaj themi që merreni këtë kërkesë nga ana e partive të vogla dhe kundërshtoni këtë kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si një masë e cila nuk është profesionale dhe një masë që nuk i ndërgjegjëson partitë por i ndëshkon ato dhe i nxjerr jashtë lojës politike.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë nga KQZ-ja për sa, për çfarë bëhet fjalë konkretisht? Se zotëria përmendi Bashkinë e Burrelit.

Znj. J. Josifi: E njëjta gjë, ka dorëzuar raportet financiare për 1674 kandidatë të listave shumëmemërore, mungojnë raportet e 58 kandidatëve të listave shumëmemërore.


Z. L. Braho: Dakord, kjo është shkelja?

Znj. J. Josifi: Po, kjo është.

Z. L. Braho: Faleminderit! Vazhdojmë, “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë”.

Z. E. Abazi, kryetar i PADSH: Faleminderit! Eduard Abazi, Kryetar i “Partisë Aleanca Demokratike”. Edhe te kërkesa që kam bërë, kam pasqyruar elementët që mendojmë që do t’i kujtojmë pjesën, pa u zgjatur. Kemi dorëzuar materialin sipas formatit që kërkon KQZ-ja por në hard copy, në pamundësi të sistemit për ta plotësuar tek faqja e tyre që kishin. Dorëzimi është bërë brenda afatit, madje tek faqja e fundit, e materialit të dorëzuar në KQZ shoqërohet me materialin, “Aleanca Demokratike Shqiptare”, raport financiar për zgjedhjet vendore dhe thotë sipas raportimeve dhe deklarimeve të kandidatëve të listave për këshilltar bashkiakë, në ato bashki ku kemi kandiduar, kryesisht në Dibër, Bulqizë, Has, Këlcyrë, Klos, Kukës, Librazhd, Maliq, Mallakastër, Pogradec, Përrenjas, Pukë, Selenicë deklarojnë me përgjegjësinë e tyre se nuk kanë kryer shpenzime për fushatën zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 dhe nuk kanë pasur financim nga buxheti i shtetit, as nuk kanë marrë donacione nga persona apo kredi për fushatë.


*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Në kushte të tilla, pas datës së dorëzimit të materialit nuk kemi marrë asnjë kontakt dhe nuk kemi pasur asnjë kontakt ju lutem, asnjë kontakt, nga KQZ-ja. Vetëm pas disa muajsh, siç e trajtuan edhe kolegët, madje në ndërhyrjet që bëtë ju bashkë me z. Çefa, kemi marrë kontakt me audituesin, me znj. Aida Nuri, e cila është pritur nga ne, është sqaruar dhe ka kërkuar një deklaratë përmes së cilës në 21 shkurt i është dorëzuar asaj sipas formatit që donte ajo, që duhet të deklaronim kopjen e deklaratës e kemi, natyrisht kam mbajtur kopjen time që i ka ardhur KQZ-së si auditues dhe në gjithë raportin prej 200 faqesh të gjetjeve Aleanca Demokratike përmendet vetëm tek rasti që është depozituar në hard copy material dhe në raportin që ka thënë audituesja, thotë “Për Partinë Aleanca Demokratike Shqiptare audituesi është shprehur me opinion pa rezervë duke konstatuar se subjekti zgjedhor ka dorëzuar pranë KQZ-së raportin financiar në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet vendore. Gjatë procesit të auditimit të raportit financiar të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjekti zgjedhor u konkludua që nuk ka pasur fonde të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023”. Edhe këtë e ka parë, e ka marrë audituesi dhe e ka dorëzuar në KQZ. Në kushte të tilla po ju them paraprakisht që pas dorëzimit të raportit financiar ne nuk kemi pasur kontakt për këtë problem dhe asnjë dijeni, veçse përmes njoftimit nga kolegët, me një material të shpërndarë me 15.10.24, që është vendimi që njofton subjektet. Ka dhe një listë të subjekteve, tre faqet e para tek e cila Aleanca Demokratike nuk është dhe në vijim të materialit brenda, të vendimit jam vënë në dijeni dhe ndaj kam reaguar duke bërë dhe ankesën përkatëse. Aty thuhet për Aleancën, për atë ndëshkim që është vënë me gjobë. Kam marrë kontakt unë, nga KQZ-ja. Kam ardhur unë kam bërë kontakt përpara se të bëja ankimimin dhe ata më thanë rruga e zgjidhjes së kësaj është ankimimi që kemi nisur për në KAS. Unë gjykoj e para njëherë, që shumë u arsyetua nga KQZ-

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

ja, më fal, mirë thashë nga KQZ-ja që bëhet fjalë për fondet e përfituara dhe të shpenzuara. Ne nuk kemi fonde të përfituara, ne e kemi deklaruar dhe e deklarojmë nuk kemi shpenzuar realisht dhe një gjë po them shumë sinqerisht për sa ne i vëmë ata kandidatë, me ato bashki që kishim mundësi të kandidonim, ne kemi kontaktuar me ta, nuk është se kudo ka vështirësi dhe për partitë e mëdha, nuk themi që është e pamundur dhe shpenzimet nuk kemi bërë realisht sepse të jemi të sinqertë ne në fushatën një mujore monitorohemi nga monitoruesi dhe ai e ndjek gjithë aktivitetin e njerëzve tanë në bashkitë ku kandidojmë. Nëse ka ndonjë informacion që ne kemi fshehur ose nuk kemi deklaruar jemi plotësisht dakord sepse këto janë masa shtërnguese ose detyruese në zbatim të ligjit. Plotësisht dakord jemi se ligji nuk i bëni as ju as ne, natyrisht ata q janë, që kanë fuqinë ta bëjnë atë. Pra dhe tjetrën, për të bashkëpunuar me KQZ-në është shumë interesante, për të mos bashkëpunuar janë marrë masa 100 000, 200 000, 300 000 dhe për një mungesë. Unë e kam deklaruar, nuk kam asnjë raport, të ndonjë subjekti ose kandidatëve janë masa ndëshkimore që fillojnë mbi 500 000. Nëse ata që e kanë fshehur ose e kanë bërë, nuk kanë bashkëpunuar etj, etj, kanë mundësi që të përfitojnë, kurse për subjektet e vogla është një penaltet në gjykimin tim, në qoftë se do të qëndrohet, masa le të jetë sipas ligjit por të jetë i barabartë ligji për të gjithë subjektet. Ju faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Për këtë rast konkret çfarë shkeljesh keni konstatuar?

Znj. J. Josifi: Është administruar raporti financiar edhe pse ai është dorëzuar fizikisht dhe jo nëpërmjet sistemit, të platformës elektronike, pra nuk është propozuar sanksion për këtë. Mungojnë raportet e 414 kandidatëve të listave shumemërore.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Nga sa apo?

Znj. J. Josifi: 414 ka pasur gjithsej.

Z. L. Braho: Pra, s'ka depozituar asnjë.

Znj. J. Josifi: Po.

Z. L. Braho: Dakord.


Z. E. Abazi, kryetar i PAD: Ndjesë, nëse do të kisha, në momentin që kam dorëzuar dhe informacionin që shoqëron është pjesë e materialit informues që u ka ardhur në raportim do të thoshit që duhet të sillen dhe për këta individë dhe nuk do të përgjigjesha, do të ishte problem tjetër. Komunikimin me KQZ-në e kam shumë korrekt, pavarësisht se ka pretendime që ka mundësi, s'ka mundësi.

Z. L. Braho: Nuk je ndëshkuar për mungesë korrekte.

Z. E. Abazi, kryetar i PAD: Jo të lutem dhe njëherë, nëse do të kisha dijeni që duhet plotësuar diçka nga mangësitë në momentin që kam dorëzuar raportin financiar ose qoftë nga audituesi dhe të mos përgjigjesha atëherë mbetet përgjegjësia ime. Unë ju thashë kush është raporti i audituesit.

Z. L. Braho: Dijenja është nga ligji. Megjithatë vijojmë, "Partia Balli Kombëtar" ka? S'ka. "Partia Demokracia Sociale"? Po ju lutem afrohuni te mikrofonin. Edhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

për ju është propozuar gjobë në vlerën 500 mijë lekë për shkak të mosplotësimit të standardeve dhe formatit të miratuar nga KQZ-ja për financim.

Z. S. Nazaj, përfaqësues i PDS: Duam të theksojmë se “Partia Demokracia Sociale” ka dorëzuar sipas rregullave dhe afateve raportin financiar në përputhje me vendimin nr. 18 të datës 7.04.2023 i Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave dhe raportimin financiar të partive politike të subjekteve zgjedhore”, neni 3, pika 1 dhe vendimi nr.458, datë 6.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për raportin financiar në platformën elektronike të raportimit financiar, të subjekteve zgjedhore”. Ne i kemi dorëzuar këto edhe elektronikisht, po edhe nga auditi që ka dërguar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në lidhje me raportin financiar, të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për të cilat ne kemi këto sanksione, në mënyrë të përsëritur ka udhëzuar të gjithë kandidatët dhe u ka rikujtuar për dorëzimin e këtyre raporteve financiare dhe nga kjo u provua dhe nga fakti se një pjesë e tyre i kanë dorëzuar këto raporte, siç edhe konfirmohet nga vendimi i Komisionerit. Vendimi nr.15, i datës 7.04.2023, neni 8, pika 2, i Komisionit Rregullator thotë që është detyrim dhe përgjegjësi e kandidatit që të dorëzojë këto raporte në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jo i subjektit zgjedhor. Pavarësisht sa më sipër një pjesë e madhe, i referohem sikur i kanë dorëzuar këto. “Partia Demokracia Sociale” përveç detyrës së saj për të udhëzuar këta kandidatë, për të kryer raportin financiar, nuk ka pasur asnjë mjet tjetër në dispozicion për të verifikuar dhe bërë të mundur plotësimin e këtij detyrimi nga kandidatët. Në çdo rast dhe siç mund të vërtetohet nga raporti financiar i “Partisë Demokracia Sociale” shpenzimet e fushatës së kësaj partie kanë qenë minimale dhe vetë kandidatët të cilët kanë dorëzuar raportin financiar, nuk kanë kryer shpenzime financiare për këtë fushatë ku dhe i kanë referuar. Për sa më lart

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

kërkojmë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve shfuqizimin e këtyre sanksioneve nga Komisioneri.

Z. L. Braho: Faleminderit! Po.

Znj. J. Josifi: Atëherë “Partia Demokratia Sociale” ka të regjistruar 1486 kandidatë në listat shumemërore, nga të cilat 1369 nuk e kanë dorëzuar raportin financiar, pra vetëm 117 prej tyre e kanë dorëzuar raportin financiar. Sa i takon vendimit të Komisionit Rregullator që përcakton rregullat për raportimin financiar për shpenzimet dhe të ardhurat e fushatës zgjedhore, përkatësisht neni 8, që zotëria citoi, kandidati i listës, që kandidatët i dorëzojnë raportet në KQZ. Në fakt pika 1, neni 8, “Kandidati i listës shumemërore dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrimin të informojë në mënyrë periodike financierin e partisë politike/financierin e partisë udhëheqëse të koalicionit për të ardhurat dhe shpenzimet e kryera pre tyre si dhe detyrimin të ndjekë udhëzimet e këtij të fundit”. Pika 2, “Kandidati i listave shumemërore si dhe kandidati për kryetar bashkie ka detyrim të dorëzojë tek financieri sërish i partisë brenda 30 ditëve nga data e zgjedhjeve raportin financiar të shoqëruar me dokumentat justifikues për fondet e përfituara dhe të shpenzimet e kryera prej tij”. Vijon, dokumenton, regjistron vlerat e fondeve, në rastin që ka të tilla. Nga ana tjetër sërish vendimi i Komisionit Rregullator përcakton në nenin 7 përgjegjësitë e financierit të partisë politike. Përkatësisht lidhur me administrimin e raporteve financiare të kandidatëve, në pikën 4 të nenit 7, financieri i partisë politike mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë e tij duke dhe, janë listuar një sërë detyrimesh, shkronja “d”, pikës 4, administruar të gjithë veprimtarinë financiare për fushatën zgjedhore të kandidatëve të listave shumemërore, të vënë në dispozicion nga këta të fundit. Pika

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

5 e po këtij vendimi thotë “Financieri kontrollon të gjitha burimet e të ardhurave”, pika 6 “Financieri mban përgjegjësi për dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët e listave shumemërore të kandidatëve për kryetar bashkie, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se nuk ka pasur mundësi ose me gjithë përpjekjet e bëra nuk ka arritur të parandalojë apo korigjojë shkeljen e kryer nga kandidati”. Në asnjë nga rastet e sipër cituara për propozimin e sanksioneve për subjektet nuk kemi pasur një arsyetim të tillë dhe qartësisht përgjegjësia i mbetet partisë politike, pra financiarit të partisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk administron në mënyrë të drejtpërdrejtë raporte kandidatësh kur ata janë kandidatë të një subjekti zgjedhor, qoftë ky parti, qoftë koalicion. Drejtpërsëdrejti KQZ-ja administron vetëm raportet financiare të kandidatëve të pavarur. Se nuk ka si të jenë pjesë e raportit të kandidatit të një subjekti partie, ose koalicion.

Z. L. Braho: Dakord. Viojmë me “Partia Demokratike e Shqipërisë”, edhe këtu kemi gjobë në vlerën 500 000 lekë sipas nenit 173, pika 3.


Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Franci Nuri, me autorizim.

Z. L. Braho: Po.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Nëse mund t’jua vë në dispozicion edhe administratës së KQZ-së.

Z. L. Braho: Merreni pak autorizimin. Po Franci me pak fjalë çfarë mendimi ke në lidhje me propozimin e Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*


Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Siç dihet në zgjedhjet e vitit 2023 ne kemi pasur pengesa, vështirësi për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Gjithsesi jemi të mendimit që janë respektuar standardet e kërkuara, janë depozituar të gjitha elementët dhe pasqyrat financiare sipas rregullave dhe ligjeve. Kështu që nuk mendoj që ka vend për sanksionim të "Partisë Demokratike të Shqipërisë" në lidhje me këtë aspekt dhe ndaj e kundërshtojmë kërkesën e Komisionerit. Kërkojmë rrëzimin e kësaj kërkesë. Faleminderit!

Z. L. Braho: Po, faleminderit! Administrata e KQZ-së çfarë shkeljesh konkretisht ka nga Partia Demokratike në lidhje me formatin dhe standardin?

Znj. J. Josifi: Atëherë në rastin e Partisë Demokratike kemi dy shkelje, është përkatësisht shkelja sipas nenit 173, pika 3, pra paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave, formateve të standardizuara, 500 000 lekë, si dhe është sërish mosdorëzimi i raporteve të kandidatëve. Përkatësisht 1587 kandidatë ka pasur të regjistruar Partia Demokratike, për të cilët i mungojnë raportet financiare të 1440 kandidatëve, pra vetëm 147, 10% le të themi kështu e numrit të kandidatëve e kanë dorëzuar raportin financiar. Lista shumemërore, sërish kandidati i listave shumemërore. Pra është i njëjti trajtim, le të themi në propozimin e sanksionit si për partitë e vogla ashtu edhe për partitë e mëdha, si për partitë që përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit për të kryer fushatën zgjedhore ashtu edhe për partitë të cilat nuk përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit.

Z. L. Braho: Qartë, dakord. Z. Nuri je i qartë besoj, se për çfarë bëhet fjalë, se mbase ti s'je në koherencë me çfarë ka ndodhur atëherë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po pikërisht atë desha të shpjegoj.

Z. L. Braho: Ka të bëjë me listat shumëmemërore, pra që nuk janë sjellë deklaratat për kandidatët e listave shumëmemërore.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Gjithsesi unë duhet të bëj detyrën dhe të mbroj subjektin “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Z. L. Braho: Ti nuk mbrohesh dot as me argumentin që je parti e vogël!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo, absolutisht por argumenti është, që prapë është “Partia Demokratike e Shqipërisë” një dhe e pandashme, kështu që ne jemi me idenë që prapëseprapë nuk ka shkelje dhe mendojmë që duhet të rrëzohet propozimi për gjobë, për masë administrative me gjobë në këtë rast. Faleminderit!

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Viojmë me “Partia e Gjellbër”, ka përfaqësues? Po. Keni autorizim apo e keni verbalisht autorizimin? Verbalisht nuk procedojmë dot. Gjithsesi do ta quajmë argumentin. “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”? “Partia Emigracioni Shqiptar”? Është “Partia e Reformave”, dakord, faleminderit! Ju lutem prezantohuni.

Z. Xh. Xhekaliu, përfaqësues i PRSH: Xhemal Xhekaliu, zëvendës kryetar i “Partisë së Reformave Demokratike Shqiptare”.

Z. L. Braho: Po, zotëri faleminderit, shkurtimisht, edhe ju jeni dënuar, propozimi për sanksion administrativ është neni 173, pika 3, pra që ka të bëjë me

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

mosdorëzimin sipas formatit të duhur të deklaratave për financimin e partisë politike tuajën, apo të kandidatëve që kanë garuar në partinë tuaj për zgjedhjet e viti 2023, zgjedhjet vendore. Nuk e di çfarë mendimi keni ju, po shkurtimisht.

Z. Xh. Xhekaliu, përfaqësues i PRSH: Partia jonë është një parti e dalë që nga dhjetori i vitit 2000. Kemi konkuruar pjesë në të gjitha procedurat zgjedhore, si parlamentare ashtu edhe për këshilla bashkiakë. Kemi qenë dhe do të jemi një parti korrekte, sidomos me procedurat dhe ligjet e shtetit. Ne na ka ardhur një gjobë nga auditi, me datë 8.10.2024, një vendim nr.186 i KQZ-së, i cili ka vendosur miratimin e gjetjeve dhe raportit të auditimit të fondeve dhe shpenzimeve, të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Ka propozuar KAS-in, për marrjen e masës administrative për partinë politike “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”, lidhur me këtë ju sqaroj: partia jonë nuk ka kryer asnjë shkelje administrative, as nuk ka abuzuar qoftë me një lek, ne nuk kemi kandidatë për kryetarë bashkie. Ne kemi kandiduar për anëtarë të këshillit bashkiak. Theksoj se çdo kandidat për anëtar këshilli i ka mbuluar shpenzimet me fondin personal, ne si parti nuk jemi financuar nga buxheti apo donatorë të tjerë. Nuk është i saktë vendimi i KQZ-së, ka gabuar Komisioneri. Ka kërkuar për të gjobitur partinë tonë me vlerë marramendëse, nuk e di ku Komisioneri ka konstatuar shkelje apo shpërdorim fondi të marrë? Ne i kemi kërkuar Komisionerit të na paraqesë arsyen e vënies së kësaj gjobe, deri tani jemi pa fjalë. Nuk dimë arsyen e vendosjes së kësaj gjobe. Të nderuar drejtues të KAS-it kërkoj nga ana juaj të bëni një vlerësim të drejtë në lidhje me kërkesën tonë. Përfundimisht kërkojmë shfuqizimin e vendimit nr.186, vendim i marrë nga KQZ-ja si një vendim i padrejtë dhe antikushtetues.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Faleminderit! Administrata e KQZ-së edhe këtu kemi të bëjmë me listat shumëmemërore.

Znj. J. Josifi: 81 kandidatë të listave shumëmemërore për partinë, 81 nuk e kanë dorëzuar raportin financiar.

Z. L. Braho: 81 kandidatë ka pasur gjithsej?

Znj. J. Josifi: Po.

Z. L. Braho: Dakord faleminderit!

Z. K. Bele: Kush është kryetari i partisë?

Z. Xh. Xhekaliu, përfaqësues i PRSH: Kryetari i partisë është z. Krenar Rryçi.

Z. K. Bele: Faleminderit!

Z. Xh. Xhekaliu, përfaqësues i PRSH: Ish deputeti.

Z. L. Braho: Vazhdojmë, “Partia Emigracioni Shqiptar”? Po, shkurtimisht.

Z. K. Papa, kryetar i PESH: Faleminderit! Për t’i rënë shkurt dhe për të mos cekur dhe ato që kanë folur parafolësit do të themi që ne fillimisht edhe pse u regjistruam në zgjedhje mendonim të tërhiqeshim nga zgjedhjet por në fund fare në ditët e fundit na u paraqitën një grup që donin të merrnin pjesë në zgjedhje në një listë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

këshillash dhe e pranuar sepse kishim menduar që do të tërhiqeshim nga zgjedhjet në rreth 20 e ca bashki që marrim pjesë zakonisht si pjesëmarrës. Kështu që e pranuar ata po me mbarimin e zgjedhjeve u larguan dhe nuk paraqitën. Në një situatë kur një parti politike nuk ka marrë fonde publike, kur një parti politike nuk ka shpenzime të fondeve publike, nuk ka marrë as forma të tjera të investimit apo të ndihmës, në një kohë kur tërë audicioni. Ne kemi ndjekur dhe kemi zbatuar sipas rregullave dhe të dokumentacionit, kemi bërë dhe dokumentacionin e regjistrimit të dorëzuar në KQZ, kjo është një, kur i thua këshilltarit ose kandidatit për këshilltar që është nga një zonë ku ndihma sociale është 2000 lekë, ku pensioni i ulët është 8000 lekë dhe kur dëgjon që kryetari i qeverisë thotë që situata, përgjegjësia është personale për një njeri që merr pjesë në qeverisje e më pas përfundon atje ku i takon. Po të bëjmë një, kemi një disproporcion. Përgjegjësia, shiko, këta kandidatë të këtij niveli kam përshtypjen që kanë nevojë për një rregullshmëri akoma ligjore, ka politikë në të cilat është vendi, kjo pasqyrohet, kjo situatë ka lidhje dhe me partitë e vogla politike por dhe me gjendjen reale të qytetarëve të pjesëmarrësve dhe të kandidatëve.

Z. L. Braho: Sa kandidatë keni pasur në zgjedhje ju?

Z. K. Papa, kryetar i PESH: Ne kishim përgatitur për 20 bashki, për lista shumëmemërore, por i tërhoqëm dhe ata morën pjesë në një. Në ditët e fundit na u paraqitën një grup të ardhurish të cilët u larguan sa mbaruan zgjedhjet.

Z. L. Braho: Se ti ke dhe emrin e partisë, “Partia e Emigracionit”, ata vijnë sa kandidojnë dhe ikin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. K. Papa, kryetar i PESH: Po.

Z. L. Braho: Sa kandidatë janë?

Z. K. Papa, kryetar i PESH: Ata jetojnë aty, donin të bënin një provë, ua pranuan, nuk kishte. Është krejt normale, ata pranuan, dhe ne ua pranuan nuk ishte ndonjë gjë.

Z. L. Braho: Faleminderit! Edhe këtu bëhet fjalë për listat shumemërore. Dakord.

Znj. J. Josifi: Listat shumemërore, 32 kandidatë.

Z. L. Braho: 32 kandidatë, një autobuz. “Partia Kombëtare Konservatore Albania”? Edhe ju z. Gjuzi të njëjtën fabul, ku shkoi? Thashë që ike tani që të erdhi radha? Na thuaj çfarë standardi dhe çfarë formati ke shkelur që ka propozuar gjobë Komisioneri për ju?

Z. K. Gjuzi, kryetar i PKKA: Faleminderit z.kryetar! Të nderuar zotërinj të KAS-it, “Partia Kombëtare Konservatore” ka marrë pjesë në katër qytete, ka fituar katër këshilltarë dhe është 50 në lidhje me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve po themi në shkelje ligjore, nëse do ta konsiderojmë kështu, por e para jemi në fushatë zgjedhore, unë s’kam asnjë gjë me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve por ky është një lloj presioni përderisa vimë në KAS për një gjobë 500 000 lekë ose 5 milionë lekë të vjetra. Në këtë rast do të kisha një pyetje, ju jeni të gjithë juristë, jeni ekspertë dhe unë kam konsideratë për ju. Ku do t’i gjejë partia politike Kombëtare Konservatore 5 milionë lekë të vjetra që t’ia japë Komisionit Qendror

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

të Zgjedhjeve? Në rastin hipotetik nëse ne duhet t'i gjejmë, atëherë menjëherë duhet që SPAK të vijë të thotë ku i gjete këto 5 milionë lekë të vjetra, na trego pak? Se duhet t'i çojmë në xhiro në llogarinë, përmes xhiro llogarisë së "Partisë Kombëtare Konservatore", ligji nuk nuk lejon që të marrësh fond më tepër se 1 milion lekë të vjetra, më duket e ka, ky është fakt i parë. Fakti i dytë është ne jemi parti që përbëjmë koloritin e partive politike parlamentare dhe jo parlamentare. Këtu kam problem me kolegët e mi që thonë partia është e vogël, është e madhe, në një garë nuk ka parti të vogël dhe të madhe. Ne kemi penalizim sepse arrijmë të gjejmë përmes atyre që kanë fituar, në rasti konkret Partia Kombëtare Konservatore ka fituar në Klos, në Kukës, në Krumë dhe në Kurbin. Në të katër rastet ne kemi atje një udhëheqës të partisë tonë, të degës tonë. Pra këto katër degë kanë funksionuar më së miri që kanë paraqitur alternativat për të qeverisur në mënyrë vendore, ato që ne i quajmë këshilla bashkiake, në këtë koncept ata vinë dhe thonë sa fonde merr partia, unë jam kryetari i degës, zero fonde merr Partia Kombëtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të gjithë të tjerët që janë në listë janë individë që do të thotë përgjegjësia është individuale, nuk është në grup. E para ne nuk mund të dënohemi në grup si parti politike, e dyta është individuale, u prek këtu edhe nga një nga kolegët tanë, politikanët që janë në sallë, që kandidojnë në mënyrë individuale, ata kanë përgjegjësinë e tyre nëse kanë marrë ose jo fonde, unë s'kam punë me këta. Kam punë me subjektin "Partia Kombëtare Konservatore", e cila në këtë moment i detyrohet shtetit shqiptar 60 mijë lekë të reja, nga gjoba e mëparshme, por kanë kaluar dy vjet dhe ligji thotë mos e paguaj, nëse do të vinte zyra përmbarimore atje ku ne kemi atë bazë të adresës tonë, për një arsye ose një tjetër disa kanë apo jo zyra, i bie që të na marrë kompjuterat, të na marrë telefonin dhe të na marrë çdo gjë ka partia. Pyetja është me çfarë do të kandidojmë ne në zgjedhjet e ardhshme? Zotërinj të Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Zgjedhjeve unë kam konsideratë të lartë për ju, ju lutem, atëherë a do të kandidojë “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, nëse ju do të merrni përsipër të miratoni atë çka kërkuar krye Komisioneri, është e pamundur, se Komisioneri do të thotë paguaj gjobën, në xhiro llogarinë time, ndryshe nuk regjistrohesh në zgjedhje, ky quhet penaltitet. Z. kryetar kërkoj që si nga anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, po pra po pastaj s’ka vëmendje, pastaj prishet protokolli, në këtë koncept unë mendoj që ju si njerëz të përgjegjshëm, ne kemi konsideratë për ju, siç e thashë, z. kryetar i seancës dhe për kolegët tuaj dhe mendoj që subjektet politike që kanë individë në listat e tyre, kanë vështirësinë e hyrjes në zgjedhje nga shumë probleme që kanë me ligjin zgjedhor 2008, edhe me miratimin gjatë kohës që ishim në parlament edhe miratimi i fundit i korrikut. Nëse në Shqipëri kërkohet që të vendoset sistemi dypartiak, unë ju them që dhe në SHBA nuk është dypartiak, janë gati 15 parti politike që kandidojnë dhe këtu në sallë janë të paktën 43-44 subjekte politike që janë pjesëmarrëse aktive në zgjedhje, nga 137 subjekte politike. Ju do të na penalizoni ne, unë mendoj se ju duhet ta rrëzoni këtë kërkesë. Faleminderit z. kryetar, faleminderit të gjithë kolegëve tuaj!

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë administrata e KQZ-së për Partinë Konservatore, cila është shkelja konkrete?

Znj. J. Josifi: Ashtu sikundër e përmendi zotëria, në kuptimin e shkeljes 50 me 50 në raport me ligjin dhe KQZ-në mungojnë raportet financiare të 54 kandidatëve të listave shumemërore, nga 108 kandidatë të listave shumemërore, për këtë parti politike.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Vazhdojmë me “Partia Komuniste e Shqipërisë”, ka përfaqësues? As këta s’i sjellin në rregull këto? “Partia Konservatore”? S’ka. “Partia Kristiandemokrate”? “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorëve të Shqipërisë”? “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”? “Partia Republikane”? “Partia Uniteti Kombëtar”? Deri këtu jemi me sanksionet që janë kërkuar për nenin 173, pika 3, fjalia e dytë. Te 33 kalojmë tek “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” që siç duket është përsëritëse ka dhe gjobë në vlerën 2 milionë lekë kjo do të jetë për çështje afati. S’ka përfaqësues. Kalojmë te “Partia Aleanca Arbënore Kombëtare”, po ashtu ka një gjobë, propozim për 2 milionë lekë, Partia të Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorëve të Shqipërisë 2 milionë lekë, “Partia Komuniste e Shqipërisë”, prapë 2 milionë, “Uniteti Kombëtar”, 2 milionë. Tani për ta kuptuar ne, pavarësisht se s’ka palë, se shoh që një pjesë e partive janë dhe te propozimi për 2 000 000, janë dhe te propozimi për 500 000. Këta kanë shkelur afatin apo s’i kanë sjellë fare?

Znj. J. Josifi: Ne jemi bazuar në shkeljen e nenit 173, pika 3 sepse nuk e kanë paraqitur raportin brenda afatit ligjor, madje nuk kanë paraqitur fare raport.

Z. L. Braho: Po mirë tani, për të qenë të qartë, një që nuk sjell fare raport gjobitet dhe për të mos sjellë fare raport dhe për shkelje standardi?

Znj. J. Josifi: Atëherë raporti financiar përmban raportin financiar të partisë, se vetë partia apo subjekti zgjedhor mund të gjenerojë të ardhura, ashtu dhe të kryejë shpenzime dhe janë tjetër gjë raportet e kandidatëve për kryetar bashkie në këtë rast apo të listave shumemërore, pra njëra nuk implikon tjetrën domosdoshmërisht sepse ka pasur kandidatë të partive të mëdha për shembull për kryetar bashkie që

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

kanë deklaruar që kanë bërë zero shpenzime sepse thotë se shpenzimet i ka mbuluar subjekti zgjedhor përkatës, ashtu sikundër ka subjekte që deklarojnë shpenzimet.

Z. L. Braho: Dakord po këtu jemi në rastin që këta s'kanë sjellë fare, as për partinë, as për kandidatët.

Znj. J. Josifi: Po. Ato parti që përsëriten në listën e parë me këtë listë të dytë kanë këtë.

Z. L. Braho: Tani ma shpjego pak çfarë standardi kanë shkelur këta?

Znj. J. Josifi: Grupi i parë...

Z. L. Braho: Jo grupi i dytë, këto që kanë këtë dy milionë lekë, që s'kanë sjellë asnjë gjë.

Znj. J. Josifi: Atëherë afati ligjor për të paraqitur raportin financiar për fushatën zgjedhore është 16 ditë pas daljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, në këtë rast rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 14 majit, ka dalë në datën 7 gusht të vitit 2023, që do të thotë afati ligjor i secilit subjekt zgjedhor për ta dorëzuar raportin në KQZ ka qenë data 10 tetor 2023. Nuk kanë dorëzuar raportet.

Z. L. Braho: Dakord. Këta i kanë sjellë pas 10 tetorit, s'i kanë sjellë fare? Si?

Znj. J. Josifi: S'i kanë sjellë fare.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: S'i kanë sjellë fare. Në qoftë se s'kanë sjellë asnjë letër në KQZ, pse duhet të gjobiten dhe për shkelje standardi dhe formati? Kjo është pyetja. Pra dakord me dy milionë, ky është. Pse duhet të marrë gjobë edhe për shkelje formati, njësoj si këto partitë e tjera që kishin tre kandidatë në listat shumëmemërore pa sjellë letra.

Znj. J. Josifi: Shkelja e formatit e përmendur në sanksionin e llojit të parë nuk lidhet me formatin në kuptimin e formatit të tabelës, lidhet me mungesën e raporteve financiare të kandidatëve bashkëlidhur raportit të partisë.

Z. L. Braho: Po pra, po ky s'ka sjellë asgjë fare.

Znj. J. Josifi: Ka sjellë por mund të kishte sjellë raport të partisë.

Z. L. Braho: A pra ju thoni...

Znj. J. Josifi: Dhe raporti me zero të ardhura dhe zero shpenzime duhet të sjellë në KQZ, se nëse nuk e vetëdeklaroi, audituesi ligjor nuk ka cilën pasqyrë financiare të auditojë, nuk ka si të qaset ndaj llogarisë dhe të verifikojë realisht që ky subjekt e ka zero shpenzimin dhe zero të ardhurën në llogarinë e posaçme, ashtu sikundër ka deklaruar në pasqyrën e vet financiare.

Z. L. Braho: Dakord. Atëherë e lamë tek 38, "Partia Aleanca për Barazi", "Partia Lëvizja Punëtore", "Partia Konservatore", "Lidhja Demokristiane Shqiptare", "Reforma Demokratike", këta s'kanë përfaqësues, e kanë gjobën një milion lekë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Tani kalojmë tek kandidatët për kryetar bashkie. Z. Arif Tafani, vetë kandidati ka përfaqësues? Armando Subashi? Emirjana Sako? Dakord. Ju lutem.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Të nderuar anëtarë të trupës!

Z. L. Braho: Ju jeni me prokurë të posaçme?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Me prokurë të posaçme.

Z. L. Braho: Dakord.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Po e depozitoj. Atëherë parashtrimet lidhur me rastin e zonjës Emirjana Sako i kam përgatitur me shkrim, për ekonomi gjyqësore po përmbledh pikat kryesore të tyre dhe më pas do t'jua vë në dispozicion parashtrimin. Atëherë znj. Emirjana Sako është gjobitur në vlerën 75 859 lekë dhe më pas detyrohet kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së sipas nenit 173, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Është pika 45 e vendimit që jemi duke shqyrtuar. Sa i takon parashtrimeve thelbi i tyre qëndron në faktin që znj. Emirjana Sako, në fakt, në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit të Rregullatorit, nr.9/2022 ka paraqitur raportin financiar brenda afatit të kërkuar ligjor dhe më pas raportin e auditimit që është bërë dhe nga gjetjet e audituesit ka rezultuar se znj. Emirjana Sako ka shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimet për këtë Rregullatori, sa i takon vlerës 75 859 lekë, pasi trajtohen si dhurime që ajo i ka bërë vetes. Referojmë se kjo gjetje e audituesit, më pas e miratuar dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vijon në respektim të frymës së legjislacionit dhe praktikës gjyqësore për sa kohë që e konsideron një shkelje të dhurimit të bërë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

ndaj vetes nga znj. Emirjana Sako. Që një kandidat të aplikohet neni 173, pika 5 e Kodit Zgjedhor duhet të plotësohen tre kushte akumulative, që ai duhet të ketë pranuar fonde private, këto fonde private duhet të jenë me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë dhe duhet të jenë pranuar përmes formave të tjera dhe jo llogarisë bankare. Tani të dyja këto dispozita, lidhet konkretisht me nenin 91, 91/2 dhe 92/2, të Kodit Zgjedhor, i cili trajton literalisht rastet kur kandidati për kryetar bashkie në këtë rast merr fonde nga një person fizik apo person juridik, pra nuk trajton rastet kur kandidati financon me të ardhurat e tij fushatën zgjedhore. Në rastin në fjalë siç provohet nga vetë parashtrimi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka bërë në relacionin e tij, ai i dhuron vetes dhe nuk ndodhemi para rasteve që parashikon vetë Kodi Zgjedhor, që janë neni 92/1 dhe 92/2, i tij sepse realisht koncepti dhurim vetes në të drejtën civile nuk njihet fare si i tillë dhe në këtë rast është një nocion abstrakt që unë nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë me thënë të drejtën, por që këtu jemi duke diskutuar. Vetë vendimi nr.13 i datës 4.02.2022, të Komisionit Rregullator, në fakt përcakton tre mënyra se si mund të bëhet financimet e fushatës zgjedhore që janë katër, janë fondet shtetërore, financimi nga burime vetjake të subjektit zgjedhor, dhurime nga burime jopublike, private, huatë ose kreditë e marra nga partitë politike apo kandidatët e tyre dhe qartësisht në këtë vendim shpjegohet se financimet nga burimet jopublike, private, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, personat fizikë apo juridikë vendas dhurojnë fonde. Pra në frymën e gjithë formave të mësipërme dhe të Kodit Zgjedhor, projektvendimi i Rregullatorit dallon qartësisht rasti se kur financimi bëhet nga subjekte private apo publike jemi para dhurimit dhe në rastin konkret kur kandidati apo subjekti zgjedhor pranon fonde të dhuruara duhet të hapet llogari bankare që të kalojë këto fonde dhe ligjvënësi ka qenë mjaft i qartë në rastin e këtij parashikimi dhe nuk mund të ketë një ekuivok që të ngatërrojmë nocionin e dhurimit me nocionin e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*


financimit nga burimet e vetë subjektit. Referuar dhe të drejtës civile siç e përmendëm, dhurimi është një veprim juridik që në fakt kërkon gjithmonë dy palë dhe nuk mund të pretendojmë për dhurim ndaj vetes siç Komisioneri referon me aktin e tij. Vihet re se në raportin financiar si të znj. Emirjana Sako, po edhe të tjerëve që më pas ata kanë plotësuar një formular, një formular tip dhe formulari përcakton si dhurues veten dhe ata e kanë marrë formularin dhe e kanë plotësuar në formën që u ka ardhur. Duket që është një plotësim gabim nga kandidatët, por kjo nuk përbën shkak që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ta konsiderojë si dhurim ndaj vetes këtë shumë dhe për të gjitha faktet e parashtruara kërkojmë përfundimisht rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhur me propozimin e dhënë në pikën 25 sa i takon znj. Emirjana Sako. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë administrata e KQZ-së në lidhje me pretendimet e përfaqësues së posaçme të znj. Emirjana Sako. Pra na e sqaroni pak këtë?

Znj. J. Josifi: Nuk e gjejmë të bazuar këtë ndarje në nocion financim, vetëfinancim.

Z. L. Braho: Jo, jo na e sqaroni, dhurimi i vetes, tani është e cituar aty që ka dhurim vetes apo nuk është e cituar dhe në qoftë se është e cituar na e argumento pak ku është shkelja. Pra këto para, vlera prej 75 859 lekë nuk është deklaruar fare apo është deklaruar si burim i financuar me fonde vetjake të znj. Sako, që ta kemi argumentin dhe për raste të tjera, se besoj e njëjta gjë duhet të jetë.


*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Argumenti është i njëjtë për të gjithë rastet e sanksioneve të propozuara për kandidatët për kryetar bashkie. Në raportin financiar përkatës të këtyre kandidatëve është deklaruar shuma e veçantë në çdo rast, e derdhur cash në llogarinë e posaçme të kandidatit për kryetar bashkie. Për këtë arsye propozohet ky sanksion. Pra nuk ka asnjë shkelje për faktin që kandidati mundet të financojë fushatën e tij, sigurisht është i lirë, mund ta bëjë këtë. Shumë, të gjithë kandidatët pothuajse e bëjnë këtë por mënyra se si ata ia kalojnë vetes këto fonde duhet përmes transfertës bankare, le të jetë kjo nga llogaria personale, e personit fizik, e individit në llogarinë e tij të posaçme si kandidat, ky është rasti që nuk ka ndodhur kështu dhe të gjitha rastet janë të bazuara në vetëdeklarimin e kandidatëve, të cilët në formatin e plotësuar nga ana e tyre dhe të pranuar nga financieri i partisë dhe të përcjellë më tej nga partia si pjesë e raportit financiar integral, deklarojnë mënyrën e kalimit të këtyre fondeve “cash”. Kjo është shkelja e pretenduar nga ana jonë. Rasti i znj. Emirjana Sako për këtë shkelje, i njëjti lloj shkelje është në fakt një rast i përsëritur. Kandidatja për kryetare të bashkisë, konkretisht Bashkisë Durrës, e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka bërë të njëjtën shkelje në rastin e fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të 6 marsit 2022 dhe në fakt ka qenë i njëjti qëndrim i mbajtur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i ka propozuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës me të njëjtin argumentim. Ka pasur parashtrime në sallë në kujtesën tonë nga ana e kandidatës dhe u evidentua që vetë raporti deklaronte dhurimin “cash”, në fakt me vendimin e KAS-it nr. 7 të datës, 19.01. 2024, znj. Sako është sanksionuar edhe në atë rast për të njëjtin lloj shkelje në vlerën 92 775 lekë. Pra kemi edhe një precedent.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Tani një pyetje tjetër, rasti është tani znj. Sako i ka pasur lekët “cash” dhe i ka derdhur në llogarinë e posaçme apo i ka pasur “cash” dhe i ka vetëdeklaruar “cash”, pra nuk janë derdhur në këtë llogari? Pra

Znj. J. Josifi: I ka derdhur në llogarinë e posaçme, i ka kaluar “cash”, pra është paraqitur, nuk janë kaluar paratë me transfertë bankare që e njëjta shkelje si në fushatën e 6 marsit.

Z. L. Braho: Të të bëj një pyetje, po në qoftë se kjo procedura bëhet kështu, unë kandidati i marr lekët “cash”, i derdh te llogaria personale e imja dhe nga llogaria personale i kaloj me transfertë te llogaria e posaçme, ky rast është shkelje?

Znj. J. Josifi: Jo.

Z. L. Braho: Qartë.


Znj. J. Josifi: Sepse për arsye të auditimit të fondeve të fushatës zgjedhore ajo të cilën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve auditon është llogaria e posaçme, e hapur për qëllime të fushatës zgjedhore, pra jo llogaria personale e një individi.

Z. L. Braho: Pra në qoftë se është ke hyrje “cash” aty është automatikisht shkelje?

Znj. J. Josifi: Po.

Z. K. Bele: Më fal se s’e kuptova drejt, qëllimi është të ketë transparencë financimi, procesi nuk bëhet për auditorin, pra sikur njerëzit janë mbledhur për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

auditim ose subjektet marrin pjesë për auditim. Auditimi është një nga mekanizmat që ligji ka dhënë për të garantuar transparencën. Tani në themi që i depoziton lekët në bankë, po të vejë te kasa 5 minuta para t'i hedhi te llogaria e vet e t'i kalojë te llogaria tjetër kjo është në rregull, po i futi vetë direkt te llogaria e posaçme, po flasim për shuma të vogla, kjo nuk është në rregull thoni ju, s'e kuptova.


Znj. J. Josifi: Atëherë, ju lutem, nën 173, pikë 5 thotë "Pranimi i fondeve private" jemi në kushtet e fondeve private në këtë rast, jemi dakord me këtë, me pjesën e parë? Kemi vlerën, ju lutem, pranimi i fondeve private, jemi në rastin e fondeve private, me vlerë më të madhe se 50 000 lekë, jemi në rastin e vlerës më të madhe se 50 000 lekë, përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare. Ka një moment, fryma e ligjit, nuk bëhen deklaratime për hir të transparencës financiare sepse auditohet por sepse do të duhet të ketë transparencë. Rasti i nënit 173, pikë 5, përse nuk sjell transparencë kalimi i ndryshëm përmes atij në llogarinë bankare do të sjellë mosdokumentim të fondeve. Nëse këto fonde janë kaluar në "cash", cili është burimi i këtyre fondeve në këtë "cash", kjo është.

Z. L. Braho: Po në qoftë se nga llogaria personale, pra lekët e krimit të organizuar i fus te llogaria personale?

Znj. J. Josifi: Nuk gjurmojmë dot burimin e fondeve.

Z. K. Bele: Unë e kuptoj nëse janë 200-300 milionë lekë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Personi i ka futur paratë në llogarinë e posaçme, të hapur si kandidat, për efekt të fushatës zgjedhore, por i ka futur “cash” jo me transfertë bankare, pra burimin i këtij dhurimi...

Z. I. Rusmali: Cili ligj të ndalon që llogarinë ta mbushësh me lek “cash”? Cili ligj?

Z. K. Bele: Një paralelizëm, shkojmë paguajmë kartën e kreditit, ndonjëherë i marrim nga llogaria bankare dhe i derdhim, i kalojmë, ndonjëherë shkojmë dhe paguajmë “cash”. Banka të ndalon nëse ti shkon paguan 100 milionë lekë apo 200 milionë lekë, më trego burimin. Kur ti shkon paguan 75 000 lekë apo 100 000 lekë, nuk ka kufizime të tilla, kështu e kuptoj unë. Më bën sens që e njëjta gjë paralele është dhe në këtë lloj situatë. Pra unë do ta mirëkuptoja këtë sanksion nëse do të flitej për shuma të cilat kalojnë një proporcionalisht dhe janë të tilla, që nuk më duket ka dhe një kufizim për sasinë e “cash” që na mbahet, por të thuash që ka derdhur në llogarinë e vet personale 80 000 lekë, apo 70 000 lekë të reja, nuk është, më duket se aq është dhe vlera e një dreke. Jo ai paguan një drekë elektorale, është në ...

Z. L. Braho: Po, çfarë?

Znj. J. Josifi: Ka qenë identik mot a mot, i njëjti rast për zonjën, kandidaten Emirjana Sako, kandidatin Edison Memolla, kandidatin Ardian Muka, kandidatin Bardh Spahija sepse i kanë dhuruar vetes sasi më të mëdha se 50 000 lekë në “cash”.

Z. I. Rusmali: Po pra.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Po është i njëjti rast.

Z. I. Rusmali: Kandidatët kanë deklaruar në raport, i kanë dhuruar vetes “cash”, po nuk e kanë futur parane në llogari, kanë mbuluar shpenzimet e tyre me “cash”, është rast krejtësisht i ndryshëm dhe i identifikueshëm qartë nga rasti i derdhjes në llogari.

Z. E. Çefa: Zotin Muka nuk e kemi sanksionuar pikërisht me këtë argument dhe i kërkoja administratës tani të më nxjerrin vendimin, ia kemi hequr sanksionin e propozuar nga Komisioneri pikërisht me këtë argument, do ta sqarojmë sigurisht në vijim, nuk diskutohet dhe ajo, asgjë nuk ka përfunduar këtu, por që të jemi krejt korrekt.

Z. L. Braho: Po kishit për të shtuar diçka?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Ajo që doja të shtoja në fakt është rasti që po trajtohet përveç sa juve parashtruat me të drejtë, neni 173, pika 5 lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me nenin 92, pika 2, ku thotë dhurimi i fondeve publike me vlerë më të madhe se 50 000 lekë duhet të bëhet vetëm në llogari të posaçme, të hapura nga banka dhe nga subjekti zgjedhor. Pra bëhet fjalë për rastet kur subjekti zgjedhor merr dhurime nga subjekte të tjera, për lekët e tij ai ka financime dhe e ka shumë të lehtë të gjurmueshme për t’u parë se nga merren këto lekë dhe ku derdhen. Siç me të drejtë thatë janë lekë që futen në llogari për të mbuluar shpenzimet e fushatës, pra nuk shikoj asnjë arsye lidhur me gjurmimin e gjëra të tjera që janë të pamundura për t’u parë, për t’u konstatuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Faleminderit! Vijoje me z. Kreshnik Hajdari?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Raportin financiar në dispozicion, e njëjta gjë dhe për z. Kreshnik Hajdari, kam prokurë të posaçme. Përsëri pretendimet janë me shkrim dhe përsëri është i njëjti argument si në rastin më parë.


Z. L. Braho: Z.Hajdari i ka derdhur lekët në llogari?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: I ka derdhur, ka tërhequr 500 000 lekë nga llogaria e tij dhe i ka derdhur te kjo llogaria për kandidat. I kam dërguar aty, është tek praktika ime, janë të gjitha praktikat e sjella.

Z. L. Braho: Përfaqësuesja e KQZ-së në lidhje me këtë fakt? E pranoni që z. Hajdari i ka derdhur për llogarinë e posaçme këto para? Pra vlerën prej 500 000 lekë.

Znj. J. Josifi: Do të duhet të shohim dosjen e përcjellë nga zonja Xhina, nëse ka një transfertë, pra ka një vërtetim të bankës, një mandat pagese aty. Ajo që ne kuptojmë nga raporti financiar për shkak të formatit të raportit të kandidatëve, ne identifikojmë emrin e dhuruesit, shumën e dhurimit, datën e dhurimit dhe metodën e dhurimit. Kur metoda e dhurimit të vetëdeklaruar nga kandidatët është “cash”, kaq është ajo që mund të themi, nëse do të kishte metodë dhurimi me kalim në llogarinë bankare atëherë do të jepeshin dhe të dhënat e llogarisë që nuk është ky rasti. Nuk ka asnjë të dhënë llogarie. E njëjta gjë dhe për znj. Emirjana, e njëjta gjë dhe në këtë rast, pra unë e kam këtë fletë të raportit financiar të kandidatit, nëse mundem t’jua jap, po është e njëjta gjë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. I. Rusmali: Jo, s'ka gjë, e qartë. Ju nuk e keni verifikuar më tutje, gjatë hetimit tuaj pretendimin e ngritur sot apo jo? Keni parë vetëm raportimin dhe se si deklarohet nga partia, ju thoni pagesat janë bërë në llogarinë bankare dhe keni sjellë provat përkatëse për të dy rastet.

Z. L. Braho: Tani këtu për z.Hajdari, shoh që ka një dokument nga një bankë e nivelit të dytë që është tërheqje nga llogaria, që është llogaria personale e tij me sa kuptoj, në vlerën 500 000 lekë. Tërheqja në datën 2 maj 2023, tani ju e verifikoni që kjo 500 000 lekë, pra tërheqjen e kemi, e kemi verifikuar, e verifikoni dot që kjo shumë është derdhur në llogarinë e posaçme? Atëherë z. Kreshnik vetëm provon që ka tërheq 500 000 lekë nga llogaria e tij.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Pra gjithashtu tek deklaratimet e bëra thuhet raportimi financiar, ai thotë dhurim ndaj vetes "cash", është ky 500 000 lekë që përkon data e tërheqjes, që e quan dhurim të vetes dhe vë emrin e tij si dhurues.

Znj. J. Josifi: Po, po e ka të derdhur në llogari të posaçme në të njëjtën datë këtë shumë? Se ky është diskutimi.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Po sigurisht që e ka.

Znj. J. Josifi: Dakord, ja e shohim.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Këto janë akte që ka sjellë vetë shtetasi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*


Z. L. Braho: Shihni a i gjeni, unë gjeta vetëm tërheqjen, pastaj çfarë bëhet me pjesën tjetër mund ta verifikoni?

Znj. J. Josifi: Dhurimi i deklaruar nga zotëria, data e vetëdeklarimit është 1 maj 2023, ai i ka tërhequr sapo e lexuat ju nga llogaria e vet personale me 2 maj, kështu që nuk është e njëjta shumë.

Z. L. Braho: Mirë vetëm ta verifikoni këtë a janë derdhur 500 000 lekë në llogarinë e posaçme apo s'janë derdhur? Vazhdojmë me Bashkia Roskovec, Majlinda Bufi. Edhe aty pashë që kishte disa letra dhe për Majlindën.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Përfaqësoj me prokurë të posaçme znj. Majlinda Bufi dhe në rastin e znj. Bufi jemi para një tjetër rasti, sipas pretendimeve dhe akteve që znj. Bufi ka paraqitur dhe që do t'jua vëmë në dispozicion, ajo na thotë se shumat për të cilën është gjobitur, dhe është shuma 243 500 lekë, janë kontribute të disa shtetasve që nuk kalojnë vlerën 50 000 lekë, pra janë kontribute nën vlerën 50 000 lekë dhe nuk ka pasur nevojë të kalojnë me llogari bankare. Nga financierja e partisë janë mbledhur të gjitha këto shuma, bashkëngjitur me listën përkatëse, me emrat dhe shumat dhe janë derdhur në bankë dhe nga banka kemi edhe listën, një vërtetim që kur është derdhur shuma që përkon me datën e deklarimit dhe listën bashkëngjitur të shtetasve që kanë bërë deklarime vullnetare të gjitha nën vlerën 50 000 lekë. Pra vetë financierja e partisë i ka mbledhur të gjitha këto shuma dhe ka shkuar i ka derdhur në bankë dhe përshkrimi i bankës thuhet që derdhur nga financierja e partisë sipas listës bashkëngjitur. E kemi këtu, është pasqyra e transkaksioneve, është përshkrimi aty.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Pra janë të paktën 48 persona.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: 50 persona.

Z. L. Braho: 50 persona që kanë dhënë kontribut, dakord. Administrata e KQZ-së për këtë rast, si vepron në rastet e këtyre që kanë pagesa deri në 5 000 lekë?

Znj. J. Josifi: Atëherë rasti i përmendur nga znj. Xhina, kandidatja ka pasur disa dhurime nën shumën 50 000 lekë nga persona fizikë dhe ky sanksion i propozuar nuk është shumatore e këtyre shumave, pra nuk ka sanksion të propozuar. Për shembull në faqen 2 të raportit financiar të kandidates, raport me 27 faqe jepet dhurimi i parë nga një person fizik me inicialet në këtë rast që publikojmë ne, të emrit të dhuruesit në shumën 15 000 lekë kesh, në datën 11.05. Nuk kemi mbledhur këto shuma të vogla ne, pra nuk kemi mbledhur shuma nën 50 000 lekë se i kemi qëndruar gjërës së ligjit. 243 500 lekë që është shuma e sanksionit të propozuar është dhurues person fizik, jepet emri i dhuruesit, është në “cash”, në total si shumë. Pra është një shumë që e kalon 50 000 lekëshin, 243 500, nuk është mbledhje shumatore, copash më të vogla se 50 000 lekë, është shuma. Është “cash”, është vetëdeklarim i kandidates në raport.

Z. L. Braho: Atëherë Majlinda Bufi.

Znj. J. Josifi: Ku fillojnë donacionet 15 000 lekë, “cash” nga një dhurues, 39 000 lekë “cash” nga një dhurues.

Z. L. Braho: Dakord me këtë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Për shembull ashtu si ka një donacion 300 000 lekë transfertë bankare, është kodi bankar i llogarisë, numri i llogarisë, emri i bankës, emri i dhuruesit, në këtë rast është vetë zonja. I ka dhuruar vetes me transfertë bankare 300 000 lekë. Kjo do duhet të ishte mënyra e pranimit të fondeve në çdo rast.

Z. K. Bele: Nuk është i ndaluar përdorimi i “cash”. Pra nuk ka një gjë që e vë bën ilegal këtë, vajtjen dhe derdhjen e lekëve “cash”, mund të vijë ajo ditë.

Znj. J. Josifi: Ka limit shume Kodi Zgjedhor.

Z. K. Bele: Të paktën në kuptueshmërinë time dhe në vendimmarrjet e mëparshme të KAS-it kemi folur për pamundësinë e kandidatit që të deklarojë, mbulova këtë shumë “cash”, por jo për pamundësinë e kandidatit që të vejë në bankë dhe të derdhë një vlerë të caktuar monetare.

Z. L. Braho: Dëgjo, kemi këtë dokumentin që është vlera 243 500, e cila është depozituar në datë 12.04.2023 dhe me përshkrimin është bërë depozitim vullnetar sipas listës. Ka dhe një listë këtu bashkëlidhur, që janë këta individë, që kanë bërë pagesa, paska dhe biznes për pagesë 50 000 lekë të reja, ka dhe 10 000 lekë të reja, po ka dhe me vlerën 5 000. Tani ajo që mund të diskutohet këtu për këto subjektet që kanë bërë pagesa 22 500 lekë, 10 mijë, 10 mijë, 10 mijë dhe mbase nuk duhet të ishte marrë totali po duhet të ishte marrë vetëm kjo vlerë.

Znj. J. Josifi: Ne kemi marrë çfarë është deklaruar dhe vetëdeklaruar nga kandidati, e ka deklaruar si një dhurim këtë në raportin financiar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Po tani nga llogaria bankare s' del kështu.

Znj. J. Josifi: Ne nuk e kemi të ndarë. E ka deklaruar si "cash" metodën e dhurimit.

Z. L. Braho: Po mirë ky audituesi çfarë bën, ky vetëm vetëdeklarime sheh? Se jam shumë i paqartë për këtë rolin e audituesit në këtë historinë e financimeve, se tani po i bie të marrim ne rolin e audituesit.

Znj. J. Josifi: Jo ka akses dhe në llogarinë bankare dhe kërkon dokumenta justifikues.

Z. L. Braho: Vijnë provat këtu te ne dhe tani të rrimë ne të shohim sa lekë kanë hyrë "cash", e sa lekë kanë hyrë me bankë, ndërkohë që dikush tjetër duhet ta kishte bërë këtë lloj pune. Megjithatë shoh që dhe kjo vlera, edhe pse janë 10 mijë janë derdhur në bankë të gjitha. Tani këtu jemi në rastin që këto thotë nuk janë nga lekët e veta po janë nga palë të treta, por që gjithsesi janë hedhur në llogarinë bankare të posaçme të kandidatit, për ju është shkelje ky rast? Pra njësoj si për rastin e kandidatëve kur i derdhin lekët vetë?

Znj. J. Josifi: Është shkelje nëse fondi është pranuar përmes një forme tjetër, në këtë rast forma është "cash", e ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare.

Z. L. Braho: Këto janë në bankë.

Znj. J. Josifi: Po i ka deklaruar "cash".

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Po mirë tani që ju u vutë në dijeni të kësaj provës që është me bankë, nuk mund ta rikonsideroni kërkesën e Komisionerit se tani ne këtu nuk jemi për të bërë shqyrtim administrativ për hir të shqyrtimit, jemi për drejtësi.

Znj. J. Josifi: Ne nuk e kemi pasur këtë pretendim nga subjekti as nga kandidatja, as partia, pra raporti i gjetjeve. E para raporti, projektraporti i audituesit i bëhet me dije subjektit të audituar, subjekti jep observacionet e veta, raporti përfundimtar i vihet në dispozicion. Raporti jonë është përmbledhës i gjetjeve, i është dërguar për konsultim, për shqyrtim, për observacion dhe nuk është ngritur në asnjë moment ky pretendim, po ngrihet sot për herë të parë.

Z. L. Braho: Dakord, ne do e bëjmë kështu, ti do i marrësh të gjitha këto prova dhe në vijim mund të na rikonfirmosh qëndrimin e KQZ-së në lidhje me këto kërkesa ku kanë ardhur disa prova të reja.


Z. L. Braho: Mariglen Disha? Prapë ju?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Unë jam përfaqësuese e Partisë Socialiste, po s'ka ardhur radha akoma se është në pikën 84, kështu që detyrimisht do filloj me prokurat. Kjo është origjinalja.

Z. L. Braho: Mariglen Disha 125 490 lekë.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Te rasti i z. Disha ne vetëm i qëndrojmë pretendimeve që kemi para nenit 173, pika 5 që lidhet me nenin 92, pika 2, pasi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

nuk e konsiderojmë dhurim, e konsiderojmë thjesht fondet e tij kandidati i ka përdorur për shpenzimet e fushatës.

Z. L. Braho: I ka derdhur në bankë?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Jo, s'i ka derdhur.

Z. L. Braho: Jo, s'i ka derdhur në bankë, dakord.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Por themi që nuk jemi para dhurimit sipas nocioneve të Kodit Zgjedhor.

Z. L. Braho: Dakord, vazhdojmë me Agron Malaj.


Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Edhe për z. Malaj është i njëjti pretendim, kam prokurën e posaçme si përfaqësuese, pretendimet me shkrim dhe është njësoj si rasti i z. Mariglen.

Z. L. Braho: Pra dhe Agron Malaj si e ka rasti, njësoj si?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Njësoj si z. Mariglen Disha.

Z. L. Braho: Pra ka përdorur fondet e veta pa i derdhur në bankë. Çfarë mendimi ka KQZ-ja për këta pa bankë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Është shkelje, në bazë të nenit 173, pika 5, “ka pranuar fonde private”, nuk ka rëndësi është dhurim, është vetëdhurim, është ka pranuar fonde private.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Të bëj një pyetje?

Z. L. Braho: Këta që i kanë derdh nga xhepi, gati.

Znj. J. Josifi: Fond privat është ai.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: T’ju bëj një pyetje? Mundem të bëj një pyetje?

Z. L. Braho: Pyetje ndaj kujt?


Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: KQZ-së, administratës.

Z. L. Braho: Po, patjetër.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Neni 173, pikë 5 me kë nen lidhet shkelja e tij në Kodin Zgjedhor, për shkelje të kujt neni?

Znj. J. Josifi: E kemi cituar nenin 173, pika 5 dhe po e lexoj, po e rilexoj “Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 000 lekë, përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së”. Tani ju këtë e lidhni me neni 92, e 92/1.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Me kë dispozitë detyruese lidhet përveç asaj?

Znj. J. Josifi: Sa lexova unë.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Ka vetëm sanksione.

Z. L. Braho: Dakord vazhdojmë me Bashkinë Peqin, Bukurosh Maçi. Po ky si e ka rastin?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: I njëjti rast.

Z. L. Braho: Dakord, pra me paratë e veta pa bankë, 70 000 lekë. Dakord, faleminderit! Kalojmë te Bashkia Krujë, "Partia e Lirisë", Agron Loka, këto i ke ti me prokurë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Shiko, kemi faktikisht dhe deklarime ose kërkesë që kanë depozituar vetë, për shembull, jo për z. Loka nuk kam prokurë, e kemi njoftuar për seancën po ka bërë një kërkesë me shkrim, në formë ankimi, mund t'jua vë në dispozicion, edhe KQZ-së. Atëherë z. Loka sqaron se për shumën 486 000 lekë, i ka marrë nga kursimet, llogaria e tij personale për të paguar subjektet për shërbimet që i kanë ofruar atij si kandidat për Kryetar të Bashkisë Krujë. Meqënëse, thotë, nuk kisha njohuri të deklaruara për dispozitat dhe Kodin Zgjedhor në lidhje me donacionet, fonde jopublike nga subjektet fizikë apo juridikë, ka gjykuar të arsyeshme se vetëm për shumat më të mëdha se sa 150 000 lekë të reja sipas ligjit për procedurat hetimore, mund të ishe e detyruar ta derdhte në bankë, nga ajo që unë kuptoj. Në këtë kushte ai i kërkon Komisionit të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Ankimeve dhe Sanksioneve që t'i hiqet gjoba. Kjo është që ka deklaruar vetë kandidati.

Z. L. Braho: Pra këtë mund të na e sqarojë dhe administrata e KQZ-së, 486 000 lekë, të z. Loka, janë “cash” apo të derdhura në llogarinë e posaçme?

Znj. J. Josifi: “Cash”.

Z. L. Braho: “Cash” pra s'ka fare.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Një pyetje nëse mundem i nderuar t'ia bëj administratës së KQZ-së për rastin konkret, a ka qenë një shumë e vetme apo kanë qenë disa shuma të caktuara?

Znj. J. Josifi: Një shumë, e ka deklaruar si një shumë në total, nuk e ka, pra nuk kemi mbledhur shuma më të vogla dhe kemi ardhur në këtë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: E kuptoj deklarimin, por nuk mendoj se ka bërë vetëm një pagesë për gjithë fushatën në këto vlerë, ajo që dua të them është se ka bërë pagesa të ndryshme nën vlerën limit, 150 mijë lekë për të cilat je i detyruar t'i kalosh.

Znj. J. Josifi: Është tjetër.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Je i detyruar t'i kalosh me bankë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Është tjetër gjë shpenzimi nga të ardhurat, ne po themi të ardhurat që ka gjeneruar, pra ka pranuar fonde, nuk po diskutojmë se të ardhurat që ka gjeneruar, si i ka shpenzuar, pra nuk jemi te shpenzimi, jemi tek e ardhura, te krijimi i të ardhurës.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po po që të shpenzohen duhet t'i kesh ato të ardhura normalisht.

Znj. J. Josifi: Po ka deklaruar që i ka "cash".


Z. L. Braho: Vazhdojmë me Bashkia Krujë ishte z.Agron Loka, me z. Albert Mëlyshi Bashkia Mirditë, kandidati i Partisë së Lirisë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Z.Mëlyshi ishte prezent qëparë, nëse është akoma.

Z. L. Braho: Atëherë duke qenë se z. Melyshi nuk është i pranishëm, ka depozituar një ankim kështu që thjesht po relatojmë ankimin për efekt mbrojtje.

Z. E. Çefa: Për efekt të respektimit të barazisë së shqyrtimit, z. Mëlyshi ka paraqitur një ankim administrativ, siç ishte dhe praktika e mëpërparshme, e cila është formalizuar në kërkesën ankimore me nr. 27 nga KQZ-ja, po kjo nuk ka rëndësi, thjesht për procesverbal dhe ai parashton argumentat kundër propozimit të Komisionerit dhe unë po i lexoj siç i ka shkruar dhe ai: "Në mbështetje të nenit 175, pika 3 e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka vendosur të propozojë KAS-it marrjen e masës administrative për kandidatin për Kryetar i Bashkisë Mirditë Albert Mëlyshi gjobën me shumën 300 000 lekë. Ky vendim është marrë referuar nenit

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

92/2, pika 3 të Kodit Zgjedhor, kandidatët e subjekteve zgjedhore nëse planifikojnë të pranojnë dhurime për fushatën e tyre me vlerë më të madhe se 50 000 lekë janë të detyruar të hapin llogari bankare të posaçme për dhurimet e fondeve jopublike. Llogaritë deklarohen në momentin e regjistrimit sipas nenit 67 të këtij ligji në formularin e deklarimit, përfshirë dhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë. Në mbështetje të nenit 92/2, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku vlen të theksoj se kandidoja për herë të parë dhe nuk kisha planifikuar të pranoja dhurata për fushatën zgjedhore të vitit 2023, ku isha kandidat për kryetar bashkie dhe si rrjedhojë nuk isha i detyruar të hapja llogari bankare të posaçme për të pranuar burimet e fondeve jopublike. Edhe ligjvënësi e ka parashikuar këtë fakt, pra planifikimin si kusht të domosdoshëm për hapjen llogarisë bankare të posaçme për të pranuar dhurime për fushatën zgjedhore. Shtetasi Paulin Marku, i biri i Prendit, datëlindja '70, banues në Kanada ka deklaruar edhe arsyen e kalimit të shumës prej 300 000 lekësh me Western Union, është se ai i ka dhuruar pa marrë më parë pëlqimin e tij. Kjo dhuratë e shtetasit Paulin Marku nuk ka qenë planifikuar dhe as ka marrë mendimin për kalimin e kësaj dhurate, pra ka qenë jashtë çdo parashikimi. Nëse ligjvënësi do të kishte vendosur detyrimin e hapjes së llogarisë bankare pa qenë i detyruar për planifikimin të pranojë dhurata do të ishte në shkelje të Kodit Zgjedhor. Përfundimisht kërkoj konstatimin e paligjshëm të aktit administrativ vendimi 186 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sigurisht për pjesën e tij". Ky ishte edhe pretendimi i z. Mëlyshi që ne e lexuam për efekt procesverbali.

Z. L. Braho: Z. Mëlyshi foli më gjatë se këta që janë të pranishëm! Atëherë administrata në lidhje me z. Mëlyshi?

*Zbardhi materialin audio
Adriano DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Në këtë rast ai e ka deklaruar këtë si të ardhur të përfituar “cash” dhe sapo dëgjuam është shprehur se dhuruesi, banues në Kanada e ka kaluar shumën 300 000 lekë me Western Union dhe nuk i ka marrë më parë pëlqimin kandidatit, por praktikisht kandidati e ka shprehur pëlqimin kur është paraqitur në degën e Western Union-it dhe ka pranuar 300 000 lekë! Në momentin që nuk kanë kaluar në llogarinë e posaçme, fare mirë në këtë moment e tejkaluam momentin e planifikimit dhe mosplanifikimit, u bë fakt dhurimi, u bë fakt pranimi i dhurimit, do duhej të paraqitej në bankë, të hapte llogarinë e posaçme, ta deklaronte në KQZ dhe të derdhte 300 000 lekët. Ndërkohë mandatin e Western Union-it e kishte.

Z. L. Braho: Shumë e paqartë.

Znj. J. Josifi: Jemi në kushtet e nenit 173, pika 5.

Z. L. Braho: Dakord, pra ky është me Western Union. Ardit Cikuli, bashkia Sarandë?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Përshëndetje të nderuar!

Z. L. Braho: Ti je vetë Arditi?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po, jam vetë Arditi.

Z. L. Braho: Po Ardit. Më thuaj pak, ti paske 259 958 lekë që duhet t’i paguash si gjobë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po. Atëherë, paraprakisht nuk e di se çfarë ka ndodhur me kandidatët e tjerë, unë jam informuar nga mediat se paskësh bërë një raport auditimi nga ana e KQZ-së dhe u bë tribunë në të gjitha mediat kombëtare dhe lokale që ndaj nesh që marrë një masë gjobe, pa u pyetur ne, pa kërkuar ndonjë informacion shtesë nëse duhej, thjesht më shumë për konsum mediatik. Unë atë ditë që kam mësuar për këtë gjë kam dërguar dhe një kërkesë, ankesë ndaj KAS-it dhe ndaj KQZ-së, e cila sipas shërbimit postar duhet t'ju ketë mbërritur. Për mua nuk është logjike kjo që ka ndodhur. Unë Ardit Cikuli nuk kam përfituar asnjë fond nga ana e KQZ-së dhe as ndonjë financim publik, nga taksat e shqiptarve, unë kam bërë financim me fondet e mia personale dhe nga një financim i një familjari tim që më është dërguar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili më ka mbërritur me Money Gram dhe e kam depozituar në llogarinë përkatëse që u çel muajin e fundit.

Z. L. Braho: Sa është vlera që mos ta zgjasim shumë, sa është vlera që të kanë transferuar, vlera 259 958?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Dy transferta nga 500 dollarë, të cilat janë depozituar në një depozitim të vetëm me përshkrimin përkatës, donacion nga personi.

Z. L. Braho: Te llogaria e posaçme?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Te llogaria e posaçme.

Z. L. Braho: Pra 1000 dollarë, të konvertuar në lekë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po të konvertuara në lekë.

Z. L. Braho: Po pjesa tjetër që i bie një diferencë prej?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Pjesa tjetër janë pagesat që janë bërë nga ana ime, nga kartat e mia personale të facebook-ut, duhet të keni parasysh që bankat e nivelit të dytë nuk lejojnë që t'i të prodhosh karta debiti të lidhura me llogaritë e posaçme, e për rrjedhojë unë të gjithë fushatën time elektorale, facebook-un që kam paguar, e kam paguar nga kartat e mia personale. Por të gjitha këto shpenzime, secila faturë, 16 fatura që kam paguar, asnjëra prej tyre nuk e tejkalonte vlerën prej 50 000 lekë, e për rrjedhojë masa e KQZ-së...

Z. L. Braho: Të facebook-ut janë disa fatura me vlerë deri në 50 000 lekë?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Disa fatura me vlerë nën nivelin 50 000 lekë.

Z. L. Braho: Këto përbëjnë këtë diferencën prej 160 000 lekë të reja?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po.

Z. L. Braho: Pra 1000 dollarë i kishe nga Money Gram, ngel dhe diku 160 000 lekë të reja dhe 160 000 lekë të reja kanë qenë sponsorizime facebook-u?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po, pak a shumë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Tani administrata e KQZ-së për këto pretendime, ku e bazoni ju këtë 259 000 lekëshin?

Znj. J. Josifi: Totali i sanksionit të propozuar është shumë e dy burimeve, të dyja mbi vlerën 50 000 lekë, njëra është përkatësisht 100 500 lekë, tjetra është 159 458 lekë, kjo e para është vetëdeklaruar si burim në “cash” nga një person tjetër, ndërkohë 159 458 lekë është “cash” nga kandidati tek vetë kandidati. Sqarimi për rrjetet sociale lidhet me shpenzime dhe jo me të ardhura, ne nuk po diskutojmë si i ka kryer shpenzimet.

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Njëra pagesë është derdhur në llogarinë e posaçme, më vjen keq e keni, keni dhe mandatet e Money Gram që kam tërhequr, keni dhe depozitimin, keni dhe lëvizjen e llogarisë, e para. I kemi sjellë këtu, i keni pasur që në momentin që...

Z. L. Braho: Mos filloni se e keni.

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: E dyta, shpenzimet që unë, nuk mund të trajtoni të ardhurat e mia në mënyrë kulumative kur unë shpenzimet i bëj në mënyrë parciale, kam paguar 16 fatura të ndryshme dhe sigurisht që kam paguar në kartat e mia personale.

Z. L. Braho: Ardit një pyetje, ti sa lekë ke deklaruar që ke shpenzuar, ose sa të ardhura ke deklaruar?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Shuma që është vendosur si gjobë, janë shpenzimet e mia që unë kam kryer për fushatën time elektorale.

Z. L. Braho: Thotë janë dy transferta, dy deklarime që ke pasur burime, atëherë jo shpenzime, mos t'i ngatërrojmë shpenzimet.


Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Burime kanë qenë dy dhurime prej 500 dollarësh secila, të akumuluar bashkë bëjnë 1000 dollarë të depozituara në vlerën 1 500 lekë llogarinë specifike, të çelur në bankë të nivelit të dytë, kjo është e para dhe pjesa tjetër e dytë janë financimet “cash” që unë kam bërë për pagesat e facebook-ut dhe detyrimeve që kam pasur ndaj palëve të treta, por janë bërë në mënyrë parciale dhe shumica e këtyre shpenzimeve që janë bërë janë nën nivelin 50 000 lekë të reja. Pra unë nuk mund të trajtoj për shumë akumulative kur unë, se unë atë të ardhur, unë nuk do marr gjobë për çfarë depozite kam në sistemin bankar.

Z. L. Braho: Pra ju ju thoni që këto vlera, atëherë dhe një herë ju pretendoni që vlera prej 259 458 lekësh përbëhet nga një dhurim ose dy dhurime që përbëjnë një vlerë të përbashkët 1000 dollarë që i ke depozituar, që i ke tërhequr në Money Gram dhe i ke depozituar në llogarinë e posaçme dhe pjesa tjetër janë para ju i keni deklaruar si të ardhura, meqenëse i keni shpenzuar?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po.

Z. L. Braho: Ato që kanë të bëjnë me facebook-un dhe që janë nga të ardhurat tuaja personale.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Pikërisht, unë desha të bëj një pyetje KQZ-së, në qoftë se unë do të kisha deklaruar, një deklaratë me shpenzime 0 sa do të ishte gjoba për mua? Sepse në vend të më thoni bravo që i ke deklaruar dhe ato të Money Gramit që më erdhën dhe Money Gram nuk ka ndonjë përshkrim dhuratë për fushatë, mua m'i ka dërguar se është gjaku im, por unë i kam derdhur për transparencë, se doja të isha transparent ndaj ligjit. KQZ-ja nuk pa që deri në ditën e fundit të zgjedhjeve, KQZ-ja nuk pa që gjithë administrata ishte rrugëve dhe pa shpenzimet e mia, të marra nga xhepi im dhe më bëni tribunë nëpër media kombëtare dhe lokale, kush ua ka borxh këtë linçim mediatik, kam marrë gjobë unë se paskam pranuar lekë nga palë të treta, çfarë janë këto, ky nen? Në jetën time s'kam një gjobë makine pa paguar, e kam bërë fushatën me dinjitet, me kë, për vendin tim, për qytetarët e mi, po të tërë e dini si u bë fushata dhe mbi të gjitha jemi shqiptarë, ne nuk duhet të trajtojmë politikisht gjërat. Unë kam deklaruar të gjitha shpenzimet që unë kam bërë dhe ligji është doktrinë, është frymë, nuk është të rrimë të merremi me presje, me pika, unë kam deklaruar çdo lloj gjëje. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Z. Çefa një pyetje?

Z. E. Çefa: Një pyetje kisha, atë diferencën dhe njëherë se po kthehem prapë aty, atë diferencën janë të gjitha shpenzime të bëra nëpërmjet kartës së kreditit apo janë dhe shpenzime të bëra "cash"?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Kam bërë shpenzime facebook-un, kam bërë shpenzime për pagesën e materialeve, fletëpalosjeve që kam prodhuar?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. E. Çefa: Shpenzimin e fletëpalosjeve si e ke bërë, i ke bërë “cash” apo me kartë krediti?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Është bërë tërheqja e fondeve nga llogaria përkatëse dhe është bërë pagesa e faturës.

Z. E. Çefa: Po në llogarinë përkatëse 105 000 lekë ke pasë, ato që të erdhën nga Money Grami, nga jashtë apo jo?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po.

Z. E. Çefa: Po ato ishin, ne diskutojmë për diferencën, minus atë diferencën.

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Totali i fushatës sime ka kushtuar 260 000 lekë të reja.

Z. E. Çefa: Iku, 105 000 po prezumojmë që i ke, diferencën?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: 105 000 kanë ardhur nga financimi i të afërmit tim, pjesa tjetër ka ardhur nga financimi im individuale të cilat janë paguar faturat të ndryshme.

Z. E. Çefa: Tani këtu më rri të lutem, këto financime që i ke bërë vetë, je vetëfinacuar, i ke depozituar në llogarinë e posaçme dhe pastaj i ke shpërndarë apo i ke krejt nga xhepi dhe i ke shpenzuar? Zotëria më tha kam paguar dhe fatura të tjera përveç facebook-ut dhe pyetja ishte i ke paguar me kartë krediti?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Po kam paguar dy fatura të tjera të cilat, kam paguar shpenzimet e një eventit.

Z. E. Çefa: Sa lekë?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: 17 000 lekë.

Z. E. Çefa: Si i ke paguar në “cash” apo në kartë krediti?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Në “cash”. Detyrimi ligjor është që faturat deri në masën 150 000 lekë mund të paguhen edhe me “cash”, në momentin që nuk e përcaktoj dot unë në mënyrën e pagesës, ma përcakton biznesi.

Z. E. Çefa: Qartë, e kuptova.

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Pra nuk është se unë kam shkelur ndonjë ligj. Unë të ardhurat, detyrimi ligjor ka qenë për pjesën e të ardhurave, pra për mënyrën se si financohet fushata, jo për pjesën e pagesave. Pjesa e të ardhurave të mia ka qenë të ardhura të mia personale që janë paguar në periudha të ndryshme, në momente të caktuara dhe kjo nuk mund të trajtohet në shumë akumulative, nuk mund të trajtohet në akumulativ dhe shpenzimet që unë kam bërë për facebook-un, që i kam bërë nëpërmjet kartave të mia personale sepse nuk kam pasur mundësi ndryshe.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. E. Çefa: Ato i kemi të qarta, e kuptojmë atë, diskutojmë këtë tani 70 000 lekë “cash”. Pyetja e fundit, pse nuk i ke fut në llogari këto 70 000 lekëshin, po i ke marrë direkt nga xhepi dhe ke paguar eventin?

Z. A. Cikuli, kandidat për kryetar të Bashkisë Sarandë: Unë nuk i kam kaluar nëpërmjet bankës, paratë e mia s’mund t’i kaloja nëpërmjet bankës sepse janë bërë, si do e bëja do i kaloja në llogarinë speciale dhe pastaj si do ta tërhiqja prapë e ta depozitoja te karta ime e debitit? S’e bëja dot këtë, teknikisht është e parealizueshme.

Z. E. Çefa: Jo teknikisht është e realizueshme, mund të jetë abstrakte, e vështirë të kuptohet po megjithatë s’ka rëndësi është e qartë, e kuptova.

Z. L. Braho: Faleminderit z. Cikuli! Administrata e KQZ-së në lidhje me këtë çështje? E dhatë opinionin tuaj. Vazhdojmë me z. Arjan Hoxha, është kandidat për bashkinë Kamëz, Z. Hoxha 72 000 lekë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Nuk është prezent në dijeninë time dhe nuk është se kemi prokurë po si gjithë kandidatët e tjerë nëse më lejohet të bëj një mbrojtje të përgjithshme? Nga çfarë po kuptojmë nga dy orë e gjysëm.

Z. L. Braho: Degjo përpara se të bësh t’i mbrojtjen, të na thotë KQZ-ja se çfarë shkelje ka bërë z. Hoxha, si e ka shkeljen?

Znj. J. Josifi: Pranim dhurimi “cash”i një shume mbi 50 000 lekë, është e njëta gjë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: I ka dhuruar një palë e tretë, është 72 000 lekë?

Znj. J. Josifi: 72 000 lekë, është vetë.

Z. L. Braho: Pra nga lekët e veta.

Z. E. Çefa: Në numrin e llogarisë apo jashtë?

Znj. J. Josifi: Jo jashtë llogarisë.

Z. L. Braho: Qenka dhe Aurel Malko, po 72 000 lekë, Aureli është i pranishëm? Jo. Bardh Spahija? Bardh Spahija e 445 580 lekë, po kështu “cash” vetes? “Cash” vetes. Bedri Hoxha? Edhe Bedri Hoxha? Domethënë këta janë të gjithë që i kanë dhënë lekë vetes pa i kaluar në llogari bankare? Pra thjesht duhet të më thuash kur është rasti që i kanë kaluar llogari dhe kur është rasti thjesht i kanë deklaruar “cash”.

Znj. J. Josifi: Nëse doni ta ribëjmë këtë verifikim për të gjithë listën e kandidatëve, e ribëjmë siç ishte rasti i kandidatëve që sollën dokumenta.

Z. L. Braho: Do të kishte vlerë për hetimin administrativ që të bëhej kjo. Behar Haxhiu, Bashkia Kurbin?, Besnik Dushaj, Bashkia Tropojë? Dëfrim Fiku, Bashkia Bulqizë? Dorian Lani? Ju jeni, kush jeni ju? Dorian Lani? Ti je Dëfrim Fiku i Bashkisë Bulqizë. Po Dëfrim, ulu aty te mikrofonin. Dëfrim ti duhet të kthesh 192 294 lekë ose do na tregosh ku i ke gjetur ose do i kthesh.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Në fakt unë kam qenë jashtë shtetit dhe nuk kam pasur mundësi që të bëj një ankesë me shkrim, po nuk e di arsyen e kësaj gjobe sepse në raportin financiar i kemi plotësuar të dhënat në mënyrë të rregullt ligjore.

Z. L. Braho: Do ta them me pak fjalë arsye e gjobës është që ti 192 294 lekë që nuk i ke kaluar nëpërmjet llogarisë së posaçme, po në detaje mund ta thotë përfaqësuesja e KQZ-së.

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Diçka për këtë numrin e llogarisë, edhe me shkrim e kam treguar se nuk kisha arsye që të hap një numër llogarie përderisa nuk kishte donacione.

Z. L. Braho: Pra nuk ke hapur numër llogarie?

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Kishin frikë të na flitshin në rrugë, jo të na jepnin lekë për fushatë elektorale, ky është një nonsens, besoj që nuk kishte arsye. Pra donacione unë s'kam pasur, asnjë lloj donacioni.

Z. L. Braho: Pra ke lekët e tua që janë 192 294 lekë?

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Po lekët e mia. Disa reklama aty që dhe ato i kam paguar avash-avash, thjesht i kam deklaruar sepse ishim kandidat të PD-së, dokumentat qarkullonin nëpërmjet LSI-së , duhet të shkonim të firmosnim atje, e ky ka qenë një lapsus. Ne kemi deklaruar kafën, rakinë në lokal atje me lekët tona.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: KQZ-ja do të thotë ndonjë gjë? Çfarë ka kështu dhurim “cash” vetes?

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: S’ka pasur lekë asnjëri.

Z. L. Braho: Kështu thonë këta.

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Po merren me ne, s’kanë punë tjetër.

Znj. J. Josifi: Atëherë sanksioni i propozuar për kandidatin është në vlerën 192 294 lekë, është shumë e dy dhurimeve, secili e kalon vlerën 50 000 lekë, është përkatësisht një dhurim në vlerën 78 000 lekë, i vetëdeklaruar nga kandidati, dhurim të cilin e ka pasur nga një person juridik.

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Nuk është aspak e vërtetë.

Znj. J. Josifi: Ju lutem, ju sjellë deklaratën vetë ju e keni firmosur raportin, ju lutem.

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Dakord.

Z. L. Braho: Një sekond.

Znj. J. Josifi: Shuma e dytë është në vlerën 72 000 lekë, që në këtë rast kjo është nga të ardhurat tuaja, sërish e deklaruar “cash”.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Po nga të ardhurat e mia, këtë e thashë unë.

Znj. J. Josifi: I keni derdhur në llogari?

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Nga të ardhurat e mia, atë e thashë unë, i kam prishur vetë, lekët e mia.

Znj. J. Josifi: Epo fond është.

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: Kurse kjo tjetra nuk është, s'kam llogari fare po të them...

Znj. J. Josifi: Atëherë keni dhe shkelje të nenit 92/2 të Kodit Zgjedhor.

Z. D. Fiku, kandidat për kryetar të Bashkisë Bulqizë: ...sepse e dija. Zonjë nuk është llogari bankare, janë thjesht disa fletëpalosje, nuk ka kaluar asnjë lek "cash" po të them në llogari.

Z. L. Braho: Dëfrim ti erdhe për të heq një gjobë , mos të shtojmë dhe një tjetër! Dakord.

Znj. J. Josifi: Ju lutem, neni 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor, dhurimi i fondeve jopublike me vlerë të madhe se 50 000 duhet të bëhet vetëm në llogari të posaçme të hapura në banka nga subjekti zgjedhor. Llogaritë deklarohen në momentin e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

regjistrimit sipas nenit 64 në formularin e deklaramit, ku përfshihet dhe autorizimi për KQZ-në dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka.

Z. L. Braho: Qartë mbi ligjin.

Znj. J. Josifi: Për ta saktësuar subjekti nuk mundet të përdorë...

Z. L. Braho: Sa kishte, sanksioni sa lekë ishte?

Znj. J. Josifi: 78 000 dhe 72 000 lekë vetë.

Z. L. Braho: Atëherë vazhdojmë me z. Dorian Lani, është? S'është.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Personalisht nuk është po ka lënë prokurë, madje dhe tani po telefonon. Atëherë po ju vë në dispozicion prokurën e z. Lani. Ka bërë dhe një deklaratë z. Lani, me shkrim, në formën e kërkesës. Atëherë po i referohem fillimisht çfarë ka parashtruar vetë zotëria. Në mënyrë të përmbledhur z. Dorian Lani deklaron se e kundërshton patjetër vendosjen e masës administrative me gjobë në vlerën 72 000 lekë, për kalimin e fondeve të marra sipas nenit 173, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Nuk është dakord me masën e propozuar me arsyetimin se ai ka hapur llogarinë sipas instruksioneve të dhëna nga ana juaj, nga ana e KQZ-së, ka hapur llogarinë bankare dedikuar për donacione të ndryshme që mund të kryheshin. Gjatë gjithë fushatës së tij nuk pasur, thekson, asnjë donacion nga persona të tretë, shuma e të cilëve duhet të ishte depozituar në këtë llogari. Shuma e shpenzimeve për fondet e shpenzuara janë burim i të ardhurave të tija personale që kanë origjinën nga punësimi në sektorin privat prej shumë vitesh dhe deklaron

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

nga ana tjetër se të gjitha pagesat janë kryer “cash” sipas tipologjisë së faturave të marra dhe të deklaruara. Pra asnjë faturë, deklaron, e thekson këtë gjë nuk e ka kaluar vlerën 70 000 mijë lekë të reja. Në gjykimin e tij, bazuar në nenin 173, pika 5, pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 000 lekë përmes formave të tjera dënohet me gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së. Sikundër është cituar më lart, shprehet z. Lani ai nuk ka marrë asnjë fond nga donatorët apo subjektet, burime të ardhura për fondet kanë qenë kursime personale dhe të ardhura nga punësimi në sektorin privat. Pra për ta përmbledhur jemi pak a shumë tek e njëjta tipologji që kemi këtu prej më se dy orë e gjysëm që dëgjojmë pak a shumë këto raste janë në vija të përgjithshme. Asnjë nga kandidatët nuk ka marrë, nuk mund ta pranojmë njëherë konceptin e dhurimit të vetes, sepse dhurimi vetes nuk ekziston ashtu sikundër u tha dhe nga kolegët, nuk ekziston në konceptin juridik, nuk mundet që një individ, person t’i dhurojë vetes së tij se është non sens, por do të ishte koncepti i duhur, do të ishte financimi vetjak, ndoshta është ai problem me formularin e KQZ-së nga ka ardhur e gjithë kjo problematikë ku gabimisht mund të jetë shënuar shumat, mund të jenë plotësuar te tabela, te rubrika e dhurimeve, nëse mundet dikush t’i dhurojë vetes. Nëse është person fizik dhe ai dhuron vetes së tij është tjetër punë, janë dy personalitete të ndryshme po themi, ose nëse, por në këtë rast është i njëjti person, nuk ka pse të ketë dallime, nuk mund t’i dhurojë vetes së tij. Në vija të përgjithshme ajo që desha të them është që edhe, jo vetëm për këtë rast por dhe për rastet e tjera duket qartë që ligji nuk është i qartë, është mjaft e dukshme kjo gjë që ka një mungesë të specifikimeve, ka paqartësi sepse ka shumë kandidatë sikundër ju po e shihni që vijmë dhe paraqiten këtu me pretendimi nga ana e KQZ-së se paskan shkelur ligjin, ndërkohë pra ligji është i paqartë, koncepti dhurim ndaj të tretëve, më duket jo i duhur dhe jo i saktë nga ana ligjore. Koncepti që përdor

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

KQZ-ja. Koha ka qenë e pamjaftueshme, nuk ka pasur as trajnime lidhur me këtë punë, ndoshta nga KQZ-ja për kandidatët, por po t'i kthehemi dhe vetë janë këtu e zëmë, zotërinjtë e zonjat kandidatë dhe mund ta shprehin se nuk kanë marrë as njoftime dhe as një komunikim nga audituesit por janë lajmëruar nga mediat apo në mënyrë të tjera po themi, pra dhe masat e propozuara nga KQZ-ja janë disproporcionale sepse nuk mundet të kërkohet gjobitja me plotësisht shumën e shpenzuar për fushatë nga x kandidat dhe ajo shumë të vendoset totalisht si gjobë kur këta kandidatë nuk i kanë fshehur këto të ardhura, nuk i kanë fshehur këto financime, nuk i kanë fshehur këto shpenzime, quajeni si të doni. I kanë deklaruar, këta i kanë deklaruar vetë, i kanë plotësuar vetë formularët, nuk i kanë fshehur, pra nuk janë shpenzime apo financime apo të ardhura që i kanë gjetur e i kanë zbuluar audituesit e KQZ-së, por janë thjesht të deklaruara, tani a janë deklaruar te rubrikat e duhura apo jo, kjo mbetet për t'u vendosur nga KAS-i. Edhe diçka të fundit para se ta mbyll, për ekonomi gjyqësore unë dua të shprehem edhe njëherë për rastin e z. Ardian Muka, precedentin e z. Muka, që ju me të drejtë si trupë e KAS-it e risollët në vëmendje. Këtu kemi qenë, kam qenë unë prezent në atë seancë dhe ju gjithashtu dhe ka qenë pak a shumë kjo tipologji. Z. Muka kërkoi nga KQZ-ja para disa muaj të dënohej me shumën që ai kishte derdhur dhe kishte, pra kishte derdhur në llogari dhe kishte paguar "cash", ndërkohë që vërtetohej fare lehtë se ishin të ardhura të tij personale, pra nuk kemi të bëjmë as me pagesa mbi vlerën 150 000 lekë për të cilat duhet të kalosh se s'bën pagesën e sistemit bankar, kemi të bëjnë me shuma që e para që s'janë të dhuruara njëherë, janë shuma personale, patjetër, por janë shuma që nuk janë dhuruar nga të tretët sipas në dispozitën përkatëse të Kodit Zgjedhor ku është shuma mbi 50 000 lekë, e dhuruar do të vetëdeklarohet, janë vetëfinancim, janë para të vetëfinancuara, të këtyre qytetarëve, nëse KQZ-ja ka indicie se këto janë shumë jashtëzakonisht të mëdha

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

dhe këta nuk kishin mundësi që t'i përballonin apo nuk kishin mundësi që t'i gjeneronin këto të ardhura dhe do të duhej që këta kandidatë ta justifikonin si burimin e këtyre të ardhurave kjo është punë tjetër, po ne kemi të bëjmë me shuma deri diku mjaft modeste do të thosha unë, që çdo kandidat e justifikon lehtësisht kursimet ndër vite apo edhe mënyrën e gjenerimit të këtyre të ardhurave. Prandaj mendoj që nuk ka vend as për z. Lani po as për kandidatët e tjerë që të gjobiten për faktin se i kanë deklaruar ato nuk është se i kanë fshehur të ardhurat. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit z. Nuri! Vazhdojmë me Edmond Komino, Bashkia Përmet?

Znj. J. Josifi: Mund të themi diçka në rastin e z. Lani, kandidatit?

Z. L. Braho: Po patjetër.

Znj. J. Josifi: Atëherë të ardhurat totale të deklaruara nga ky kandidat janë në vlerën, të ardhurat, shuma totale e të ardhurave korrespondon me shumën totale të shpenzimeve të vetëdeklaruara prej tij, është në vlerën 85 180 lekë nga të cilat 72 000 lekë kesh, fonde të tij dhe 13 180 lekë po "cash", po duke qenë që nuk kalonin limitin prej 50 000 lekë të caktuar nga ligji nuk janë pjesë e sanksionit. Sa i takon burimeve të financimit të fushatës zgjedhore dhe argumentit se është dhurim, është vetëdhurim, është financim, është vetëfinancim, i përmendur nga të dy përfaqësuesit e partive më të mëdha parlamentare, neni 86 i Kodit Zgjedhor, burimet e financimit të fushatës zgjedhore, thotë: "Burimet e financimeve të fushatës për subjektet zgjedhore janë: a. fondet e dhëna paradhënie nga buxheti i shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, b. të ardhurat e vetë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit”, nuk po vazhdoj me c dhe ç sepse jemi në të gjithë këtë llojshmëri dhurimesh ose të ardhurash, ndjesë në rastin e gërmës “b”, të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor, kandidatët janë subjekte zgjedhore, në zbatim të Kodit Zgjedhor. Kështu që trajtimi i të ardhurave si të jenë të vetë subjektit zgjedhor, si të jenë të ardhura të përfituara prej tyre nga të tretë do të duhet të trajtohej njësoj, pra përmes llogarisë së posaçme. Çdo e ardhur dhe çdo shpenzim.

Z. I. Rusmali: Meqenëse jemi te kjo histori dhe ndoshta këtë duhet ta sqarojë KQZ-ja në mënyrë përfundimtare. Kandidati vetë, që financon fushatën e tij, sa e ka limitin e financimit të fushatës? Është i përcaktuar ky limit?

Znj. J. Josifi: Nuk ka parashikim në Kod, por maksimumi i fondeve të pranuar është një milion lekë nëse i referohemi palëve të treta.

Z. I. Rusmali: Dakord, pra në qoftë se do e quajmë donacion, ai nuk mund të financojë fushatën me më shumë se sa një milion lekë. Ju i qëndroni zyrtarisht kësaj se këta duhet ta dinë këtë gjë, këta duhet të dinë paraprakisht se në qoftë se futen në betejë kaq e kanë limitin, një milion lekë nuk e kanë më shumë. Ose përndryshe nuk është donacion, është financim me të ardhurat e veta dhe limitin e ka o pakufi ose një shifër tjetër, ose nënvlerë të limitit të subjektit përfaqësues, një rregullim për këtë duhet se kështu nuk kemi kurrë qartësi. Ju u kini marrë deklaratimet e tyre, në ato shifra që ka, vetëfinancim “cash”, po e pranoni me termin donacion, por vetëfinancim “cash” në masën mbi 50 000 lekë, po mirë ka qenë një transaksion apo kanë qenë dhjetë transaksione nga 1 000 lekë secili? Si do ta ndajmë këtë sepse ju e keni raportimin e kandidatit, por kandidati nuk raporton çdo pagesë që ka bërë dhe ai thotë kam bërë pagesa në shumën kaq dhe për të kuadruar

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

të ardhurat thotë këto janë financime të mia në shumën korresponduese, por 70 000, 100 000, 300 000, 500 000 nuk është e thënë se është një veprim. Pra një donacion, mund të jetë çdo mëngjes kandidati pasi ha mëngjesin shkon në bankë dhe fut kuotën 50 000 lekë dhe këtë e bën çdo mëngjes dhe jemi në rregull apo duhet t'i themi jo mos e bëj këtë, mos ndiq zakone të tilla, bëj zakone të tjera që ne të jemi në rregull me ty! Një gjë që duhet të jetë e qartë për të gjithë kjo s'është fare e qartë dhe s'është as për ne. Ju thoni ka deklaruar "cash" 72 000 lekë, kur ai ka deklaruar nuk ka deklaruar "cash" të ardhura 72 000 lekë, ai ka thënë në logjikën e vet nga xhepi im kam futur 72 000 lekë, po këto të futura nga xhepi mund të jenë në të gjithë fushatën, jo në një rast.

Znj. J. Josifi: Më lejoni të them pse nuk e kemi konsideruar kështu, pra sikur ajo vlerë në këtë rast 72 000 lekë po çdo vlerë tjetër mbi 50 000 lekë është bërë në një veprim apo në disa veprime. Formulari që plotësohet për deklarimin e të ardhurave kërkon që për çdo të ardhur të plotësohet e njëjta fletë po e quajmë kështu. Pra një të ardhur plotësohen përkatësisht 16 fusha për një të ardhur, një ndër të cilat për shembull është data e dhurimit, është për çfarëdo lloj të ardhure. Pra njësoj deklarohet edhe e ardhura që merr nga buxheti i shtetit që i kalon në llogari, për partinë po flas, njëlloj.

Z. I. Rusmali: Kjo do të thotë që në rregullat tuaja, ju keni rregulla për plotësimin e këtyre formularëve. Në rregullat tuaja me siguri duhet të figurojë fjalia që për çdo të ardhur nga burime të vetat do të bëhet deklarim i veçantë dhe nuk duhet të mblidhen ato në një përmbledhëse të plotë. Pra nuk duhet të jepet shifra totale por sa herë që fusni dorën në xhep duhet ta deklaroni shifrën përkatëse si të tillë. E keni këtë udhëzim për njerëzit?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Nuk ka pasur asnjë konfuzion lidhur me këtë për sa kohë është deklaruar një datë konkrete ose ishin në rastin e kandidatës znj. Bufi, e cila kishte bërë vetëfinancim, po e quajmë kështu, në ditë të ndryshme, në shuma të ndryshme vetes, herë me transfertë herë me “cash”. Pra të gjithë janë të qartë që për çdo të ardhur në moment. Prandaj rasti i raportit financiar të znj. Bufi ishte 27 faqe, nga të cilat nëse dhjetë faqe kanë qenë të ardhurat, janë dhjetë të ardhura, dhjetë data.

Z. I. Rusmali: Edhe prapëseprapë nuk i shpëtoi gjobës.

Znj. J. Josifi: Ne kemi marrë çdo të ardhur, ne nuk propozuam sanksion për një të ardhur 300 000 lekë, e cila ishte bërë me transfertë bankare në një, ama atë të radhës që nuk ishte bërë me transfertë, po.

Z. I. Rusmali: Po mbledhjen a e keni bërë për financimin me fondet e veta, e ka kaluar një milion lekë?


Znj. J. Josifi: Jo asnjë nuk e ka kaluar.

Z. I. Rusmali: Mirë.

Z. L. Braho: Vazhdojmë me z. Komino. Po Edmond, ti duhet ti kthesh KQZ-së sipas KQZ-së 198 000 lekë të reja.

Z. E. Komino, kandidat për kryetar të Bashkisë Përmet: Këto janë shpenzime që kam bërë unë, kam paraqitur dhe të ardhurat, kjo është shuma e faturave që i kam bërë “cash”.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Këto ti i ke paguar nga lekët e tua?

Z. E. Komino, kandidat për kryetar të Bashkisë Përmet: Po.

Z. L. Braho: Po në llogari të posaçme i ke derdhur?

Z. E. Komino, kandidat për kryetar të bashkisë Përmet: Jo s'i kam derdhur në llogari të posaçme, mbase një çikë jo sqarim i mirë nga ky audit, se çdo gjë ishte e zgjidhshme. Audit ka thënë që këto pagesat "cash" nuk merren parasysh. Ai e paska shënuar te zëri dhurim dhe prandaj na erdhi kjo mangësi sot që jemi në këtë penalizim.

Z. L. Braho: E kuptoj, pra ti këtu deklaron që janë lekët e tua dhe i ke përdor për fushatë?

Z. E. Komino, kandidat për kryetar të Bashkisë Përmet: Po, janë faturat që janë paguar "cash".

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit Edmond!

Z. I. Rusmali: Faturat i ke, pagesat Edmond? Kanë shifra të mëdha pagesat? ke pasë kështu për bërë dasëm në Përmet ti? Dakord.

Znj. J. Josifi: Këtu flitet për dhurime dhe jo për shpenzime, pra flasim për pranim fondesh jo për shpenzime.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Si e kuptoj unë këtë punë? Këta kanë harxhuar ca lekë në fushatë, këto vlerat që janë këtu, 98, 140...

Znj. J. Josifi: I kanë gjeneruar para se t'i shpenzojnë.

Z. L. Braho: ...sepse në fillim nuk e kanë ditur dhe në fund fare e kanë kuptuar që i kanë harxhuar, me lekët e veta këto. Ideja është që këta kur dalin në fushatë duhet të dalin me këto formularët në xhep, sa herë shkojnë në ndonjë kafe dhe ai i zoti i lokalit nuk do që të paguajnë këta përherë duhet të plotësojë formularin që të konsiderohet dhurim! Shtatë kafe herë 50 lekë!

Znj. J. Josifi: Në fakt duhet të zbatojnë ligjin.

Z. L. Braho: Po ky është thelbi i gjësë.

Z. I. Rusmali: Pse lidhet gjëja me shpenzimet ishte pyeta jote, kur janë të ardhura. Në fakt procesin këta e kanë të bashkuar në një, fusin dorën në xhep, kapin të ardhurat dhe paguajnë shpenzimet, prandaj shifrat kuadrojnë.

Znj. J. Josifi: Këto të ardhura, nuk është ky problemi, nuk kemi evidentuar asnjë rast që të jetë shuma totale e shpenzimeve më e madhe se shuma e të ardhurave, nuk është ky diskutimi. Diskutimi është, të ardhurat e gjeneruara nga të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor sipas nenit 86, ne nuk po vëmë në diskutim vetë të ardhurat, vetë subjektit, të vetë kandidatëve në këtë rast. Sigurisht janë të tyre, do duhet t'i kishin kaluar përmes llogarisë së posaçme.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. I. Rusmali: Jo gjithmonë, në qoftë se fatura do të ishte mbi 50 000 lekë nuk e bënin dot sepse duhet ta fusnin në bankë, pastaj ta marrnin nga banka, jo direkt nga xhepi, ky është rregulli apo jo? Mbi 50 000 lekë të ardhura duhet të kalojnë nëpërmjet llogarisë bankare, mbi 50 000 lekë, po fatura është 49 000 lekë, fus dorën në xhep e paguaj dhe kam të ardhurat e mia mund t'i deklaroj 49 000 lekë po s'e kam detyrimin që t'ia kaloj nëpërmjet llogarisë, a është kështu apo jo?

Znj. J. Josifi: Ne po flasim për mbi 50 000 lekë.

Z. I. Rusmali: Gjithmonë shifra mbi 50 000 lekë, faturat që i kanë pasur mbi 50 000 lekë nuk i bënin dot aty për aty shlyerjet e detyrimeve, duhet të merrje, duhet të shkonin t'i çonin paratë në bankë, t'i nxirrnin nga banka dhe ta paguanin. Faturat nën 50 000 lekë mund t'i shlyenin aty për aty se s'ka problem, boll ta deklaronin që janë paratë e mia.

Znj. J. Josifi: Në këtë rast jemi për fatura mbi 50 000 lekë.

Z. I. Rusmali: Po këtë s'e dimë akoma ne. Mundi na e tha që i ka mbi 50 000 lekë po nga të tjerët nuk e dimë. Ju s'e keni bërë këtë verifikim. Ju keni marrë vetëm raportin, ju nuk keni investiguar shifrën, nga kanë ardhur paratë dhe tani çfarë janë përdorur paratë që të kuptonit janë disa të ardhura, shifra nënkupton disa herë futjen e dorës në xhep apo një herë dhe nënkupton disa pagesa apo vetëm një pagesë. Kjo duhet të hetohet nga auditi. Auditi s'e ka bërë, këta s'e kanë referuar, ju nuk e keni dhe ne rrimë dhe frymë sytë. Krahu andej e ka referuar, këta s'e kanë referuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*


Znj. J. Josifi: Edhe faturat, meqë jemi tek faturat në pjesën e raportit financiar të modelit të raportit që janë shpenzimet është e njëjta gjë. Plotësohet një formular me 16 të dhëna për çdo shpenzim, duke thënë numrin e faturës, apo të mallit, pra ne e dimë shumë mirë nëse është një veprim apo nëse është shumë e disa veprimeve.

Z. I. Rusmali: Në gjysmën e rasteve që keni shqyrtuar deri tani nuk ka qenë një veprim, kanë qenë më shumë se sa një veprim, ju e keni deklaruar, në gjobën tuaj si një veprim, tani dhe e dini mirë dhe pastaj...

Znj. J. Josifi: Po sepse në një veprim e kanë deklaruar kandidatët vetë në raport, e kanë deklaruar si një veprim.

Z. I. Rusmali: Të mos ngatërrohem kot, keni marrë për bazë raportin nuk keni bërë hetimin e realitetit. Ky ishte pretendimi, ju duhet të hetoni ngjarjen, jo të merrnit raportin. Ju thoni ata i kanë dhënë të gjitha gjërat dhe ne jemi të sigurtë që është ashtu. Ashtu vinë provat dhe thonë, jo nuk është një transaksion, janë tre transaksione por ne i kemi raportuar në një, se tonat janë fundja. Dakord është gabimi i tyre, dakord. Puna është që është raportuar si një transaksion, na futet te 73/5, por e raportuar si tre transaksione nuk është më shkelje apo jo? Jemi kështu apo jo. Tani midis asa që është shkelje dhe asaj që nuk është shkelje, ku do e gjejmë të vërtetën ne, kur ju nuk keni bërë hetim, kur auditi nuk ka bërë hetim. Ne na duhet të gjejmë të vërtetën, si është rasti dhe nuk e gjejmë dot sepse është ky konfuzion që krijohet midis raportimit dhe faktit dhe auditi dhe me siguri paqartësisë së rregullave se s'ka si të jetë ndryshe, kur këta kuptojnë një gjë dhe ju kuptoni një gjë tjetër.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*


Znj. J. Josifi: Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore kryen disa herë trajnime edhe për financierët e partive politike edhe për kandidatët qofshin ata të pavarur, qofshin kandidatë të subjekteve zgjedhore dhe ndërkohë është një nga detyrimet veç trajnimeve për hir të së vërtetës na duhet të themi se jo të gjithë kandidatët marrin pjesë në trajnime, detyrimet në zbatim të Rregullatorit, financierit të partisë t'i njohi ata me rregullat. Ajo që ne mund të bëjmë me të drejtë për të kërkuar të vërtetën siç ju e thatë është të marrim statement atëherë të secilës llogari të posaçme.

Z. I. Rusmali: Janë padiskutim, ne nuk futemi në këto, janë nxënës të këqinj, s'kemi ç'i bëjmë, dakord. E kuptuam, ju e keni bërë shumë mirë, këta janë nxënës të këqinj, ju keni vetëm një detyrë të ndani kush futet në betejë e ka kufirin një milion lekë apo nuk ka kufi? Se mbi këtë bazë vjen gjithë arsyetimi, këtë s'e keni ndarë me sa kuptova, po kjo duhet ndarë se mbi këtë bazë vjen gjithë trajtimi i financimit të këtyre zonjave dhe zotërinjve këtu dhe gjithë mënyra e raportimit të tyre. Kjo është shumë e rëndësishme. Donatorë të vetvetes apo financues të vetvetes, janë dy gjëra të ndryshme dhe kanë regjim juridik të ndryshëm, duhet të na e ndani. Kjo është pjesa e rregullave që ne po ankohe mi, po nuk është faji juaj. Pjesa tjetër është nxënës të këqinj, të pavëmendshëm, zezzekë e ku di unë me radhë, ata e kanë fajin, ju kurrë!

Z. L. Braho: Faleminderit! E kemi lënë te z. Komino. Vazhdojmë me z. Elvis Hajdërlli është i Bashkisë Devoll, është vetë Elvizi?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po është vetë prezent.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Elvis ti e ke 223 762 lekë.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Andej nga zonat tona thonë, mirë gomari që na ngordhi po s'na lënë rehat as mizat! Tani te raporti im janë 68 fletë të plotësuar, fatura pas fature, të gjitha detajet, janë 45 fatura karburanti, një qenka 20 000 lekë edhe pagesa e facebook-ut, të tëra të detajuara, s'e kuptoj pse.

Z. L. Braho: Ti s'i ke bërë në bankë këto, i ke bërë "cash"?

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë, Devoll: Po, "cash". Nga llogaria ime, i kam marrë lekët dhe 30 000 lekë hidhja karburant.

Z. L. Braho: Nga cila llogari, llogaria e posaçme apo?

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Jo individuale.

Z. L. Braho: Po llogari të posaçme kishe ti?

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Jo.

Z. L. Braho: Pra i bëje tërheqjet nga llogaria individuale dhe ke bërë pagesat?

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Po.

Z. L. Braho: Po facebook-un e ke paguar direkt me kartë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar bashkie, Devoll: Me kartë.

Z. L. Braho: Pra që prapë të është zvogëluar shuma në bankë, po administrata e KQZ-së?

Z. I. Rusmali: T'i bëj një pyetje administratës? Në formularin e kandidatit, jo të subjektit politik për regjistrim, po të kandidatit të subjektit politik për regjistrim, ekziston zëri që këta duhet të deklarojnë llogarinë siç është për subjektin politik? Subjekti politik ku regjistrohet duhet të deklarojë dhe llogarinë e posaçme, këta e kanë që duhet të deklarojnë llogarinë e posaçme?

Znj. J. Josifi: Po nëse planifikojnë që do të pranojnë gjatë fushatës zgjedhore fonde, po. E deklarojnë që në fillim në momentin e regjistrimit.

Z. I. Rusmali: Është në formular pyetja, nuk është çfarë bëjnë, në formular shkruhet numri llogarisë së posaçme për zgjedhjet e kandidatit, shkruhet kjo gjë? Në qoftë se kjo është opsionale, nëse mendojnë se është pjesë e praktikës, dokumentacionit, formulari me të cilin deklarojnë që nuk kanë në plan të marrin donacione? Ose, ose është njëri ose është tjetri apo jo?

Znj. J. Josifi: Nuk ka një formular për të deklaruar paraprakisht që nuk planifikon të marrë për pasojë llogari...

Z. I. Rusmali: Dakord, gjysma e fjalisë na mungon, gjysma e parë është?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Znj. J. Josifi: E deklaron, patjetër ka detyrimin të deklarojë të dhënën e llogarisë së posaçme.

Z. I. Rusmali: Është në formular?

Znj. J. Josifi: Po dhe kjo llogari përshkruhet në të dhënat e formularit si llogaria ku janë derdhur të ardhurat, pra jepet çdo e dhënë e llogarisë, kodi bankar i llogarisë, numri i llogarisë, emri i bankës, etj.

Z. J. Rusmali: Çfarë ke plotësuar këtu ti?

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Po i kemi dhënë llogarinë individuale, timen.

Znj. J. Josifi: Është llogaria individuale ajo që thotë zotëria nuk është llogaria e posaçme.

Z. E. Hajdërlli, kandidatë për kryetar të Bashkisë Devoll: Individuale, nuk kemi pasur llogari të posaçme.

Z. I. Rusmali: Ia keni pranuar në dokumentat e kandidimit si llogari të posaçme.

Znj. J. Josifi: Atëherë unë e kam përpara formularin, rasti për shembull.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Atje numër llogarie lexon.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Atëherë zotëria këtë vlerën 223 762 lekë e ka shumë të vlerave mbi 50 000 lekë, njëra nga të cilat, për shembull, po lexoj njërin nga shumat, pjesë të shumës, është 143 762 lekë, është faqja 2.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Të cilat janë 45 fatura hedhje karburanti në ditë të ndryshme.

Znj. J. Josifi: Flasim për të ardhura ju lutem, jo për shpenzime, jemi tek të ardhurat, e keni deklaruar të ardhur edhe për analogji në formular deklaroni.

Z. I. Rusmali: I ka marrë nga llogaria, pretendimi, pastaj e diskutojmë është i vërtetë pretendimi apo jo.

Znj. J. Josifi: Atëherë jo sepse...

Z. I. Rusmali: Të lutem prit, tha i kam marrë nga llogaria ime, të cilën thotë e kam deklaruar zyrtarisht si llogari të posaçme për zgjedhjet, kështu thotë ky.

Znj. J. Josifi: Jo nuk ka deklaruar llogari të posaçme fare, numër llogarie të posaçme.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Te formulari i deklaramit si kandidat kam deklaruar llogarinë, numrin e llogarisë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Do ta verifikojmë te formulari por të ardhurat, pra në raportin tuaj financiar ju nuk e keni deklaruar as llogarinë aty e cila, as ato ku janë derdhur të ardhurat, pra asnjë llogari, është bosh llogaria këtu, është faqja.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Te formulari i pranimit të kandidimit për kryetar bashkie është deklaruar llogaria.

Znj. J. Josifi: Atëherë në rastin e faqes 4 të raportit tuaj, i keni sërish dhuruar vetes dhe në këtë rast është vlera 59 004 lekë, pra është mbi 50 000 lekë, data e dhurimit 17 prill, metoda e dhurimit kartë krediti/debiti jepet kodi bankar i llogarisë, jepet numri i llogarisë, jepet emri i bankës. Pra në këtë rast e keni bërë me transfertë pranimin e këtyre fondeve, sërish nga vetja, sërish mbi 50 000 lekë, jemi në rregull.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Kam kartën e krediti që është paguar facebook-u.

Znj. J. Josifi: Ju lutem e keni si të ardhur, jo shpenzim, nuk jemi tek shpenzimet, pra keni gjeneruar edhe para “cash”.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Mos ngatërrohi të ardhurat, është në total.

Znj. J. Josifi: Keni gjeneruar të ardhura edhe në formë “cash”, edhe me kalim bankar. Tani ne nuk kemi propozuar sanksion për ato që kanë kaluar përmes transfertës bankare, siç ishte ky rasti për shembull 59 004 lekë. Ama ato që janë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

“cash” kemi propozuar sanksion dhe janë 50 000 lekë. Pra i kemi parë secilën nga të ardhurat si një veprim i mëvetësishëm. Vijon sërish shuma e dhurimit 3100 lekë “cash” nuk ka asnjë lloj sanksioni, pra e kemi lexuar shuma e dhurimit 20 000 lekë “cash”, asnjë lloj, nuk kemi propozim. Pra kudo ku është “cash”, ja rasti i dytë që është shuma, ju thashë kjo vlerë është shuma e dy shumave, i keni dhuruar vetes 80 000 lekë, sërish në “cash”, në 18 prill. Po flasim për të ardhura jo për shpenzime. Më lejoni të shkoj dhe te shpenzimet. Atëherë nëse ky është rasti që nga llogaria personale kandidati ka tërhequr para, një shumë mbi 50 000 lekë, e ka tërhequr dhe këtë e ka vijuar trajtimin e kësaj shume në “cash”, jashtë rrugëve bankare sigurisht që është shkelje e Kodit, do të duhet ta kishte depozituar këtë në llogarinë e tij të posaçme si kandidat. Nuk po diskutojmë fare shpenzimet, nuk jemi fare te shpenzimet, jemi tek te ardhurat. Atëherë këtë gjendjen dakord, e ka të vetën. Çdo veprim i bërë për të ardhurat dhe shpenzime në kuadër të fushatës zgjedhore të një kandidati apo të një subjekti zgjedhor qoftë parti, qoftë kandidat, qoftë koalicion bëhet vetëm dhe vetëm nëpërmjet llogarisë së posaçme të subjektit, për sa kohë s’kemi fakte, llogari të posaçme dhe nuk mund, si mund ta gjurmojmë, si mund ta gjurmojmë për transparencë.

Z. E. Hajdërlli, kandidat për kryetar të Bashkisë Devoll: Ku është parashikuar kjo? E kam deklaruar në fillim.

Znj. J. Josifi: Ja ta verifikojmë atëherë nëse ka deklaruar këtë, dakord.

Z. L. Braho: Vazhdojmë me zotin Ethem Dumani, Bashkia Kolonjë, është Ethemi? S’është. Evdar Kodheli? Hajde Evdar se ke gjithë kohës që je aktiv pa mikrofon,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

kështu që tani ke gjithë mundësinë të shprehesh. Ti ke për kthyer 192 000 lekë. Jo do i kthesh, do i paguash në formë gjobe.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Quhem Evdar Kodheli, ish kandidat për Bashkinë Fier, nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”. I nderuar z. kryetar, të nderuar trupi gjykues, të nderuar kolegë! Ju faleminderit për prezencën këtu që na e dhatë këtë mundësi të ballafaqohemi është, na erdhi si e papritur kjo. E paranë bazë të ligjeve të vendit ne kemi plotësuar formularët dhe na janë pranuar formularët për kandidatë për kryetar bashkie, ku aty kemi deklaruar të gjitha të dhënat personale, përfshirë adresën, përfshirë numrin e celularit dhe adresën elektronike të emailit, patjetër dhe numri i llogarisë bankare, llogari e posaçme në rastin tim. E drejta e informimit, patjetër që shteti do bëjë detyrën, KQZ-ja aq më tepër do bëjë dhe transparencën, por në momentin që ka një auditim, bëhet dhe një raport paraprak i auditimit për secilin, për të cilin unë nuk jam informuar dhe jam informuar vetëm nga media. Unë kryej një detyrë të caktuar që më lidh puna me shumë biznese, me shumë subjekte, qoftë individë, qoftë privatë, kam një studio kontabiliteti dhe ligjore në Fier, gjë e cila më dëmton tmerrësisht shumë imazhin kur bëhet fjalë për gjoba personale sepse unë jam ai individ që përfaqësoj subjektet nëpër të gjitha institucionet shtetërore por dhe ato të drejtësisë, që në këtë rast unë e konsideroj, pavarësisht që mund të kem bërë shkelje, por e konsideroj një shkelje nga ana e KQZ-së të drejtës time personale por edhe juridike sepse njëkohësisht jam edhe administrator i një shpk-je dhe ortak i vetëm i asaj shpk-je. Pra e drejta e informimit në rastin e parë mungon totalisht nga KQZ-ja. Raporti i auditit, bëhet një raport paraprak i auditit i cili, në bazë të të cilit bëhet një observacion dhe nëse do të ishte bërë ai observacion në rastin tim jam i bindur që nuk do ishim këtu sot sepse të ardhurat e mia personale vërtet janë, unë i kam

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

deklaruar “cash”por i kam bërë dhe i kam tërhequr nga llogaria ime individuale e pagës në dy banka, Banka Kombëtare Tregtare dhe tek Tirana Bank, çka do të thotë të gjitha fondet e deklaruar për shpenzimin e fushatës, kam tërhequr dhe nuk i kam depozituar te llogaria e posaçme po kam bërë shpenzime sipas varianteve ditore që kishim gjatë fushatës. Pra pamundësia e observacionit solli këtë ku jemi sot. Ka qenë një keqinformim ose keqinterpretim i ligjit përkatës mbi të cilin unë jam dënuar sepse në një pikë thuhet, e kam cilësuar dhe në ankimin që i kam drejtuar trupës suaj, që nuk e kam përdorur llogarinë e posaçme por e kam konsideruar donacion nga palë të treta mbi 50 000 lekë të reja kurse unë nuk jam palë e tretë. Unë jam vetë individi për të cilin bëhet fjalë, që kështu mua nuk kushtonte gjë që këto fonde t’i transferoja nga BKT apo nga Tirana Bank ku i kam tërhequr “cash” dhe për këtë unë ju siguroj dokumenta, prandaj e përmenda dhe pak më sipër që nëse do të kisha mundësinë e observimit të raportit paraprak do isha i bindur që ekipi i auditit do t’i kishte marrë në konsideratë të gjitha tërheqjet që kam bërë unë nga banka dhe do të ishim në konkluzion tjetër dhe lidhur me shpenzimet.

Z. L. Braho: Nuk jemi për shpenzimet këtu.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Shpenzimet totale a është vetëm një zë shpenzimi 192 000 lekë?

Z. L. Braho: Sa është zëri i shpenzimeve?

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të bashkisë Fier: Janë disa, janë shumë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Çfarë ke paguar me këto lekët ti, me 192 000 lekë?

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Fletëpalosje, kartvizita, qera ambienti, karburant, lokale pafund, unë jam i bindur në këtë sallë të gjithë kemi vlera “cash”, dakord dhe në Republikën e Shqipërisë nuk janë të ndaluara pagesat “cash”.

Z. L. Braho: Po kur je kandidat ke disa detyrime të tjera.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar Bashkisë Fier: Patjetër që po.

Z. L. Braho: S’je njësoj si ne që jemi qytetarë të thjeshtë.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Patjetër që po dhe unë pranoj pjesën e fajit nëse do kisha informimin dhe nëse do të ishin zbatuar të gjitha pjesët ligjore nga KQZ-ja është që unë nuk i kam derdhur po nuk ka logjikë normale që unë t’i marr nga një numër llogarie, t’i derdh tek një numër llogarie dhe pastaj të vete tek lokali i fshatit, të vete të paguaj kafe apo dreka që gjithsecili nga ne është i vetëdijshëm çfarë ndodh nëpër fushata elektorale.

Z. L. Braho: Tani të të bëj një pyetje, kur je vënë në dijeni për këtë propozimin për gjobë apo sanksionohesh adminastritivisht.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Me 28 tetor të këtij viti.

Z. L. Braho: Pra ti nuk e ke ditur që po hetohesh.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Absolutisht jo, e kam lexuar në media sociale ku një miku im, shoku im ma dërgon në whatsapp, më thotë mua paske dalë në gazetë, urime më tha mua paske marrë gjobë, po çfarë gjobe, pastaj komunikoj me partinë.

Z. L. Braho: Ti thua financat tona.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Me 28 tetor, ju tregoj dhe komunikimin në whatsapp, direkt unë komunikoj me partinë dhe e vë në dijeni për këtë histori dhe pastaj vijon rrjedhshmëria e komunikimeve elektronike me këtë problem.

Z. L. Braho: Po audituesi nuk të ka ardhur ndonjëherë.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Absolutisht nuk isha në dijeni, me një fjalë kontakti im i parë dhe i vetëm deri në 28 tetor ka qenë një komunikim me një mesazh në whatsapp nga një miku im.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit!

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Ju faleminderit dhe juve.

Z. L. Braho: KQZ-ja dhurime kesh, vetëdhurimi “cash”?

Znj. J. Josifi: Sa i takon pak kësaj.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Jo s'ka gjë.

Znj. J. Josifi: E këtij procesit që bëhet paraprakisht me projektraportin e audituesit, pastaj raportin përfundimtar etj., në çdo rast ky proces bëhet, është detyrim, madje projektraportet i paraqiten subjektit të audituar duke vënë në dijeni KQZ-në. Tani është e pamundur që audituesi të kontaktojë të gjithë kandidatët, jo thjesht për arsye praktike apo objektive në rastet e partive që kanë shumë kandidatë por sepse rregullat e përcaktuara në vendimin e Komisionit Rregullator për raportimin financiar e bëjnë fare të qartë që përgjegjësia për këtë është e financierit. Pra audituesi në projektraportin...

Z. L. Braho: Po pra po lekët po ua kërkoni këtyre tani.

Znj. J. Josifi: Një moment të lutem, një sekond. Atëherë audituesi projektraportin ia paraqet partisë, financierit të partisë, ashtu sikundër observacionet i vinë nga financieri i partisë, që do thotë do të duhet që financieri i partisë dhe partia kur bëjnë observacion për elementë të raportit të partisë, të të ardhurave dhe shpenzimeve të partisë ta bëjnë dhe për kandidatët, se këta nuk janë kandidatë të pavarur, nuk janë të pavarur. Financieri i partisë neni 7, pika 4, gërma "a" administron, mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë e tij, duke administruar veprimtarinë financiare të fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor, regjistruar në të gjitha transaksionet financiare të bëra për qëllim të fushatës si dhe gjurmon, çdo shpenzim ose kontribut, për hapjen dhe deklarimin të llogarisë bankare të posaçme, në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor dhe siguron që dhurimi i fondeve jopublike mbi masën 50 000 lekë bëhet vetëm nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme, te gërma "d".

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Mund të bëj një ndërhyrje të vogël për sa thotë zonja, ju lutem?

Z. L. Braho: Një minutë ju lutem të mbarojë zonja.

Znj. J. Josifi: Administron të gjithë veprimtarinë financiare për fushatën zgjedhore të kandidatëve të listave shumemërore, të vënë në dispozicion nga këta të fundit, e dorëzon raportin financiar të fushatës duke u kujdesur që të jetë i plotë dhe sigurohet që t'i kthejë përgjigje në mënyrë të plotë dhe në çdo kohë, çdo kërkesë për informacion të paraqitur nga audituesi ligjor apo KQZ-ja.

Z. L. Braho: Pra ju thoni që...

Znj. J. Josifi: Pra ne e kemi kryer këtë proces.

Z. L. Braho: Financeri i partive.

Znj. J. Josifi: Patjetër, pra do të duhet, ura lidhëse e përcjelljes së informacionit, e marrjes së informacionit midis subjektit zgjedhor, parti, e cila po ashtu mban përgjegjësi ligjore për kandidatët, bëhet përmes financierit të partisë edhe me audituesin edhe me KQZ-në.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: E nderuar, një ndërhyrje, nëse do të mbajmë një standard, mbajmë një standard. Nëse këtu është përgjegjësi e partisë, atëherë këtu duhet të ishte partia dhe jo ne.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Znj. J. Josifi: Për komunikimin.

Z. E. Kodheli, kandidat për kryetar të Bashkisë Fier: Nëse ne jemi thirrur në mënyrë individuale këtu, atëherë duhet të raportojmë mbi të drejtat individuale dhe raportim individual, çka do të thotë që KQZ kur merr një masë administrative ose propozon një masë administrative karshi një kandidati duhet të ndjekë rrugën e informimit individual të kandidatit sepse po na kërkoni, në radhë të parë po na dëmtoni imazhin. Në radhë të dytë po na dëmtoni bukën e fëmijëve, në radhët të tretë nuk po na lini rehat që të punojmë. Pra, ne duhet të mendojmë në kompleksitet përpara se të përmendim emrin e qoftë edhe të një individi të thjeshtë dhe jo më ne përfaqësojmë ca votues në një zonë të caktuar apo që përfaqësojnë edhe biznese dhe individë me potencë në zona ku jemi. Prandaj e drejta e informimit dhe të drejtën e observacionit për një akt që merr në mënyrë individuale është e drejtë kushtetuese. Ju faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Z. Fatmir Shero, Bashkia Konispol? Nuk është z. Shero. Z. Fisnik Qosja? Nuk është z. Qosja. Z. Hasim Çekrezi? Nuk është Hasim Çekrezi. Hilë Curri? Nuk është Hila. Hysni Sharra? Atëherë z. Sharra, ju paskeni një vlerë të konsiderueshme prej 452 311 lekë që duhet ta paguani në formën e gjobës. Tani na sqaroni pak çfarë janë këto lekë?

Z. H. Sharra, kandidat për kryetar bashkie: Unë jam nga më të dalluarit edhe në ndonjë skeç litarin do e kisha pak, megjithatë pa u bërë përsëritës do them dhe unë ato të miat që asnjë njoftim paraprak nuk kemi pasur, por jemi njohur me vendimin nga gazetata, nga shoqëria, nga facebook-u, mediat sociale, etj, etj. Meqenëse u tha

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

që KQZ-ja trajnon, s'po them në Vlorë, në Fier, a ka ardhur dikush, ndonjë ekip që të trajnojë financierët e degëve apo financierët e partisë në qendër sepse unë s'kam asnjë njoftim dhe nuk di asnjë gjë për këtë. Koncepti tjetër ndaj që për faj të invidëve po gjobisim partitë. Tani për faj të financierit që i bie partia ne po gjobisim individët, pra janë dy qëndrime, dy standarde dhe janë gjëra që nuk kanë sens. Tjetër gjë që doja të thosha unë ka të bëjë me konceptimin e kësaj gjëje. Fakti është se siç e tha z. Rusmali ne jemi përballë një shpenzimi të konstatuar, i cili duhet të përballohet nga një e ardhur që është vetëfinancim, nga vetja jote apo nga të tretë, persona fizikë apo juridikë dhe si pasojë e këtij shpenzimi ne duhet ta përballojmë me një fond të caktuar, pra nuk është se ne çdo fond që financojmë veten apo të tjerët mbi vlerën 50 000 lekë, s'po e derdhim te ajo llogaria personale apo te llogaria e posaçme dhe kemi kryer një shkelje të ligjit, pra këto janë parë, përveç kësaj janë parë dhe në mënyrë kumulative do thosha unë sepse janë disa transaksione, madje unë do ju lutesha zotërinjve të KQZ-së të tregojnë pjesë të deklarimit tim ku thuhet që edhe për një faturë të facebook-ut 30 cent, po flasim për 30 cent të dollarit, të deklarosh të ardhura 30 cent, pra për të barazuar një shpenzim të caktuar ne jemi të detyruar ta deklarojmë atë si e ardhur dhe kjo nuk ka lidhje fare me atë vlerën prej 50 000 lekësh. Kjo është ideja, madje deklarimi ka qenë online, ka qenë eksperiment për herë të parë dhe është plotësuar me qindarka, është siç e thashë unë, derisa janë shpenzuar miliona euro për këto projektet dhe për mënyrën e deklarimit mund të shpenzoheshin edhe ca të tjera për trajnimin e njerëzve, kurse për vlerën që paguhet legjislacioni tatimor kur kemi të bëjmë persona fizik/juridik që është shërbim individ vlera është 150 000 lekë fare, por meqenëse kjo pjesë trajtohet në burimin e të ardhurave në vlerën 50 000 lekë edhe unë do isha në atë që të bëj transparencë. Në qoftë se ka transaksione me vlerë mbi 50 000 lekë, por nën 150 000 lekë, pra për shpenzime edhe ajo është e lejuar nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

ligji, kështu që pa u zgjatur dhe pa ju lodhur edhe ju të tjerëve doja t'ju falenderoja, të nderuar ne nuk e kemi pasur këtë mundësi të degjohemi gjatë procedimit administrativ që ka kryer Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe besoj që sqarimet që ne dhamë do të jenë shteruese, përfundimtare edhe vlejné si eksperiencë për herët e tjera.

Z. L. Braho: Faleminderit z. Sharra! Tani për këtë vlerën, kjo është vlerë e financuar nga ana jote, vetëfinancim?

Z. H. Sharra, kandidat për kryetar bashkie: Plotësisht.


Z. L. Braho: Që ke bërë pagesa të ndryshme gjatë fushatës. Mirë. Z. Igli Cara? 368 135 lekë z. Cara.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Është vete prezent, gjithashtu ka paraqitur dhe prokurë po i japim një kopje KQZ-së.

Z. L. Braho: Dakord.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Faleminderit z. kryetar! Të nderuar anëtarë të KAS-it, të nderuar përfaqësues të KQZ-së! Në fakt u mendova gjatë duhet të flas apo jo se në fakt shumë argumentë ishin shterues, por në respektin tuaj dhe të gjithë kandidatëve por dhe të problematikës, mendova të them dy fjalë dhe më tepër do ta bazoj, jo tek argumenti po u nisa për të folur për argumentat e mia, por fakti që kam pasur disa detyra më shtyu të mendoj që dua të them ca gjëra të vërteta. Në fakt të gjithë kandidatët, çuditërisht u njoftuan më

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

shumë se një ditë më mbra për shkeljet që kishin bërë dhe u etiketuan shkelës të ligjit me penalitete të ndryshme, pavarësisht vlerave nëpër media. Dëgjova përfaqësues të KQZ-së që thanë që është detyrim ligjor që auditi para se të bëjë projektin për projektvendimin përfundimtar duhet që së pari t'i kishte dëgjuar kandidatët sepse me thënë të drejtën, pavarësisht se sot jemi këtu, kandidati siç ka privilegjin të përfaqësojë një qytet ka dhe detyrimet ligjore, por dhe duhet të respektohet. Mënyra se si KQZ-ja i ka trajtuar kandidatët në këtë pikë nuk më duket aspak dinjitoze, mos të them ofenduese dhe në fakt duke qenë se kam pasur detyrë dikur të jem ligjvënës, ndoshta duhen pikërisht këto takime për të iniciuar ligjet. Dëgjova përfaqësues të KAS-it me shumë vëmendje dhe ju falenderoj se i ngritët pyetje dhe problematika që lidhen pikërisht së pari me atë çfarë trajton ligji. Diku quhet dhurim, diku quhet vetëfinancim, diku një term tjetër dhe çuditërisht kandidatët nuk kanë të gjithë formimin që të jenë as juristë, as financiarë dhe shpeshherë kanë nevojë për ndihmë. Kuptohet që ne kemi pasur përfaqësues tonë, financiar, juridikë por mënyra se si është ai drafti që plotësohet, kuptohet që mund të lërë shteg gabime të mundshme, prandaj ndodh pikërisht nga këto takime duhet të lindin dhe iniciativa ligjore për të ndryshuar pikërisht atë që ju thatë zotërinj. Për të ndryshuar që edhe kandidati të jetë i qartë dhe të mos gjendemi këtu dhe pavarësisht se kemi deklaruar çdo shpenzim, sado i vogël, qoftë dhe një euro, gjendemi këtu sikur jemi në bankë të akuzuarve për shkelje të mëdha. Nuk ka rëndësi sa është vlera, rëndësi ka na trajtuan apo jo dhe për dinjitet, pavarësisht se kush tha që kemi dhe bukën e gojës. Nuk mund të dalim ne nëpër media që kemi bërë shkelje dhe kemi bërë x gabime, kur normalisht, minimumi në respekt të këtyre përfaqësuesve që dalin në të gjithë Shqipërinë, që janë kandidatë për të udhëhequr pikërisht qytetet e tyre, mos të kemi minimumin e respektit, të thërritemi edhe për t'u konsultuar dhe çfarë gabimesh kemi bërë dhe nuk është e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

vërtetë dhe është një justifikim do të thoja, nuk dua të përdor term që kemi njoftuar ne, apo financuesit e partive. Po mirë kur na pranuan dokumentacionin për të dalë kandidat a na kërkohet emaili, telefoni, të dhënat, bankat, llogaria e posaçme dhe të gjitha? Kaq të vështirë ishim ne për t'u gjetur dhe për t'u thërritur se nuk bëhet fjalë që qenkan 10 000 siç cilësua diku aty, bëhet fjalë që aty maksimumi, nuk e di janë 30 vetë, 30 kandidatë, s'ka rëndësi a janë të majtë apo të djathtë. Po kjo është e turpshme sepse para se të vij këtu unë ndoshta nuk do të bëja fare ankimim, në qoftë se do të kuptoja që në origjinë që unë kam bërë gabim sepse dënohemi apo jo ne sot, merret apo jo parasysh kërkesa e KQZ-së për t'u penalizuar është e rëndësishme po jo aq sa kjo që po them, se kjo punë do të vazhdojë, para një viti paska qenë kolegu ynë Muka, që ju me të drejtë e keni rrëzuar kërkesën e KQZ-së. Tani vimë ne, disa të tjerë pas një viti do të ketë përsëri të njëjtën situatë KAS-i. Ka punë të tjera më të rëndësishme KQZ-ja për të kapur disa shkelje të rënda, akoma më të rënda me vlera mijëra herë më të mëdha gjatë fushatës, po nuk e bën dhe çuditërisht vetëm nga deklarimet tona që mund të jenë plotësuar dhe gabim, se njerëz jemi, çuditërisht kapen dhe penalizohen në maksimum, prandaj në qoftë se më lejohet kjo do të ishte një kërkesë e jona, besoj unë, jo vetëm e imja që mundësisht duke qenë se ju jeni njerëz që keni përgatitje shumë më tepër se ne në këtë fushë, bëni dhe ndryshimet ligjore që ne mos të gjendemi përballë këtyre situatave siç thashë më sipër. Për sa i përket rastit tim, unë jam pak a shumë tipologjia është e njëjtë, pranimi i fondeve me vlerë më të madhe se 50 000 lekë përmes formës, po e them se ju e dini tanimë. Nuk kam asnjë rast të tillë për pranim fondesh mbi 50 000 lekë, sipas nenit 173, pika 5. Pra nuk besoj që ekziston ky penalitet. Vazhdojmë më tej me nenin 92/3, deklarimet e publikimit, nuk po e citoj fjalë për fjalë subjektet janë të detyruara brenda 60 ditëve, ky është qartësisht i respektuar nga ana ime. Nuk është që KQZ-ja në këtë pikë sepse është brenda

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

afateve. Raportet financiare hartohen sipas modeleve dhe kjo çdo dhurim me kredi janë bërë qartësisht të deklaruara sipas nenit. Por në këtë pikë kuptojmë që dhe kandidati ka të drejtë të vetëfinancojë fushatën e tij me anë të fondeve të tij private. Të ardhura të tij të siguruara nga puna apo familja me të cilën jeton, bashkëjeton. Për sa është fondi limit me të cilin kandidati mund të financojë fushatën e tij e gjejmë këtë informacion të shprehur në nenin 92/1, ku pika 2 thuhet “Shuma që çdo person fizik apo juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se një milion lekë ose sikundër vlerë dhe shërbime”. Unë penalitetin e kam 368 pra më poshtë, por që të bëj një detajim se ndoshta dhe përfaqësuesit, të nderuar të KQZ-së e kanë, bëhet fjalë për vetëm dy fatura të hapjes dhe të mbylljes së fushatës, të një firme dhe me thënë të drejtën kjo është bërë me datë 11, tre ditë para mbylljes së fushatës dhe është bërë sepse fatura siç ju e dini janë dhe “cash” dhe me llogari dhe është bërë në “cash”, pasi janë tërhequr nga llogaria ime e posaçme, sërish më thotë financieri se unë nuk e kam këtu po i kërkova tani që të më sjellë statement që t’jua paraqes dhe pastaj si provë. Pra nuk ka fonde të dhuruara nga dikush tjetër apo subjekt tjetër, janë fonde të miat të cilat kanë bërë me faturë tvsh-je, është mbyllja e fushatës me sa më kujtohet është firma Cakul, numri nuk më kujtohet, mund t’i gjej se e kam aty, po pak a shumë është kjo tipologji. Pra kam marrë paratë dhe pastaj i kam derdhur “cash” sepse kështu e donte, e donte faturën me para në dorë. Të gjitha të tjerat KQZ-ja me sa di nuk më ka thënë gjë tjetër, të paktën ky është rasti se këto dy fatura përputhen me vlerën 360 000 dhe unë do të mbi të gjitha thashë, ndoshta, në fakt mendova në fillim të mos flas fare për çështjen time po ndoshta dhe në respekt të asaj çfare dhe avokati Nuri mund të thoshte pastaj, e sqarova pak a shumë. Gjë tjetër nuk kam po ju uroj punë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Faleminderit z.Cara! Po z. Nuri ke ndonjë gjë për të shtuar?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo z. Cara ishte mjaft shterues në dhënien e detajeve lidhur me rastin e tij konkret, unë do t'i rikthehem dhe njëherë jo vetëm elementit që ligji është i paqartë, rregullat janë të paqarta dhe jemi në përsëritje sepse dhe rasti i z. Muka u përmend që ka qenë përpara disa muajve, përpara një viti, sot jemi më me shumë kandidatë, ndoshta herës tjetër, për zgjedhjet e tjera do të kemi akoma më tepër nëse vazhdojmë me këto rregulla dhe i bashkohem thirrjes së z. Cara që KQZ-ja të përcaktojë rregulla të qarta dhe të mos ketë ambiguitet e para. E dyta është problemi i njoftimeve që u tha, patjetër që nuk kanë marrë njoftime në kohën e duhur dhe ndoshta po të kishin një komunikim më të mirë me kandidatët nga ana e KQZ-së, mund t'i kontaktonin drejtpërdrejt ata nëpërmjet kontakteve publike që ata kanë pasur apo numrave të telefonit, por ajo që dua të them është që jo vetëm nuk ka pasur shkelje, por ligji është mjaft i qartë, për vlerat mbi 150 000 lekë të reja legjislacioni tatimor të detyron që të bësh pagesat në bankë. Në këtë vlerë je i detyruar t'i bësh në formën që ta kërkon biznesi dhe në rastin konkret, për rastin e z. Cara faturat janë të prera nga biznesi, janë të lëshuara nga bizneset "cash" dhe nuk mundet që t'i paguante nëpërmjet bankës, kur vetë biznesi ta kërkon pagesën me "cash", sikundër e lejon dhe ligji. Më korrigjoni nëse gabohem në këtë pikë apo dhe rastet e tjera që janë paguar pagesat e facebook-ut, u tha dhe më përpara facebook-u i pranon si kompani pagesat e reklamimeve edhe marketingut online që është shumë i rëndësishëm në fushatat elektorale të kohëve moderne, këto pagesa i pranon vetëm nëpërmjet një llogarie bankare të lidhur me kartën e krediti dhe një nga kandidatët tanë që u shpreh më përpara e shpjegoi mjaft qartë që llogaria e posaçme edhe në qoftë se do të ishte e tillë nuk të lejon banka që të kesh një kartë bankare për atë llogari të posaçme, që më pas të bësh

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

dhe pagesat e reklamimeve të rrjeteve sociale, për të mos i bërë reklamë facebook-ut apo ndonjë rrjeti tjetër social. Pra e kishin të domosdoshme që këto pagesa, këta kandidatë për marketingun e tyre politik kaq të domosdoshëm, ta kryenin nëpërmjet llogarive personale ku kanë kartat e kreditit apo debitit në sistemin bankar dhe e fundit duket nga ky trajtim që është për të gjithë kandidatët dhe jo vetëm për rastin e z. Cara po të gjithë kandidatëve pa dallim ngjyrimesh politike duket sikur KQZ-ja do të penalizojë dhe sanksionojë definitivisht pagesat “cash”, nëse kjo do jetë qëndrimi që do të duhet që në të ardhmen çdo pagesë për fushatë bëhet vetëm nëpërmjet sistemit bankar le ta miratojnë një akt të tillë po nuk e di se sa produktive do të ishte. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit z. Nuri! Përfaqësuesja e KQZ-së për rastin e z.Cara për vlerën, çfarë informacioni keni aty nga audituesit?

Znj. J. Josifi: Kam përpara raportin financiar të kandidatit, nuk kemi folur në asnjë rast as për z. Cara, as për kandidatët e tjerë për mënyrën se si janë paguar faturat dhe se si janë kryer shpenzimet, nëse ato nën 150 000 lekë janë bërë “cash” apo me bankë dhe e anasjellta. Flasim vetëm për pranimin e të ardhurave. Rasti i z. Cara, ai ka deklaruar të ardhura në porcione, pra në shuma të ndryshme, nga shuma shumë të vogla, edhe një shifrore edhe disa shifrore, pra edhe më të vogla se sa 50 000 lekë dhe më të mëdha se sa 50 000 lekë, të cilat herë i ka deklaruar si shuma dhurimi në “cash”, për veten pra është gjithnjë fonde të vetat dhe herë me transfertë bankare, po vetë në llogarinë e tij të posaçme si kandidat. Ne i kemi mbledhur vetëm ato të cilat janë deklaruar si “cash” dhe janë mbi 50 000 lekë, të gjithë shumat e tjera, qofshin mbi apo nën 50 000 lekë, nga vetja, të cilat i ka deklaruar me transfertë, ka deklaruar numrin e llogarisë, është ai, është llogaria e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

posaçme, pra nuk kemi propozuar sanksion. Konkretisht për shembull, një nga shumatat është këtu. Për shembull dhe një shumë 14 070 lekë e ka bërë me transfertë bankare, edhe shuma të tjera. Edhe një shumë 83 340 lekë e po në llogari bankare. Pra asnjë shumë e kaluar përmes llogarisë bankare mbi 50 000 lekë nuk është propozuar për sanksion.

Z. L. Braho: Ka të tjera që i ka mbi 50 000 lekë, por që i ka derdhur në llogari bankare?

Znj. J. Josifi: Nuk i ka derdhur fare, jo.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Jua thashë, bëhet fjalë për dy fatura tvsh-je.

Znj. J. Josifi: Jo nuk janë fatura në këtë rast.


Z. L. Braho: Ato janë shpenzime.

Znj. J. Josifi: Nuk flasim për shpenzime.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Të ardhurat të tjera nuk ke, të ardhura të tjera i ke të gjitha nga arka në llogari.

Znj. J. Josifi: Të lutem, ja për shembull e keni këtu, jeni ju pra, të ardhurat tuaja, është shuma 108 000 lekë, data e dhurimit 10 maj 2023, metoda me para në dorë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po pra ajo është fatura 108 000 lekë.

Znj. J. Josifi: Dhe keni një tjetër 200 e ca.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po pra janë të gjitha.

Znj. J. Josifi: Nuk janë fatura këto, janë të ardhura, shpenzimet janë më poshtë, ato i keni në rregull.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Si të ardhura, të ardhura nga kush?

Znj. J. Josifi: Të ardhurat tuaja.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po të ardhurat nga kush, po janë të ardhurat e mia pra, nuk i kam marrë nga një palë e tretë apo jo duhet theksuar.

Znj. J. Josifi: Po po janë të ardhurat tuaja.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po janë të miat që i kam tërhequr nga llogaria e posaçme, pse s'e thoni këtë?

Z. L. Braho: Ti i ke tërheq nga llogaria e posaçme?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: I kam tërhequr nga llogaria ime për të bërë një pagesë që po jua shpjegoj.

Znj. J. Josifi: Janë fatura.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po pra po janë të miat, nuk i kam nga palë e tretë, i kam të dokumentuara, janë të miat të cilat po paguaj një faturë “cash”, ajo që pak a shumë thanë kolegët, është njësoj si të shkoj në një lokal dhe të ma japi faturë “cash” dhe unë t’i them jo more vëlla, më jep llogarinë e bankës se e dua patjetër në bankë!


Znj. J. Josifi: Nuk po flasim si i keni paguar shpenzimin ne po flasim si i keni futur të ardhurat.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po pra dhe unë po ta tregoj, nuk i kam futur. Një sekond, më bëtë një pyetje, të lutem ku i kam futur këto lekë?

Znj. J. Josifi: Nuk i keni futur askund i keni “cash”, i keni administruar si “cash”.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po pse thoni se nuk i kam futur, por pra se kam bërë pagesë. Pra nuk mund të përdorni termin, këtë term, duhet të thoni që këto para që unë po i marr nga llogaria po i shpenzoj, kaloje termin dhe quaje shpenzim. Se kjo nuk është e ardhur, po merret e po kalon shpenzim. Ky është term i gabuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Me çfarë kuptoj unë z. Cara thotë i kam tërhequr “cash” nga llogaria e posaçme dhe me këtë tërheqje ka bërë pagesën e këtyre dy faturave.

Znj. J. Josifi: Nuk po vë njeri fare në diskutim tërheqjen, po themi këto të ardhura si janë administruar, kjo e ardhur?

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Është nga llogaria ime, e ardhur quhet kur merret nga një palë e tretë.

Znj. J. Josifi: Është e ardhur e vetë subjektit zgjedhor pranë jush si kandidat?

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Është nga llogaria ime personale.

Znj. J. Josifi: Po pra, po ju jeni subjekt zgjedhor.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Ku është kjo që po thua ti?

Znj. J. Josifi: Edhe njëherë, të ardhurat kalojnë në llogarinë e posaçme, është tjetër histori se si bëhen shpenzimet.

Z. I. Cara, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës: Po ta shpjegoj zonjë, nga këto raste kur nuk bëhet nga llogaria e posaçme, është pagesë “cash”, e kam marrë nga llogaria ime dhe ia kam dhënë “cash”. Atëherë ju duhet të shihni, ajo që ju thanë kolegët e KAS-it duhet të shihni që këto shumat e mia totale përputhen me

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

vlerën 21 milion që kam te llogaria ime e posaçme, vlera totale, vlerë totale, me x shpenzime?

Z. I. Rusmali: Ose e thënë ndryshe, në metodologjinë e plotësimit të raportit, në qoftë se vendoset totali i llogarisë së posaçme, 21 milionë lekë tek pjesa e të ardhurave nuk ka asnjë nevojë që të shpjegojë pastaj se si, thotë të ardhura të fushatës 21 milion, kaq kacidhe këtu, kaq kacidhe këtu dhe mbyllet e gjitha. Metoda që përdorin të gjithë kandidatët pa përjashtim është që tek të ardhurat japin zë për zë lekët që kanë harxhuar për çdo shpenzim, është çështje e metodës. Tani nëse metoda që përdorin ata është e mirë apo është metodë e keqe është një diskutim tjetër, por që për metodën që përdorin të hanë gjobë është...

Z. L. Braho: Dëgjo ne duhet të vazhdojmë se ne kemi kohën të kufizuar, se në orën 15 kemi një takim me ODIHR të programuar, kështu që vijojmë me z. Ismail Uka? Z. Uka sipas KQZ-së ju duhet të paguani gjobë 72 000 lekë. Po shoh që ka disa 72 000 lekë, është rastësi, se kam parë 5-6 raste që e kanë 72 000 lekë. Z. Uka uluni.

Z. I. Uka, kandidat për kryetar të Bashkisë Dibër: Jo paraprakisht për procedurë sepse unë doja të flisja dhe nga vendi në fakt. Format, këtu jemi në një hetim administrativ dhe formati tani unë do flas për ca rregulla proceduriale. Format i ndërtimit, përfaqësueset e KQZ-së, është edhe fyese që janë me shpinë nga subjektet të cilat ne jemi këtu, duhet, pra ne kem dhe administratë, duhet të vendoseshin në pozicione këtu për të na dëgjuar se nuk e kuptojmë ne në këtë formë, këtë lloj formati me të cilin ne flasim dhe flasim nga shpina dhe do të detyrohet përfaqësuesit e KQZ-së të kthehet nga mbrapa, pikë së pari.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Kjo është çështje e arkitekture dhe nuk është kompetencë e jona.

Z. I. Uka, kandidat për kryetar të Bashkisë Dibër: Nuk është e drejtë se jeni në hetim administrativ dhe fillojnë rregullat proceduriale, rregulla administrative që parashikon Kodi i Procedurës Administrative.

Z. L. Braho: Ideja është që ju nuk e keni debatin me administratën e KQZ-së, pra ju i drejtoheni KAS-it, si ju, si ata.

Z. I. Uka, kandidat për kryetar të Bashkisë Dibër: Nuk kam asgjë personalisht me administratën, as me përfaqësuesit, janë të autorizuar, por mënyra e formatit që ju e keni vendosur na vë në pozita të pabarabarta dhe shumë fyese për ne, se s'kemi ardhur për teatër politik këtu.

Z. L. Braho: Atëherë z. Uka na thuaj pak për këtë propozimin, keni qenë kandidat, nuk e di sipas këtyre del një vlerë prej 72 000 lekësh që ti nuk i ke të kaluar nëpërmjet sistemit bankar, në llogarinë e posaçme, kështu që nuk e di çfarë informacioni mund të na japësh tani.

Z. I. Uka, kandidat për kryetar të Bashkisë Dibër: Po faleminderit kryetar! Të nderuar zotërinj anëtarë! Ju kërkoj ndjesë ndoshta dhe për intonacionin po mënyra e reagimit të përfaqësuesve disa herë më vuri në pozitë dhe në atë pozicion që isha. Pikë së pari unë kam disa pyetje për të parashtruar para përfaqësuesve të KQZ-së. Së pari më është njoftuar projektraporti i audituesit të KQZ-së mua si subjekt, kandidat për kryetar bashkie i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Bashkinë Dibër,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

nëse po cila ka qenë mënyra e njoftimit tim si subjekt dhe si e provoni këtë fakt? Patjetër e dua përgjigjen sepse prej këtu fillon procedura, jemi përpara një akti administrativ, i cili duhet të pranohet e të bëhet procedura sipas Kodit të Procedurave Administrative. Pra kemi vendimin 186, 8.10. 2024 që janë propozuar dhe masat përkatëse.

Z. I. Rusmali: Z. Uka se realisht po largohem nga tema. Nuk është akt administrativ, është një kërkesë me të cilën Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in. Procesi administrativ fillon këtu, te ne dhe rregullat e procesit administrativ ne i kemi zbatuar të gjitha sepse gjëja e parë që kemi bërë i kemi njoftuar ju që të vini të merrni pjesë, të mbron, të thoni argumentat tuaja, të mbron të gjitha pozicionet ligjore që ju keni. Ju jeni sot këtu për këtë punë, ne jemi këtu që t'ju dëgjojmë me vëmendje dhe siç e keni parë kemi dëgjuar gjithsecilin me vëmendje dhe të përpiqemi të kuptojmë raportin e pretendimit me ligjin. Na ndihmoni dot? Kështu që më mirë e fillojmë me ju tek historia ju e keni marrë dijeni për raportin se e keni. Çfarë keni për të thënë gjetjet e tyre që pastaj të jepni atyre mundësinë të bëjnë prapësimet.

Z. I. Uka, kandidat për kryetar të Bashkisë Dibër: Me gjithë respektin që kam ndaj jush, e para kemi një vendimmarrje dhe çdo akt administrativ i nënshtrohet procedurës administrative.

Z. I. Rusmali: Kemi 30 vendimene që themi ajo vendimmarrje nuk sjell pasoja për njeri, të gjitha kërkesat ankimore që na kanë ardhur në bazë të asaj vendimmarrje i kemi rrëzuar si të papranueshme, kemi thënë ky proces administrativ, kompetenca

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

është e KAS-it, jo e Komisionerit, ky proces administrativ fillon me shqyrtimin në KAS. Komisioneri ka punën e vet, dokumentacioni dhe ka ardhur me një pretendim dhe ka thënë merreni në shqyrtim ta trajtoni dhe jemi me shqyrtim administrativ me palë këtu. Këtu fillon, nuk ka lidhje me akt vendimmarrjen, fillon me kërkesën e Komisionerit, i cili propozon që për ju të vendoset një gjobë, në masën 72 000 lekë, për shkelje të dispozitës të nenit 173, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Z. I. Uka, kandidat për kryetar të Bashkisë Dibër: I gjithë projektvendimi, ose kërkesa që është parashtruar KAS-it, flas për kandidatët në tërësi, pa i ndarë këtu me ngjyime politike, natyrisht që kanë gjetjet e veta, po po flas për pretendimet që ngre, lidhur me shkeljen e nenit 173, pika 5 e Kodit Zgjedhor, për ekstraktin në pikën 72, të kësaj kërkesë bëhet fjalë edhe për porpozimin që është bërë për 72 000 lekë që duhet të paguaj dhe të kalojnë në fonde të marra për llogari të KQZ-së. Tani duhet të ndahem nga pikëpamja ligjore sepse u trajtuan po s'dua të bie në përsëritje, së pari dispozita që i referohet kjo kërkesë është neni 173, pika 5, çfarë parashikon sepse ngecim dhe në mënyrën e interpretimit të termave të ligjit, kuptimit të ligjit sepse e gjithë situata e sanksioneve që lidhet me mënyrën e financimit të fushatës, lidhet me parimet e Kodit Zgjedhor që parashikon në nenin 4 të ligjit, pikërisht për të garantuar një proces të rregullt ligjor, për të garantuar votën e lirë, të barabartë për të gjitha subjektet. Çfarë parashikohet në pikën 5, është parashikuar pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 000 lekë thotë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me gjobë të barabartë me shumën e dhuruar. Shkojmë te koncepti shumë së dhuruar, njëherë pranimi i fondeve unë s'jam për fonde private këtu sepse nuk mund të quhet fond t'ia kesh dhuruar vetes. Së dyti, shkojmë te koncepti i Kodit Civil, te kontrata e dhurimit ose dhurimet. Ka dy palë ose dy subjekte, ka dhurues

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

dhe pranues. Në rastin konkret, pretendimet që ngrihen në kërkesën me objekt shqyrtimi administrativ bëhet fjalë për fonde të cilët kandidatët i kanë nga llogaritë e tyre personale dhe nuk bëhet fjalë për dhurues, nuk ka në hetimin administrativ, unë flas për ekstraktin, për pjesën e ekstraktit tim që të do të fokusohem edhe aty, do ta provoj dhe këtu që është një gabim, në keqinterpretim të ligjit. Pra në rastin konkret nuk është e parashikuar, nuk është e sanksionuar sepse deri në shumën një milion lekë të reja kandidatët ose subjektet të drejtë t'i përdorin si fonde. Nuk është e parashikuar në ligj një dispozitë e tillë, nëse mund të bëhet kalimi nga llogaritë personale ose jo. Në rastin konkret unë po flas sepse ka dhe konfondim. Ndonëse raporti financiar i fushatës elektorale, po flas për vete si kandidat është mbajtur sepse ishim pa firmë, pa vulë, pa fonde sepse duhet të referohem këtu edhe për fushatën elektorale meqenëse jam përfaqësues i KQZ-së, nuk do flas, s'ka ardhur të flas politikisht, po kam ardhur për të nxitur pikërisht për këto fonde. Çfarë thotë në rastin konkret raporti përfundimtar i OSBE/ ODIHR, besoj nuk është raport, as pretendimi imi, i datës 29 shtator 2023. Çfarë bëhet fjalë në rastin konkret? Financieri ose ai që ka mbajtur deri në këtë kohë ka qenë deri në këtë kohë përfaqësues i "Partisë së Lirisë", është Gjorgjas Gostishti, i cili ka përfaqësuar dhe dokumentacionin, këtë formular të cilin tani është audituar në mënyrë private. Bëhet fjalë për një faturë prej 72 000 lekë të reja, të cilat, ja ta shihni dhe ju, po jua vendos në dispozicion se këtu përfaqësuesit e KQZ-së duhet të vinin me ekstraktet dhe me dokumentacionin t'i vendosnin aty në tavolinë, jo në telefon, jo t'ua kërkojnë palëve, kandidatëve sot. Për çfarë bëhet fjalë? Bëhet fjalë për një faturë tatimore me numër 429, e datës 10.5.2023, e cila është për subjektin "Sakuli shpk", që përfaqëson një pagesë të kryer nga ana ime si kandidat për kryetar bashkie në Dibër, për aktivitetin i cili ka qenë dita e prezantimit të kandidatit nga dr. Berisha në Peshkopi. Bëhet fjalë, ka sjellë ca karrike e ka vendos në mes të qytetit aty dhe për

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

këtë ata e quajnë event, janë paguar 72 000 lekë me faturë dhe subjekti janë të shënuara me para në dorë dhe kjo faturë është në raportin që unë kam bërë përfundimtar të shpenzimeve si kandidat. Ku konsiston shkelja këtu? Është pyetja për KQZ-në sepse u bë shumë mediatike, na nxorën nëpër televizione? Le të ma kthejë mandatin e kryetarit të bashkisë KQZ-ja, ia alokoj unë këto fonde, që ma grabitën, ma vodhën, nuk ka asnjë gjobë të vendosur, ja ku i keni, jeni përfaqësues të KAS-it. Shiheni duke u organizuar aktivitetet retro në Dibër, Belinda Balluku, Ulsi Manja, Blendi Gonxhja, shihni ja t'ju jap, t'i shohë KQZ-ja, t'i shohë me lekë, duke dalë nga pallati, është bërë publike. Sa denoncime ka bërë KQZ-ja për zgjedhjet në Dibër, sa masa administrative ka marrë? Ja shihni, me pamje, me figurë, doni me zë? T'i shihni ju dhe vihet e bëhet sot një show mediatik me ne si kandidatë. Na ktheni dinjitetin, na ktheni mandatin e vjedhur, për këtë është i ndërtuar Kodi Zgjedhor dhe çfarë ndodh? Në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR çfarë thuhet, ja çfarë thuhet, përsa i përket fondeve, fushatës, megjithatë bashkëbiseduesin, në faqen 15 të raportit. Në disa qarqe pretendohen se mbështetësit e opozitës u përballën me kërcënime thotë, që synonin pengimin e tyre për të mos marrë pjesë në aktivitetin e fushatës, përveç kësaj pati akuza të shumta për blerje ose dhënie të shumës financiar që njerëzit të mos merrnin pjesë në zgjedhje, në shumicën e rasteve pretendohet, si të iniciuara nga PS. Aleati i atij, Partia Demokrate dhe mbi 63 fletë për Bashkinë Dibër, 6 këshilltarë ka shit Partia Socialdemokrate, kthehet forcë politike në Dibër duke vjedhur dhe duke blerë vota. Çfarë thotë raporti përfundimtar, kush është raporti përfundimtar që flet për rekomandime parësore, cili është rekomandimi parësor? Po flas kështu sepse ju jeni profesionistë të ligjit, të politikës, vini dhe nga politika dhe duhet të jap një mesazh, duhet të marrë fund shit-blerja e votës. Mos u merrni me ne, ne jemi pjesa më dinjitoze e këtyre zgjedhjeve, e kësaj masakre, e kësaj platforme, pjesë e kësaj

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

platforme manipulimi i zgjedhjeve janë dhe segmente të KQZ-së. Çfarë thonë organet e zbatimit të ligjit, thotë, duhet të kenë të gjitha përpjekjet për të identifikuar dhe hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore duke përfshirë blerjen e votë, presionin, në keqpërdorimin e burimeve administrative në mënyrë tërësore në formën e duhur dhe me transparencë. Zgjedhësi thotë duhet të informohet sistematikisht për mekanizmat e zbatueshme për denoncimin e shkeljeve duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj pasojave të denoncimit, ky është raporti më i zi që ka ndodh në 33 vite të hetimit të zgjedhjeve administrative, të monitorimit nga mekanizma ndërkombëtarë. Nuk e them unë si kandidat dhe ne sillemi këtu e dalim e bëhemi pazar nëpër televizione akoma pa u shqyrtuar nga KAS projekti, për sa i përket shkeljeve të fushatës zgjedhore. Ne i paskemi bërë shkeljet zgjedhore? Nga 61 mandate, 53 mandate kanë shkuar në favor të mazhorancës, ne i paskemi bërë? Ma ktheni mandatin mua të kryetarit të bashkisë, se i jap unë lekët, atë 72 000 lekëshin. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit z. Uka! Viojmë, se di ka KQZ-ja ndonjë koment? Jepi një kopje administratës së KQZ-së. Po e nxjerr nga sistemi. Vazhdojmë me z. Lefter Maliqi? Nuk është. Luçiano Boçi?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Më falni për z. Lefter Maliqi kemi prokurë.

Z. L. Braho: Desh harrove për pak.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo, është mjaft e rëndësishme.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. L. Braho: Tani kemi një takim, në orën 15.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Shumë shpejt, një minutë vetëm për z. Lefter Maliqi.

Z. L. Braho: Një minutë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Është e njëjta problematikë, sikundër dhe të gjithë kandidatët e tjerë që kemi dëgjuar deri më sot, shpenzime të kryera nga vetë kandidati, nga fondet e tij personale, nga paga dhe kursimet e tij që ka pasur. Nuk ka asnjë lloj tejkalimi të ligjit apo të limiteve, me pagesat, kështu që kundërshtojmë me gjithë argumentat që paraqita dhe më përpara dhe kërkojmë rrëzimin e masës së propozuar për z. Lefter Maliqi.

Z. L. Braho: Z. Luçiano Boçi, 72 000 lekë edhe ai me një faturë nga "Sakuli" më duket, paska shumë fatura. Keni prokurë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo për Luçianon nuk kemi prokurë. Besoj duhet të jetë faturë, 72 000 lekë duhet të jetë për TVSH-në, 20%, se s'ka mundësi, 600 lekë të vjetra, plus 20%, nuk e di.

Z. L. Braho: Për Luçiano Boçin keni prokurë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo nuk kemi prokurë, i qëndrojmë mbrojtjes që kemi bërë për të gjithë kandidatët e tjerë, ish kandidatët tanë në zgjedhjet vendore.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

Z. L. Braho: Luftar Dauti, Has? Pashk Gjoni, Lezhë? Resmi Shanaj?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Për Resmi Shanaj kemi deklarim, një deklarim që e ka nënshkruar vetë dhe po ia vë në dispozicion KQZ-së, po e relatoj shkurt. Zotëria deklaron se për të gjitha fondet mbi 50 000 lekë nga palët e treta, i ka derdhur në llogari bankare. Ai thotë që ka hapur posaçërisht llogari për këtë shërbim dhe sqaron se nuk e interpreton ashtu sikundër e ka interpretuar dhe KQZ-ja në lidhje me shkeljen e tij. Ai nuk e pranon shkeljen dhe deklaron se mund të ketë një keqinterpretim në lidhje me këtë pikë të ligjit, po jo të qëllimshme dhe i kërkon Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ-së që të marrë në shqyrtim ankimin e tij dhe të anulojë masën dhe në këtë rast jemi në shumën 72 000 lekë, po më tej po i referohem shkresës së zotërisë dhe po e vë në dispozicion të KQZ-së.

Z. L. Braho: Dakord. Nuk e di a ka ndonjë të pranishëm nga këta këtu, Shefki Çoku? Zonja, jeni Sofije Alushaj. Sofia do të dëgjojmë se ti e paske 80 100 lekë. A del dot atje te mikrofonit?

Znj. S. Alushaj, kandidate për kryetare të Bashkisë Patos: Dua të njihem për çfarë jam gjobitur e para sepse s'jam njoftuar nga askush, në as edhe një mënyrë. Përpara tre ditësh vetëm me email nga Partia Demokratike. Ndërsa gjatë kohës së paraqitjes së raportit kemi pasur një kontakt me KQZ-në dhe sipas çdo udhëzimi jemi detyruar që t'i paraqesim në mënyrën e rregullt.

Znj. J. Josifi: Ia kemi bërë me dije raportin, draft raportin me gjetje, përpara miratimit të raporteve subjektivit zgjedhor, në bazë të "Partisë së Lirisë" dhe kemi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 3.12.2024*

bërë po ashtu me dije projektvendimin në interpretim përpara se ai të miratohej dhe nuk kemi marrë asnjë observacion për këtë rast.

Znj. S. Alushaj, candidate për kryetare të Bashkisë Patos: Përfaqësuese e PL, apo jam si Sofija Alushaj?

Znj. J. Josifi: Jeni candidate.

Znj. S. Alushaj, candidate për kryetare të Bashkisë Patos: Të lutem!

Z. L. Braho: Degjo nuk e kemi debatin me...

Znj. S. Alushaj, candidate për kryetare të Bashkisë Patos: Ma sqaro për çfarë e kam gjobën?

Znj. J. Josifi: Për pranim të fondeve private në “cash”.

Znj. S. Alushaj, candidate për kryetare të Bashkisë Patos: Nga?

Znj. J. Josifi: Do ta verifikojmë.

Znj. S. Alushaj, candidate për kryetare të Bashkisë Patos: Nga vetja ime? Kam idenë që nuk mund ta kem vjedhur veten time dhe si mund t’ia kthej dikujt lekët e mia në qoftë se i kam marrë nga njëri xhep dhe i kam vënë te xhepi tjetër? Edhe t’i jap të njëjtë vlerë, do e jap edhe njëherë, të njëtën vlerë do e jap edhe njëherë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 3.12.2024

Z. L. Braho: Zonja Alushaj besoj u qartësuar? Ideja është që keni përdorur fondet tuaja personale për fushatë pa i kaluar në llogarinë e posaçme, ky është pretendimi që ka KQZ-ja. Vazhdojmë me z. Zija Ismaili?

Znj. S. Alushaj, candidate për kryetare të Bashkisë Patos: Ka qenë që në llogarinë personale të posaçme mbi 50 000 lekë kur deklarohet, nuk kemi ndonjë nga palë e tretë, por jo kur i kemi personale. Të paktën kështu është komunikuar gjatë fushatës. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë mbeten për në vijim Shefki Çoba, Shkëlqim Hoxha, Zija Ismaili dhe Zihni Tolloshina, po ashtu Pjerin Ndreu që ka një gjobë për arsye të tjera si dhe partitë politike, “Partia Socialiste”, “Partia Demokratike”, “Partia Agrare Ambjentaliste”, “Partia Republikane”, “Partia Konservatore”, të cilat do të japin pretendimet e tyre në lidhje me këto propozime. Do shtyhet edhe ajo tani se është e pamundur, thjesht të caktojmë datën. Atëherë seanca për shqyrtimin administrativ do të vazhdojë nesër në datë 4 dhjetor, ora 11, me vijimin për sa i përket palëve që nuk patën mundësi që të japin pretendimet e tyre sot. Më tej do t’ju njoftojmë në lidhje me shpalljen e vendimit nesër. Ata vijnë, s’vinë ne. Atëherë do të lihet për datë 5, ora 12.00.

Zbardhi materialin audio

Adriana DUKA

